

Jeta Arbëreshe

e-mail: jetarbreshe@libero.it - <http://digilander.libero.it/jetarbreshe> (Mondo Italo-Albanese)

Del nga tre muaj - Trimestrale della Minoranza linguistica storica Albanese d'Italia - Eianina / Purçill (Cs- Italia)

Spedizione in A.P. - TAXE PERÇUE - art. 2 comma 20/c - L.662/96, Aut. n. DCO/DC/CS/101/2003, valida dal 06/03/03

Përmbajtja / Sommaire

NGA EPARKIA E HORËS SË ARBËRESHËVET

Tommasina Guarino (*Ndërrimi i priftrave*) faqe 2/5

KRYEARTIKULLI

Drejtori (*Eparkia e Ungrës kërkon udhën e bjerrë*) faqe 3/25

KORRESPONDENCA NGA KATUNDET ARBËRESHË

Francesco Marchianò (*Spixanë: 1860-2010*) faqe 4/16

Maria Assunta Fazzano (*Pë të mbahet mend Skanderbegu*) faqe 5

Viçenxi Stratikò (*U buar gjithsej ndër kta katunde: Kush ftesin?*) faqe 6

Lucia Cardamone (*Fjalëkryqi*) faqe 6

Angelo Matrangolo (*Një marmur pir zotin Matrangolo*) faqe 7

Drejtori (*Seminari i Prishtinës*) faqe 7

Nicoletta Russo (*Katundi im*) faqe 8/15

Emanuele protopapas Giordano (*Mëma Tereze Bojaxhiu*) faqe 8

100VJETORI I LERJES SË NËNËS TEREZE

Poezi e Lutje të Gonxhe-s Bojaxhiu faqe 9

TEKSTE POPULLORË NGA KATUNDET ARBËRESHË

Giuseppe Chiaffitelli (*Lëmi*) faqe 10

Andrea Bellucci (*Këngë për fëmijë*) faqe 11

Vittoria Oliverio (*Duminku te poça*) faqe 11

Salvatore Franco (*Vjershe malli*) faqe 11

LIPET TANË

Drejtori (*Anita Markut, mëma ime*) faqe 12

Drejtori (*Arkimadriti Eleuterio F. Fortino*) faqe 12/29/31

Don Lush Gjergji (*Kaloi në amshim Arkimadriti Arbëresh Eleuterio Fortino*) faqe 13/25

QISHA BIXANTINE ARBËRESHE

Emanuele protopapas Giordano (*Mesha e Shën Vasilit të Math*) faqe 14-15

POEZI SHQIPE

Zhaneta Ogranaja (Habazaj) (*Dua vullnetin tuaj të bukur*) faqe 16

Lek Pervizi (*Mirëdita, Faleminderit Liri*) faqe 16

STUDIME / RECENSIONE / ARTIKUJ / TEKSTE MBI BOTËN ARBËRESHE

Klara Kodra (*Bota poetike e Buzëdhelprit*) faqe 17

Zejnullah Rrahmani (*"Fitorja e sana" e Zef Serembes*) faqe 18

Zamira Alimemaj (*De Rada, promovues i romantizmit shqiptar*) faqe 19

Laura Smaqi (*Poezi e pikturë te De Rada*) faqe 20-21

Imri Badallaj (*Edhe një Fjalor i Arbërishtes*) faqe 21

Motra e vogël Maria Lucia (*20 vjet në Ejaninë*) faqe 21

Orjeta Baja, Merita Hysa (*Ndikimi i italianizmave në gjuhën e Arbëreshëve të Italisë*) faqe 22-23

Nando Elmo (*Ku vete Eparkia e Ungris?*) faqe 23

STUDIME / RECENSIONE / ARTIKUJ / TEKSTE MBI BOTËN SHQIPTARE

Baviola Shatro (*Vertikaliteti i përditshmërisë dhe alegoria e heshitjes*) faqe 24-25

Helena Grillo (*Shqyrtime Sociolinguistike për Emrat e Farefisnisë dhe Emrat Vetjakë*) faqe 26-27

Motra e vogël Lliçja (*Tiranë 1986, Otranto 1991, Shkodër 2010*) faqe 27

Tomor Osmani (*Martin Camaj për kulturën shqiptare. Shkrimtari dhe albanologu*) faqe 28

LIBRE e REVISTA faqe 29

DORËSHKRIMI ARBËRESH

Bernardo Bilotta (*Pjeqëriza*) faqe 30-31

Drejtori (*Idiomatizme ka Purçilli*) faqe 31

JO VET ARBËRISHT

Pierfranco Bruni faqe 32

Ndërrimi i priftrave

Tommasina Guarino

ka Kuntisa (Pa)

Nga më shumë se një vit Kuntisa rron një gjëndje etnikokulturor-fetare kritike, që zgjon qajtë të gjithë hora, kute shkatërruar atë ndodhje shpirtërore që duket se ishtë ndë besimtarët e rritit grek-bizantin e besimtarët e rritit latin-roman; bashkëri kjo që, për kush di t'ë lëngonjë, plotëson komunitetin e tërë e ngë ishtë shkak zënieje e ndarjeje, si ndonjeri, në mënyrë të padijtur, mënd të thotë.

Më duket se jemi e pririmi prapa për më shumë se 250 vjet, kur për të vënë sosje zënieve ndë të dyja rritet, te dita gjashtë shtator 1754, ishtë nënshkruar një "Accordium" "Mirëkuptim" ndë klerin bizantin e klerin latin, i aprovuar nga vishku i Xhixhentit e pas, më 10-11-1900, i vërtetuar nga vishku i Munrialit.

Ky "Mirëkuptim", më mirë njohur me embrin "Tranzacionë", thotë çilat janë të drejtat që i ngasën klerëve të të dyja klishave, ndë këto drejtësia e klerit bizantin të bënë të klisha litire "Paraklis-in" te të parat pesëmbëdhjetë ditë të gushtit, vespret dhe festën e Shën Mërisë së Favarës, "Stosanesin", domethënë lajmin e ngjalljes së Krishtit te dita e Pashkëve e dy ditë dopu.

Nga viti i shkuam, pjesë e famullisë litire, në emër të të njëjtin nder, ngë do të njohinjë sa atje ishtë shkruar e njera sot u ka bërë. Thuhet se dokumenti ngë ishtë i vërtetë e, pa mbajtur kund te ato që janë traditat shekullore e njëi populli, pa thënë gjë, përveç se mënd e gjëndet dera e klishës mbëlljitur, mirren dica zgjidhje që ngë janë të liturgjia, si për shembull, të kënduar këndime e alleluja, te dita e Pashkëve, kur jarren te klisha litire kleri bizantin e, prandaj, ngë jipet qëroi për të thënë çerimoninë ashtu si duhet. Sa të ngatëroj më shumë të rrojturit e Kuntisiotëve ka klënë atë që ka bërë delegati i Papës imzot Françesko Pio Tamburrino, që ka ardhur te hora për të ndrequr këtë gjëndje, të dërgoj "si dënim" priftrat e të dyja klishave, kute krijuar probleme të forta e kute dhezur tjera flakë zjarrmi.

Imzot Tamburrino, me zgjidhjen që ai mori, ngë i ka shkuar thomse për krei se hora ishtë arbëreshe, ku priftrat tek e shkuamja kanë pasur një rëndësi të madhe te rilindja arbëreshe e për vlerësimin e karakteristikave lokale, e dërgon papas Nikollën Kuça, parakun e klishës bizantine të Kuntisë, që mënd t'ë çelëm ndë këta të sipërthënë, përveç të jetë shumë i zgjuar te apostullati i tij brënda horës së tërë, nga Kuntisa në Pallac, kute detyruar parakun bizantin të Pallacit, papas Sepa Borzi, të shkronjë në Kuntisë, ku ai leu.

Mosgjë bënë litrat, telefonatat, hjakulatat me proçesjonë, artikujt mbi aq gazeta e televizionja. Zbisët qëndruan si tha ai e pa gjykar.

Delegati i Papës, njëherë se ai ishtë prifti liti, thomse ngë ka varrejtur se të dyja parakat, ai i Kuntisë dhe ai i Pallacit, janë martuar me bijë e ndërrim krijon shumë probleme te fëmijla. Vërtet ishtë se problemet e fëmijlës, në këtë kontekst, ng' i hyjnë, por ishtë gjithashtu vërtet se fëmijla në fushën fetare ishtë te të parat vende.

Mundësisht, imzot Tamburrino, që ng' e njeh shumë mirë të shkuamen e horës, përkuideset vetem të ruanjë zbisët që duken e jo të mbanjë gjallë identitetin, që rri te zëmra e Kuntisiotëve, e një horje, të një pakice etnike, edhe përmes fenë e klishës me nderin e me mbajtjen e traditave e të zakoneve.

Klisha", sot si sot, ngë ka më bëzonjë priftra më shkronjën "P" të madhe, që formojnë gjindjen, por zotra që vënë përpara atë që duket e jo atë që ishtë; ngë adunaret se te dheu italian aq tjera fe venë kute rritur.

Atëherë u vetëm e vetëm bënë një pyetje: ndodhja e Arbëreshëve

(ec te faqja 5)

CONTESSA ENTELLINA VIVE UNA SITUAZIONE CRITICA - Da più di un anno Contessa Entellina vive una situazione etno-culturale-religiosa critica, che suscita polemiche in tutta la popolazione, rompendo quell'apparente equilibrio spirituale esistente tra i fedeli di rito greco-bizantino ed i fedeli di rito latino-romano; coesistenza questa che, per chi sa ben interpretarla, arricchisce l'intera comunità e non è motivo di beghe e di divisioni, come qualcuno, in maniera ignorante, può dire o vorrebbe fare credere.

Mi sembra che si stia tomando indietro per più di 250 anni, precisamente a quando, proprio per porre fine ai dissensi sorti fra i due riti, il 6 settembre 1754 viene sottoscritto un "Accordium" tra il clero bizantino e il clero latino, approvato dal vescovo di Girgenti e successivamente, il 10-11-1900, confermato dall'arcivescovo di Monreale.

Questo "Accordium", meglio conosciuto col nome "Transazione", stabilisce i diritti e le competenze spettanti ai cleri delle due chiese, tra i quali il diritto del clero greco-bizantino di recitare nella chiesa latina la "Paraklisis" nella prima quindicina di agosto, i vesperi ed i festeggiamenti in onore della Madonna della Favara, il "Hristos anesti", cioè l'annuncio della resurrezione di Cristo il giorno di Pasqua e i due giorni successivi.

Dallo scorso anno, parte della comunità latina, in nome della pari dignità, non vuole, con cognizione di causa, riconoscere quanto ivi scritto e fino ad ora rispettato.

Si mette in dubbio la veridicità del documento e, senza tener conto di quelle che sono le tradizioni secolari di un popolo, autonomamente, oltre a far trovare la porta della chiesa chiusa, si prendono delle decisioni non contemplate dalla liturgia, come per esempio, intonare canti ed alleluia il giorno di Pasqua, quando arriva in processione il clero bizantino e, quindi, non dare adeguato spazio allo svolgersi della cerimonia, come previsto.

A rendere più complicato il "modus vivendi" dei Contessioti, è stata la decisione presa dal delegato pontificio mons. Francesco Pio Tamburrino, venuto a Contessa E. per risolvere la situazione in maniera consona, di trasferire "come punizione" i preti delle due parrocchie, creando così malcontenti ed alimentando nuovi fermenti e dissapori.

Mons. Tamburrino, nel trovare la soluzione al problema creatosi, non ha forse tenuto conto che trattasi di un paese di etnia albanese, dove i papas nel passato hanno avuto una grande incidenza storica nella "Rilindja Arbëreshe" e per la valorizzazione delle peculiarità locali, e trasferisce papas Nicolò Cuccia, parroco della chiesa bizantina di Contessa, che lo possiamo annoverare tra i suddetti, oltre ad essere molto zelante nel suo apostolato in seno al paese, da Contessa Entellina a Palazzo Adriano, obbligando, nel contempo, il parroco bizantino di Palazzo Adriano, papas Sepa Borzi, di passare a Contessa Entellina, suo paese natio.

A niente sono valsi le lettere di protesta, le telefonate, le fiaccolate, gli articoli su giornali vari ed i servizi televisivi. Le cose sono rimaste così come Lui ha decretato. Tra l'altro, il delegato pontificio, essendo di rito latino romano, forse non ha ben valutato e preso in considerazione che i due parroci, quello di Contessa Entellina e quello di Palazzo Adriano, sono sposati e con figli e lo spostamento crea problemi non indifferenti in famiglia. Vero è che i disagi familiari, in questo contesto, non sono contemplati, ma è altrettanto vero che la famiglia nell'istituzione religiosa occupa un posto preminente.

(ec te faqja 5)

Eparkia e Ungrës kërkon udhën e bjerrë

Këtë faqe dojt' e kisha lënë të bardhë. Sepse u, mbi Eparkinë e Ungrës, i thashë e i shkruajta të gjitha, ka trembëdhjetë vjet e këtej. Tridhjetë artikuj. E i shkruajta se kisha besë se peshpku i Ungrës e ndreqnij Eparkinë. Po kështu s'qe. E sot Ungër kemi një Administrator Apostollik lëti. Sepse priftrat e Eparkisë s'u gjëndtin dakord mbi ëmrin e peshpkut të ri. Janë të ndajtur.

U kam besë se problemet e Eparkisë zunë me vitin 1987. Si peshpku Lupinaçi u ul mbi thronin eparkial, u zbulua pafuqia e tij: si pa se me priftrin e Ungrës s'vej dakord, kish t' e kish llarguar, po s'e bëri. Ky gjest pafuqije qe mbëkati i tij originall. Mbëkat që bëri njetër herë, tetë vjet pas, tek hapja e Sinodit të Ungrës (1995). Kur prifti i Ungrës, përpara gjithëve, tha se ai Sinod ish "ilegal". As atë herë peshpku ngrëjti shkopin. E këtu skandalli u përhap, si vulë vali, ndëpër gjithë Eparkinë. Peshpku mendonij të shpëtonij Eparkinë me butësinë, jo me fuqinë; me fjalën, jo me shkopin. (Kish t' e kish shpëtuar me fjalën e me shkopin). E priftrat, si e panë të pafuqishëm, i muartin dorën e krahun: zunë e bënë që dishtin. Zunë e u llarguan ka peshpku. E peshpku ka priftrat.

Pak bëri peshpku për të gjënj vokaciona ndër katundet arbëreshë, edhe se pak e ndihtin priftrat. Përvoi të gjënj seminaristë ndë Shqipëri, po jo një u bë prift. Qëndruar pa seminaristë, peshpku mbëllijti Seminarët e Shën Vasilit e të Grotaferratës, e s' dirgoi mosnjeri më te Kollexhi Grek. E, për të mbulonij këtë turpë, priftrat vate e i kërkoi ndë... Romani! U kam besë se peshpku seminaristët e priftrat i kish ndë Kalabri. Gjatë vitrave, kush u xhesh e kush iku, e vanë me Qishen Orthodoxke greke; kush dojt' bënur lektor, po qe reshtur, e vate me Qishen Orthodoxke Ruse, ç' e bëri prift; kush është dhjak ka vitra e s'qe bënur prift; dica seminaristë mbaruan studimet filozofikë e teologjikë po s'janë menu dhjakra; kush është laik i martuar e do t' u kish bënur prift, po peshpku menu dish t' e dinij.

Si peshpku s' djiti, e s' dish, të buthtonij autoritetin e tij mbi priftrat, e kështu qe ka këta i qellur dhunë; kështu priftrat s' djitin, e s' dishtin, të buthtojn autoritetin e tyre mbi gjindjat e katundeve, po ka këta qenë qellur për hundje. Pa bësull, aq peshpku sa priftrat. Si peshpku i shtëlloj ngaherë ftesmen ngrah priftravet ("Ja thom me të mirë, po s' më gjegjëjën"), kështu priftrat i shtëllojën ftesmen ngrah gjindjes ("Arbrishtin s' e kuptojën, duan lëtitshin; duan statuat e jo ikonat; duan festën e Shën Piu, e Shën Frangjiskut, e Shën Ndonit; s' duan t' e dinë Sinodin e Ungrës, etj...). Pa bësull. Ku u pá, ndonjë herë, se dhentë i thonë delarit ku kanë të venë të kullotjën? Pa bësull. Pa kulturë bixantine (e kanë, po e fshehtin), pa zëmer arbëreshe, pa kocë. E anarkia vate ture u shtuar, aq Ungër sa ndër katundet arbëreshë. Thënie tipike lëtre hyjtin te liturgjia bixantine, me bekimin e peshpkut; recitimi italian ("bla-bla-bla-u monoton") zu vendin e këndimit grek e arbëresh; këtu këtjës, statuat i bën këpucët ikonave, tek festat e tek proçesjonat; te dica qishë, mesha këndohet lëtitsh ka zoti e populli përgjegjet grek; e pagzimi bëhet me ujë të shtënë mbi ballët; etj...

Mons. Nunnari, kuj i bëmi shumë urime, ka që t' punonjë, më parë se të gjënjë një prift arbëresh të denjë për thronin e

(ec te faqja 25)

L'EPARCHIA DI LUNGRO CERCA LA STRADA PERDUTA - Questa pagina l'avrei voluto lasciare bianca. Perché io, sull'Eparchia di Lungro, ho detto e scritto tutto, da tredici anni in qua. Trenta articoli. E li ho scritti perché credevo che il vescovo di Lungro avrebbe raddrizzata l'Eparchia. Ma così non è stato. E oggi a Lungro abbiamo un Amministratore Apostolico latino. Perché i papas non si sono trovati d'accordo sul nome del nuovo vescovo. Sono divisi.

Io credo che i problemi dell'Eparchia sono cominciati nel 1987. Appena il vescovo Lupinacci si sedette sul trono di Lungro, si scoprì la sua impotenza: appena accortosi che col parroco di Lungro non c'era accordo, avrebbe dovuto allontanarlo, ma non lo fece. Questo gesto d'impotenza fu il suo peccato originale. Peccato ripetuto otto anni dopo, all'apertura del Sinodo di Lungro (1995). Quando il parroco di Lungro, davanti a tutti, bollò di "illegaltà" il Sinodo stesso. Neanche quella volta il vescovo alzò il bastone. E qui lo scandalo si estese, come macchia d'olio, a tutta l'Eparchia. Il vescovo pensava di salvare l'Eparchia con la bontà, non con la forza; con la parola, non con il bastone. (Avrebbe dovuto salvarla con la parola e col bastone). E i parroci, vedendolo impotente, se ne approfittarono: cominciarono a fare quel che loro piaceva. Cominciarono ad allontanarsi dal vescovo. E il vescovo dai parroci.

Poco fece il vescovo per trovare vocazioni nei paesi arbëreshë, anche perché poco aiutato dai parroci. Provò a trovare seminaristi in Albania, ma non uno si fece prete. Rimasto senza seminaristi, il vescovo chiuse i Seminari di S. Basile e di Grottaferrata e non mandò più nessuno al Collegio Greco. E, per coprire questa vergogna, i preti andò a cercarli in... Romania! Io credo che il vescovo i seminaristi e i preti ce l'aveva in Calabria. Negli anni, chi s'è spogliato e chi se n'è andato, trovando posto nella Chiesa Ortodossa Greca; chi voleva essere fatto lettore, ma venne scacciato, e se n'è andato con la Chiesa Ortodossa Russa, che l'ha ordinato prete; chi è diacono da anni, ma non è stato ordinato prete; alcuni seminaristi hanno finito gli studi filosofici e teologici, ma non sono neanche diaconi; c'è chi è laico sposato e avrebbe voluto farsi prete, ma il vescovo non l'ha neanche voluto sapere.

Come il vescovo non ha saputo, nè voluto, esercitare la sua autorità sui preti, e così da questi è stato preso in giro; così i preti non hanno saputo, nè voluto, esercitare la loro autorità sui fedeli dei paesi, ma da questi sono stati trascinati per il naso. Senza bussola, tanto il vescovo quanto i preti. Come il vescovo ha sempre addossato la colpa ai preti ("Glielo dico con le buone, ma non mi ubbidiscono"), così i preti addossano la colpa ai fedeli ("L'albanese non lo capiscono, preferiscono l'italiano; vogliono le statue e non le icone; vogliono la festa di S. Pio, di S. Francesco e di S. Antonio; non vogliono saperne del Sinodo di Lungro, ecc..."). Senza bussola. Dove mai s'è visto che le pecore dicono al pastore dove devono andare a pascolare? Senza bussola. Senza cultura bizantina (ce l'hanno, ma l'hanno nascosta), senza cuore arbëresh, senza testa. E l'anarchia è andata aumentando, tanto a Lungro quanto nei paesi arbëreshë. Frasi tipiche italiane sono entrate nella liturgia bizantina, con la benedizione del vescovo; qua e là, la recitazione italiana (bla-bla-bla monotono) ha sostituito il canto greco e albanese; le statue hanno soppiantato le icone, nelle feste e nelle processioni; in alcune chiese, la messa viene cantata in italiano dal prete e il popolo risponde in greco, e il battesimo si fa per aspersione; ecc...

Mons. Nunnari, a cui facciamo tanti auguri, ha da lavorare, prima di trovare un prete arbëresh degno del trono di Lungro.

(ec te faqja 25)

Spixanë: 1860-2010

Francesco Marchiano

ka Spixana (Cs)

Te dita 31 gusht u mbulli projekti Pon "Più scuola per tutti", i bënë ka Ics i Spixanës, i drejtuar ka dokt. Rosina Costabile, ka Sh. Sofia, për nxënësit e shkollës edhe për të mbëdhenjt.

Ky projekt kërkoi të bënej një shurbes i mirë tue ruajtur historinë e katundit,e për ktë u nda dy copash: një modull u interesua për Rilindjen arbëreshe, që 1848 njera te viti 1866; kurse jetri modull bëri një pjesë teatrale mbi tekstin që duall ka modulli i historisë. Prof. Francesco Marchiano dhe Cesare De Rosis ruajtjn anën e historisë ture mbjedhur material, kurse Demetrio Corino shkruajti e vu në skenë pjesën teatrale, i ndihur ka Pierluigi Sposato, ç'është aktor edhe interesohet për kinematografi.

Bashkë me këta u vu mbrënda edhe ana muzikale, e ruajtur ka Daniela Bosco, e cila gjetë këndimet e Rilindjes e ja mbësoi aktorvet. Mbrëmanet e 6 gushtit, te teatri i Spixanës, u bë shfaqja teatrale me qindra gjindë ç'i pëlqeu si u sualltin aktorët (nxënësit edhe të mbëdhenjt).

Te muaji i shatorit do të dalë edhe libri ku janë kontributet e Marchiano-it, Corini-t e Bosco-s me titullin: "Spezzano Albanese per l'Unità d'Italia (1848-1866) – Gli episodi ed i protagonisti".

Libri, si edhe pjesa teatrale, rrëfienjën gjithë shurbiset ç'u ndodhëtin Spixanë te Rivolucioni i 1848-t, kur shkoj Garibaldi, kur zunë Brigandët njera te viti 1866, kur u mbulli lufta e pavarësisë. Fjitet edhe si jetohej te katundi, kush ishën Karbonarët, njerëzit që luftuan, vdiqitin ose i vunë te filaqia. Mbrënda te projekti, Vincenzo Lucchetti ruajti anën e daljevet te Muzeumi i Sibarit edhe te Kollegji i Shën Trianit te katundi i Shën Mitrut. Kem thomi edhe se tjerët që shurbien janë : Mariangela Presta (koordinatore e projektit), mësuesi Antonio Bosco (përgjegjës shkencor), Emmanuele Armentano (i shoqatës kulturore MeEdusa, sekretari organizuese dhe shtyp), Giuseppe Piragine (i shoqatës teatrale "Il Sipario"), Giuseppe Acquafredda (i shoqatës kulturore BKA, përgjegjës i botimit). Shumë faleminderit nxënesvet edhe te mbëdhenjvet ç'u buftuan si aktorë të mira: Adele Diodati, Antonella Russo, Chiara e Federica Mostaccio, Daniela Carfora, Franca De Rosis, Lina Bellusi, Antonella Russo, Daniela Bosco, Ferdinando Toma, Francesco Manna, Antonio G. Spingola, Giuseppe D'Ambrà, Giuseppe De Marco, Luca De Marco, Rocco Gallucci, Vincenzo Barbati, Vincenzo Genovese.

Në fund, por jo e fundit, një "faleminderit" të veçantë zonjës dokt. Rosina Costabile, drejtoreshë shkollore, që me vendim, fuqi dhe ndjenje u buftua si një arbëreshe e vertetë dhe e zgjuar, ture ruajtur e pyetur si ecnej Projekti ditë për ditë.

SPEZZANO: 1860-2010 - Il 31 agosto si è chiuso il progetto Pon "Più scuola per tutti" redatto dall'Istituto Comprensivo di Spezzano Albanese, diretto dalla dr.ssa Rosina Costabile, di S.Sofia d'Epiro, per gli alunni della scuola e per gli adulti. Questo progetto ha cercato di fare una cosa buona, salvaguardando la storia del paese e, per questo, è stato diviso in due parti: un modulo si è interessato per il Risorgimento Albanese, dal 1848 al 1866; mentre l'altro modulo ha preparato una parte teatrale sul testo uscito dal modulo storico. Prof.Francesco Marchiano e Cesare De Rosis hanno curato la parte storica raccogliendo materiale, mentre Demetrio Corino ha scritto e messo in scena la piece teatrale aiutato da Pierluigi Sposato, che è attore e si interessa di cinematografia. Insieme a queste due parti, anche la parte musicale, curata ka Daniela Bosco la quale ha trovato i Canti del Risorgimento e glie l'ha insegnato agli attori. La sera del 6 agosto si è tenuta a Spezzano Albanese la rappresentazione teatrale con centinaia di spettatori, a cui è piaciuto come hanno recitato gli autori (alunni e adulti). A settembre uscirà anche il libro, con i contributi di Marchiano, Corino e di Bosco, dal titolo: "Spezzano Albanese per l'Unità d'Italia (1848-1866) – Gli episodi ed i protagonisti". Il libro, come la piece teatrale, raccontano tutte le cose successe a Spezzano nella Rivoluzione del 1848, quando passò Garibaldi, quando comparvero i Briganti, fino al 1866 quando si chiuse la lotta per l'Indipendenza. Si parla anche di come si viveva in paese, quando c'erano i Carbonari, le persone che hanno lottato, sono morti o finiti in carcere. Dentro il progetto, Vincenzo Lucchetti si è occupato delle visite guidate, al Museo di Sibari e al Collegio di S.Adriano di San Demetrio Corone. Dobbiamo dire anche che gli altri che hanno lavorato sono: Mariangela Presta. (coordinatrice del progetto), l'insegnante Antonio Bosco (responsabile scientifico), Emmanuele Armentano (dell'Associazione Culturale MeEdusa, segreteria organizzativa e stampa), Giuseppe Piragine (dell'Associazione teatrale "Il Sipario"), Giuseppe Acquafredda (dell'Associazione Culturale Bashkim Kulturor Arbëresh, responsabile della pubblicazione). Molte grazie agli alunni e agli adulti che si sono dimostrati bravi attori: Adfele Diodati, Antonella Russo, Chiara

(ec te faqja 16)

Jeta Arbëreshe

Trimestrale di Cultura e Informazione Arbëreshe, in Italia e nel Mondo

Revistë tremujore e Shoqatës Kulturore "Jeta Arbëreshe", Purçill/Eianina (Cs-Italia)

Drejtor përgjegjës / Direttore responsabile: **Agostino Giordano**
Drejtori, Redaksi dhe Administratë / Direzione, Redazione, Amministrazione: via G.Marconi,30 – 87010 Eianina-Purçill (Cs-Italia)

Tel. 0981-32539 / 340-8452364; e-mail: jetarbreshe@libero.it – <http://digilander.libero.it/jetarbreshe>

Shërbim grafik / Lavoro grafico: Antonio Giordano

Ku shtypet / Stampa: AGM srl, Telefax 0981-491957 – e-mail:

info@agm.calabria.it

Abonime / Abbonamenti: (4 numeri): Italia €30 (Institucjona €60), Europa e America €40

Ku dërgohen turrësët / Versamenti: sul ccp. n.12994760, intestato a: Associazione Culturale "Jeta Arbëreshe" – 87010 Eianina/Purçill (Cs)

Regjistrim / Registrazione: Tribunale di Castrovillari (Cs), nr.4/2001 del 28-12-2001

Artikuj, Dorëshkrime e Fotografji, edhe ndëse s'botohen, nënj jipen prapë /Articoli, Manoscritti e Foto, anche se non pubblicati, non si restituiscono

Drejtorja nënj është përgjegjëse për përmbajtjen e artikujvet të nënshkruar / La Direzione non è responsabile del contenuto degli articoli firmati

Gjithë të drejtat të rezervuara / Tutti i diritti riservati

Pë të mbahet mend Skanderbegu

Maria Assunta Fazzano

koordinatore rrexhonale Sportjele Gjuhësorë të Molizit
kana Munxhufunit (Cb)

Nga vjet, që ta '99, a sprasmja diël të lujit, Shoqata Equites Sancti Millenni Munxhufunit, un' bashk, ta kjo hor a vogël të Mulizit, një spasjat historike pë mbahet mend Skanderbegu. Pë ktë dit, ata të Federacjunës Nacjonal të Lùorit Storike e jo, vinjën ktu pë shërbime kulturore.

Si na i thot Rozelja Sforca, që bë ta nisi shoqatën, simbjtet qeti mbajtur mend gjella Skanderbegut, kur ishi i vogël. Ndramesna shekujt XIV e të par vitrat të XV, ta Shqipëria, invadirtur ta Turkrat, kjeti ujtur ndën Xhuani Kastrioti, prinxhëpi Krujës e jati Xhorxhit.

Xhuani kumbatovi Turkrat dhe Murad i Diti ma shumë forc; ki i mori të katrat fëmijët burra, e ndramesna kta, Xhorxhin. Ki i sprasmi bë ta vajti ta dherat oman e ktu mësovi shumë gjuhura, u bëh burr i mirë, kushtu Turkrat i dhan emrin Iskënder Bej – Prinxhëpi Alesandr ta gjuha turk, si Alesandrin i Madh - e Shqiptart a kanjovën ma Skënderbej. Ashtu kjeti mbajtur mend Munxhufun ta spasjata kulturore që ndurisi njera mbrëmret e u sos ta Llamet, ma ata që a urën bashk, ma di qind veta që rëçëtojnë e që erdhën edhe kana Korinaldo, Venexja e Ravena, ndramesna gjindtrat ma vesh e si të gjegjën e shihjën, e më shumë ma forcën të Presëdendit, Nicola Sette, që ju miton pë mot.

Ndërrimi i Priftrave

(vjen nga faqja 2)

me ritin grek-bizantin thomse ng' i pëlqen jetës katolike e bëhet atë që mëndet për të kundërshtuar të rrojturit e tyre? Kjo isht thomse edhe njëjtër herë një provë latinizimi? Kurse e rikurse historike.

Pra ngë dej të ish shumë më mirë të gjykohej me kartë të zbluluar, përkundra të dredhen zbiset e të bëhen të bëma të fshehura. Prapa këtij ndërrimi vendi ç' i rri? Zbesi ngë isht i lehtë të thuhet.

Në Amerikë kush zotëron jep leje të ndërtohen klishta të reja, në Arbëri kush zotëron kërkon të gorramisënjë klishat që janë, kute lerë ashtu aq probleme të rënda jo vetëm fetare, por edhe më shumë shoqërore, përcë rrohët te një kontekst, ku ndodhen e ngiten me dorë dica vlëra, si nderi i ndryshimit , i pritjes, i zëmbërgjerësisë, i ndihmës njerëzore.

Në sosje urimi që u dua të bënj Kuntisiotëve isht:

“ Jemi trashgimtarët e Skënderbeut, për këtë mos ngrijëm duart te e para pengesë, ecëm çdoherë me krye të lartë, mbahemi fort e ruajëm gjithë ato bëgatëri që na lënë tatëmadrat tanë. Kjo isht histori; e për kush ng' e di, ng' i qëndron të priret tundu e t' e mbësonjë.

Sen. Basilio Giordano

3^a Commissione - Affari Esteri, Emigrazione
Vice Presidente Comitato Italiani all'Estero

Piazza Madama, 1 – 00186 Roma
Tel. (+39) 06.6706.3174 • Fax (+39) 06.6706.6174
basilio.giordano@senato.it • www.basilioigiordano.com

Ogni anno, dal 1999 e in occasione dell'ultima domenica di luglio, l'Associazione Culturale Equites Sancti Millenni di Montecilfone organizza per le vie della cittadina molisana un corteo storico per rievocare la vita del condottiero Giorgio Castriota Skanderbeg, al quale partecipano gruppi della Federazione Italiana Giochi Storici, e non solo. Come testimoniato da Rosella Sforza, fondatrice dell'associazione, quest'anno la rievocazione ha riguardato i momenti cruciali in cui, tra la fine del secolo XIV e i primi decenni del XV, in Albania, occupata dalle forze ottomane, vennero represses le rivolte di Giovanni Castriota, principe di Kruja e padre di Giorgio. Giovanni fu uno dei signori ribelli all'occupazione ottomana contro il sultano Murad II, che infieri in modo pesante su di lui perchè era tra i più forti condottieri avversi all'occupazione. Le forze ottomane presero in ostaggio i quattro figli maschi di Giovanni e tra questi, Giorgio. Alla corte del sultano, quest'ultimo si distinse per capacità ed intelligenza, parlava perfettamente, oltre all'albanese, il greco, il turco, il latino, il bulgaro e il serbo croato. Divenne esperto nell'uso delle armi e di strategia militare, guadagnò la stima e la fiducia del sultano, che gli diede il nome di Iskënder Bej – Principe Alessandro, in turco, alludendo forse al Macedone Alessandro Magno, che gli Albanesi trasformarono in Skënderbej Così è stato rievocato quest'anno a Montecilfone, una passeggiata storica di quattro ore conclusasi a tarda notte in piazza Lame, tra organizzatori, circa 200 tra attori e comparse, provenienti anche da Venezia, Ravenna e Corinaldo. un pubblico entusiasta e attento, e soprattutto tra la dirompenza del presidente dell'Associazione Equites Sancti Millenni, Nicola Sette, che invita tutti per l'edizione del prossimo anno.

(vjen nga faqja 2)

Probabilmente, mons. Tamburrino, estraneo a tutte le vicissitudini del passato, si interessa solo di salvare le apparenze e non si preoccupa di tenere viva l'identità, che sta a cuore a tutti i Contessioti, di un paese, di una minoranza etnica, anche attraverso la spiritualità della propria chiesa con il relativo rispetto e mantenimento delle proprie tradizioni e dei propri usi. La “Chiesa”, oggi come oggi, non ha più bisogno di preti con la “P” maiuscola, formatori di coscienze, ma di prelati che anteppongono l'apparire all'essere; non si accorge che nel suolo italiano la percentuale delle altre credenze “religiose” sempre più va ad aumentare.

A questo punto mi viene spontanea la domanda: la presenza degli Arbëreshë di rito greco-bizantino forse non è ben tollerata nel contesto del mondo cattolico e si fa di tutto per ostacolare la loro esistenza? C'è forse ancora un ulteriore tentativo di latinizzazione? Corsi e ricorsi storici.

Allora sarebbe più dignitoso parlare a carte scoperte, piuttosto che ricorrere a sotterfugi. Che cosa sta dietro a questo trasferimento? La cosa non è facile a dirsi.

In America l'autorità autorizza nuove chiese, nell' Arbëria l'autorità cerca di demolire le chiese esistenti con gravi conseguenze non solo religiose ma anche e soprattutto sociali, in quanto si vive in un contesto basato su determinati valori, quali il rispetto della diversità, dell'accoglienza, della tolleranza e della solidarietà umana.

Questa è storia; e, per chi non la conosce, non gli rimane altro che impararla.

U buar gjithsej ndir kta katunde! Kush ftesin ?

Fjalë kryqi

Lucia Cardamone

ka Shën Sofia (Cs)

Viçenxi Stratikò

ka Ungra (Cs)

Na çë kemi vjеч ishish të mësuar se na shkonej ka koca pir atën çë suçëdirnej ndë katund. E më shum pir shurbiset e Qishs tonë e pir Eparkin. Gjndja gjith muar pjes kur qen të bën tјert Bonsinjūr (na i thomi kēstū Pēpshkut). Ish një suçëdhim çі ng'vjen nga vit. Ç'ahirna shkoj shum mot. Sot jo më! Sot ng'na shkon shum ka koca se është një problem të bonsinjurit ri. E puru është "un evento straordinario". Qe i numnartur një Amministratore Apostollik lëtir nd'Eparkit e Ungris! Një her kish qen skandall o, pir më pak, kishim piejtur "Pse?". Sot jo! Të parin piemi; pstanta ngë dimi kuj mund'i marmmi vesh; prana sikur gjegjin një Gr e vjon nutixjen pse "ng'është pir me mbajtur mend". Ma ftesmi na o ata çë na mësuan kēshtu pir një zet o tridhjet vitra? Na mësuan se "ngi m'shkon ka koca më se aq" çë kur u mbullijtjin ka jeta jasht, çë kur zun të zëfshin, njeri kundir jetrit; pir fēudet e tire të vogil e të mëdhenj; pak desh të dijin ka problemet e tјervet.

Pir si e pēnxonj u, mund thom se dua një Bonsinjūr të zgjedhur ndir zotrat tan, sa mēnjēhere.

Më mir ndose ka B-në të madhe. Ma edhe manu ka b-në të vikir e rri bashk e gjith na, se ti na rrier mir shpirti, mir se na vjen. Ma e t'vinjë!

Ësht virtet se 'u buar gjithsej ndir kta katunde'? Ftesmi na se 'ngë na shkon ka koca fare më gjë'?


Njeri ka t'e bēnjē nj'esam të kushēnxjes pi s'dreqēti! Mund jēt se gjithsej angora 'ng'u buar'. Na qindron një çik pasjun e vjetir çë pret të zgjofet sa të zērë popani. Ma fuqin ka të na e japjin prap.

Jāmu, bilarū! Shini çë kin të bēni!...

SI È' PERSO TUTTO IN QUESTI PAESI! DI CHI È LA COLPA? - Noi che abbiamo una certa età eravamo abituati a una notevole sensibilità verso gli accadimenti del paese. In modo particolare verso le cose del mondo della Chiesa locale, e quindi dell'Eparchia.

Ricorda che ci fu molto interesse quando nominarono all'epoca gli altri Vescovi. Grande partecipazione di popolo ad un evento importante. Erano tempi lontani.

Oggi non più! Oggi si vive il problema del nuovo Vescovo con grande indifferenza. Eppure si tratta di un evento straordinario: è stato nominato un Amministratore Apostolico latino nell' Eparchia di Lungro di rito greco! In altri tempi ciò avrebbe creato scandalo o, perlomeno, ci saremmo chiesti: "Perché?". Oggi no! Prima chiediamo; poi, non sapendo a chi dare ascolto, archiviamo la novità come chi, in un Gr, apprende una notizia cui non dà molta importanza. Ma è colpa nostra o di chi ci ha abituato così per venti o trenta anni? Ci hanno abituato al "non m'importa più di tanto" con la loro chiusura al mondo esterno, la loro litigiosità, le loro competizioni, i loro piccoli-grandi feudi, la loro scarsa



PËR SË GJERI

1. poco
3. molto
5. appena
6. far impazzire
10. ancora , anche
11. nome
13. tosse
14. insieme

PËR SË GJATI

1. pavone
2. zucca
3. moglie
4. insegnare
7. patrigno
8. palmo
9. melograno
12. porcellino



partecipazione ai problemi della gente. Per la mia mentalità, mi permetto di dire che voglio un Vescovo scelto tra i nostri Papàs, al più presto. Meglio se avrà la V maiuscola. Ma, anche se la v sarà minuscola, e sarà a contatto con tutti noi, per il nostro benessere spirituale, ben venga. Ma che venga!

Ma è proprio vero che 'si è perso tutto in questi paesi'? E siamo noi responsabili della nostra apatia?

Qualcuno dovrà pur fare un attento esame di coscienza. Forse non tutto è andato perduto. Ci rimane ancora un po' di passionalità antica, che non aspetta altro che essere risvegliata, per ricominciare.

Forza, ragazzi! Datevi una mossa!...

Një marmur pir Zotin Matrangolo

Angelo Matrangolo

ka Firmoza (Cs)

Njëzet e nëndë të gushtit Firmozë është festë e madhe, është Shinjanji (Shën Janji Pagëzor), ai që tha të drejtin e i pren kocin: kështu thonë firmoziotët. Simbjet sindku desh se kësaj festë t'i shtofej njetir festë; menatëvet u tha Mesha e pra duall Shënji e ndir udhët ku shkonej vinej adhur mishin ndë lëngut, ndë furrit o të pjekur ndë hellit, e më të shumtë farrojnë se ishin prapa Shënjitit e lëjnë të këndojnë e lipijnë buzin. Mesditë ishin gjithë më triasë, hëngëtin mënjehere pse pra ish jetra festë: ajo e zotit.

Si është zakona, u nistin ka Kroj Pjak me fjamuret e vanë pirpara qishës, ku Sindku zbuloi një marmur që mban mend Zotin Viçenx Matrangolo, prifti e bekoj e pra hytin mbë qishë. Shumë ishin burrat e politikës, më pak prifrat e Eparkisë tonë, shumë gjindë, shumë ishin ata e ato që njoftin kit Zot, që qe ndi kit jetë martëriu i Krishtit.

Foli avukat Giuseppe Capparelli e rrefyejti jetin e Zotit, gjithë atën që ai bëri e se sa shurbei pir vreshtin e Tynzotit, e shumë vetave i dualltin lotët e i lagëtin faqet. Nganjë doj të mirr fjalën e të thonej gjë; ata që patin si të fjisjin, thanë shurbise të dreqta, se si i thoi Shinjanji.

Zoti ish, qe e është, pir qishin e pir Firmozin, një dritë shpirtërore, që me lutjet e të bënurat e tij na dritësoi gjithë neve. Ai shurbei pir të nëmurit, pir murgjit, pir të shkretët, pir të lëshuarit, pir paprindrit: shurbei... pir Tynzot. Mbrëmavet tek sheshi pirpara qishës, Grupi i Konservatorit të Kosencës, mbajti një concert pir nderin e Zotit Viçenx Matrangolo me muzikë klasike. Gjithë dita shkoi ture mbajtur mend se ata që bëjnë shurbise që i pilqejnë Zotit i mbami fort ndë zëmir.

UNA LAPIDE PER PAPAS MATRANGOLO - Il 29 agosto, ad Acquafornosa, è festa grande: è San Giovanni Battista, quello che disse la verità e gli tagliarono la testa, così dicono gli acquafornosmitani. Quest'anno il sindaco ha voluto che a questa festa se ne aggiungesse un'altra: la mattina si è celebrata la Messa e poi è uscito il Santo, e per le strade dove passava, veniva odore di carne al sugo, al forno o arrostito allo spiedo, e la maggior parte della gente dimenticava di essere appresso al Santo e lasciavano il canto per leccarsi le labbra. A mezzogiorno erano tutti a tavola, mangiarono presto, perché poi c'era l'altra festa: quella del parroco. Com'è tradizione, sono partiti dalla Fontana Vecchia con le bandiere e sono andati davanti alla Chiesa, dove il Sindaco ha scoperto una lapide che ricorda papas Vincenzo Matrangolo, il prete l'ha benedetto e poi sono entrati in Chiesa. Molti erano gli uomini politici, di meno i preti della nostra Eparchia, molta gente, molti quelle, e quelle, che conobbero questo Sacerdote, che fu, su questa terra, il testimone di Cristo. Ha parlato l'avvocato Giuseppe Capparelli e ha narrato la vita del papas, tutto ciò che fece e quanto lavorò per la vigna del Signore, e a molte persone sono spuntate le lacrime e hanno bagnato le gote. Ognuno voleva prendere la parola e dire qualcosa; quelli che hanno avuto la possibilità, hanno detto cose giuste, come le diceva San Giovanni. Papas Capparelli era, fu ed è, per la Chiesa e per Acquafornosa, na luce spirituale, che con le sue preghiere e le sue opere ha illuminato tutti noi. Egli lavorò per i poveri, per gli sventurati, per i diseredati, per gli orfani, per i senza genitori: lavorò...per il Signore. La sera, sul piazzale davanti alla Chiesa, il Gruppo del Conservatorio di

Seminari i Prishtinës

Simbjet Seminari XXIX i Prishtinës, i drejtuar ka prof.dr. Liman Matoshi, për Arbëreshët qe ai më i nëmuri. Vet pesë (5) vetë muartin pjesë: Mario Antonello D'Arcangelo ka Kazallveqi (Fg), Gennaro Rizzo ka Purçilli (Cs), protopapasi Ndon Bellushi ka Frasnita (Cs), Anna Fucarino ka Kuntisa (Pa), Agostino Giordano ka Purçilli(Cs). Jo më se 5 (pesë) vetë! Kush ftesën? Ftesjen Arbëreshët që qenë mbitarut/ftuar e s'vanë? O ftesjen organizatorët e Seminarit që i thanë "jo" atyrevet që kërkuan të vejnë? U, me të vërtetë, qindrova lik. Jashtë kufinjvet të Shqipërisë Etnike (Shqipëri e Kosovë, + pjesë të Greqisë, të Maqedonisë, të Malit të Zi, të Serbisë), Arbëria - për Katunde e Folës, për Katedra universitare, për Shkrimtarë e Dijetarë, për Libra e Rivista – sot është e dyta mushkëri e Shqipërisë. Rëndësia e Arbërisë s'ka shokë, jashtë Shqipërisë dhe Kosovës. Megjithatë vet 5 Arbëreshë gjëndëshin Prishtinë. Qenë vitra që Arbëreshët e mbytetin Prishtinën me njerëz : studentë, fëmila të tëra, dijetarë. Simbjet u nga fundi, më poshtë s'mund të veket.

Po numri i bashkëpunëtorëve të "Jetës Arbëreshe" që mbajtin Referime o Kumtesa qe i lartë: *Imri Badallaj* (Format e kohës së ardhme të shqipes në përfaqje me ato të serbishtes), *Tomor Osmani* (Shqipja në Mal të Zi, në sfidat e kohës), *Ina Arapi* (Ndërtimet analitike si mënyrë për formimin e fjalëve të reja në gjuhën shqipe), Bardh Rugova (Qëndrimi folës dhe kohët e foljeve në gazetata e Kosovës), *Majlinda Bregasi* (Gjuha e keqe), *Rrezarta Draçini* (me A.Hoti) (E folmja e Ulqinit dhe ndikimi i kontakteve në këtë areal), *Merita Hysa e Orjeta Baja* (Asimetritë gjuhësore dhe përplasja e kodeve në situatën e bilinguizmit), *Juliana Kume* (Greqizmat në terminologjinë e fesë ortodokse). Të vetmat Referime-kumtesë mbi problematika arbëreshe i mbajtin: *Hamit Xhaferi* (Zef Skiro di Maxho, individualitet dhe krijues i fuqishëm në poezinë bashkëkohore arbëreshe), protopapasi *Ndon Bellushi* (Revista "Lidhja" dhe Kosova e viteve 1980-2000) dhe *Agostino Giordano* (Prije për një farë standardizimi të arbërishtes: kontributi i Emanuill Xhordanit).

Urimet e mia janë për një Seminar ngaherë më të organizuar. Sepse është një vatër e madhe që mbjeth, e ngrohën, gjithë ata që duan vërtetë mirë Gjuhën, Historinë dhe Kulturën Shqipe.

Drejtori

Jeta Arbëreshe

(8 vjet: 2002 - 2009)

64 numra, 1.088 faqe

gjuhë, kulturë e lajme ka Arbëria
e ka Bota Shqiptare

400 euro

(për Istitucionat 600 euro)

Cosenza ha tenuto un Concerto di musica classica in onore del papas Vincenzo Matrangolo. Tutto il giorno è trascorso ricordando che quelli che fanno cose che piacciono al Signore li teniamo stretti forte al cuore.

Katundi im

Nicoletta Russo

ka Farneta (Cs)

Farneta është një katund shumë i vogël, ndoshta një më të vegjlit katund arbresh. Ka pak njeriz, bën ket ndonjë qind, edhe më pak.

U mbraz ndër ata vitra që gjithë nisëshin për të vejin ndër çitatat për të gjëjin llavur , pse këtu s'ish më gjë.

Në vitrat 1960-70 kish pesëqind vetë, pra belu belu iktin gjithë e s'qindroi më njëri, dhe të shumë vdiqin.

Gjithë këta emigrandrat që iktin, ndër pushimet vinjan e shohan katundin e tyre, pse i merr malli.

Farneta është një katund i veçant , ka shpirt të stisura me gur, edhe udhët janë të bënura me pllaka.

Njerëzit që iktin e vanë llargu ndër çitatat janë të kutunjur (kultuar) një herë ndë vitit me një festë "Festa Emigrandvet", që bia nga nëndëmbëdhjetë të gushtit.

Farnetë s'priren vet ata që iktin, po vinjan edhe ata që do të bënjn pushimet llargu ka kamndonjet e fabrikavet: duan të marran ajar të mirë, pra nisen se ka të venë të shurbenjan.

Kur janë pushimet, vinjan edhe njeriz të huaj: ka Austria, Spanja, Shqipëria, Xhermania, etj...

Farneta gjëndet tek një lartësi 880 metrash mbi detin Jon; bia borë e shumë njeriz vinjan se duan ta shohan, se duket si një presep. Të vegjlit dhe të mbëdhenjët bredhan me kokulla borje dhe kanë hare se erdhin.

Katundi Farnetës është i rrethuar ka shpardhet : ka qi arvur merr ëmrin katundi.

Farnetë është një traditë, se kur janë festat luhet ka qaca e, për këtë shkak, vinjan shumë lëtinjë ka katundet afar.

Njetar traditë shumë e përdoruar është të vaturit tue kënduar der mbë der me arganëtin e me karramunxat. Mblidhen di o tre miq, kur ka p'randuar dialli, zën arganetin e karramunxat e ven shpi për shpi; pak e pak mbidhen edhe më. Pas tri sunata që bënjn ka dera, zoti shpisë hapën derën e shkon verë e tarale. Luhet e këndohet gjithë natën, njera kur bëhet ditë.

Farnetë flitet arbërisht, është një e folme shumë e vjetër e shumë e rrallë: atë që sualltin arbëresht gjashtëqind vjet prap.

Farnatizët janë të sjellshëm, shoqërorë dhe të mirë, flasën me gjithë.

IL MIO PAESE - Farneta è un paese molto piccolo, forse uno dei più piccoli paesi albanesi. Ha pochi abitanti, forse 100 o anche meno. Si è spopolato in quegli anni in cui tutti partivano per andare in città in cerca di lavoro, perché Farneta non offriva più niente. Negli anni 1960-70 vi erano 500 anime, poi piano piano il paese si è spopolato e non vi è rimasto più nessuno, molti sono morti. Tutti questi emigrati andati via, durante le vacanze ritornano al loro paese, perché ne hanno nostalgia. Farneta è un paese caratteristico, ha le case costruite in pietra e le strade sono pavimentate con sanpietrini. Le persone emigrate nelle lontane città vengono ricordate una volta all'anno, con la "Festa dell'Emigrante", che ricorre ogni 19 agosto. Il paesino di Farneta non è solo meta degli emigrati, ma anche di coloro che vogliono passare le vacanze lontano dallo smog provocato dalle fabbriche: quindi rigenerarsi e ripartire, perché il lavoro li chiama. Durante le vacanze, vengono anche stranieri: dall'Austria, Spagna,

(ec te faqja 15)

Mëma Tereza Bojaxhiu

protopapas Emanuele Giordano

ka Frasnita (Cs)

Mëma Tereze ish shqiptare: u le në Shkup të Maqedonisë mbë 27/9/1910, ka Kolë e Drame Bojaxhiu. Këta ishin shqiptarë katolikë: e thërritëtin Gonxhe, që vjen me thënë 'Lule'. Ajo u rrit e u edukua ndë një familje të krishterë, besimtare e bulare. Kish një motër, Age, e një vëlla, Lazar. U pagëzua në Shkup. Mësimet e shkollës i bëri në Shkup. Shumë njize ndiejte thirrjen ka Ynzot të bëhej kallogjërëshe; prindëvet i dispëlqei, po e lanë t'i vej pas thirrjes. Kur kish 18 vjet, dish të hynej te kongrega e 'Motravet të Shën Mërisë së Loreto' e u nis ka Shkupi për Dublinin (Irlandë); ku xu gjuhën nglize, e pëstaj u nis për Kalkutën (Indi); atje mbësoi edhe që bënur drejtoreshë shkollje. Pëstaj ndiet një thirrje të dytë ka Ynzot, që doj se kish të jipej me më të nëmurit e të sëmurët. I lipi krerëvet (peshkopit dhe Papës) se doj të lirenej kongregën e 'Motravet të Loreto' e t'ish e lirë të shërbenej ndë mes të atyre. Roma i tha se ëh, e ajo zu e u shërbei me të nëmurit, të sëmurët ç'ishin po të vdisjen (t'i mbjithë ndër udhët), me lebrozët, me andikapët, me të vigjlit të lëshuar udhëvet, me llavëçkat, me të sëmurmit e Aids, me të harruarit, me të dejturit.

Sot, te gjithë Bota, janë hapët 112 shpi misjonare të Mëmës Tereze, 46.000 shpi me lebrozë. 1450 janë motrat e saj misjonare. Të parët fjalë të saja ishin: Besë, Dashuri e të Bëna: domethënë "jetë e sakrifikuar".

Thoj: Unë jam vegël ndër duart e T'Ynzoti"; edhe: "S'jam më u, po është Krishti që shërben tek u"(Shën Pali); edhe: "Zëmra ime është e tërë e Zotit Jisu"; edhe:"U dua mirë njerëzit, se jam e dashur mirë ka Ynzot".

E për 'bashkimin e njerëzvet' thoj: "Kur të rregjeronjë Dashuria te jeta, ahiera do të bëhet njësia e Qishës dhe e tërë jetës. (...) Rinia dhe njeriu sot janë të lodhur fjalësh, duan të shohën puna të vërteta e martri konkrete të Besës. (...) Ndëse na kemi zëmërën e ndërgegjijen të pastërta e të dëlira, kemi ka Ynzot çdo i lipmi".

Shqipërinë e kish mbë zëmër dhe parkalesnej gjithmonë për të, Atdheun e saj. Thoj hapët: "Jam shqiptare po shteti im është India! Unë jam motër katolike, për thirrje, po jam 'e tërë jetës', se për mua gjithë njerëzit janë vëllezërit e mi, se janë gjithë bil të t'Ynzoti. Shqipëria, Dhë i vogël dhe i bjerrë ndë mes të shtetëvet të mbëdhenj, u bë shumë i njohur dhe i admiruar për Mëmën Tereze. E për Shqipërinë, që pësonëj nën komunizmin ateist, thoj: "Nani e xura sepse kam të pësonj: se të priret Zoti Krisht ndë Shqipëri!".

Mëma Tereze u bë 'Mëma e njerëzimit': sepse, për 'të, të Krishterë, Ebrej, Muslimanë, Induistë, Budistë, Ateistë... nënj janë ndryshe njëri ka jetri, janë gjithë bil të T'Ynzoti.

Kur i thojn "Ruaj shëndetën tënde, se je e sëmurë", përgjegjje: "Për shëndetën time është kush kujdeset: Ynzot".

Kur i qasej dita e vdekjes thoj: "Dëshirova, te gjithë jeta ime, të priresha, e shpejt, te shpia e Atit, e nani dëshironj të jem e varrosur 'ndë mes të të nëmurvet', që u ndiha e shërbeva te jeta ime".

Jeta e shërbimi i Mëmës Terezë është, për gjithë ne, një shembull për me imituar.

Njerëzimi e Qisha le të xënë ka ajo, si ajo xu ka Zoti Krisht e ka Shën Pali; e Jeta e Qisha do të kenë bashkim, paqë, përparim.

E Mëma Tereze të mirët që i bëri njerëzvet, në lypsjet e tyre, do t'e bënjë edhe sot ka Parrajsi, ku Krishti e thërriti: ajo parkalesën për gjithë.

Poezi e Lutje të Gonxhe-s Bojaxhiu

Gjej kohë

Gjej kohë për të menduar - është burimi i fuqisë.

Gjej kohë për t'u lutur - është në botë më e madhja fuqi.

Gjej kohë për të qeshur - është muzika e shpirtit.

Gjej kohë për lojë - është fshehtësia e rinisë.

Gjej kohë për të dashur - është dhurata e Hyjnisë.

Gjej kohë për t'u dhuruar - është ngadhnjimi i dashurisë.

Gjej kohë për të lexuar - është burimi i urtisë.

Gjej kohë për t'u shoqëruar - është rruga e lumturisë.

Gjej kohë për të punuar - është çmimi i ardhmërisë.

Gjej kohë për të bërë mirë - është çelësi që të shpie në Qiell.

TROVA IL TEMPO – Trova il tempo per pensare: è la fonte della forza / Trova il tempo per pregare: è la più grande forza sulla terra / Trova il tempo per ridere: è la musica dello spirito / Trova il tempo per giocare: è il segreto della giovinezza / Trova il tempo per amare: è il dono di Dio / Trova il tempo per donarti: è la vittoria dell'amore / Trova il tempo per leggere: è la fonte della saggezza / Trova il tempo per socializzare: è la strada della felicità / Trova il tempo per lavorare: è il prezzo del futuro / Trova il tempo per fare del bene: è la chiave che ti porta in Paradiso.

S'ka rëndësi

Njeriu është i paarsyshëm, i palogjikshëm, egocentrik
S'ka rëndësi, duaje!

Nëse bën mirë, do të thonë e bën për qëllime egoistike
S'ka rëndësi, bëj mirë!
Nëse zbaton qëllimet e tua, do të gjesh miq të rrejshëm dhe armiq të vërtetë
S'ka rëndësi, zbatol!

Të mirën që e bën, nesër do të harrohet
S'ka rëndësi, bëj mirë!

Nderi dhe çiltërsia do të bëjnë të lëndueshëm,

S'ka rëndësi. Ji i çiltër dhe i ndershëm!

Atë që ke ndërtuar vite me radhë, mund të rrënohet fill

S'ka rëndësi. Ndërto!

Nëse i ndihmon njerzit, do të hidhërohen

S'ka rëndësi, ndihmoi!

Jepja botës pjesën më të mirë të vetvetës, do të shqelmojnë!

S'ka rëndësi, jepe pjesën më të mirë të vetvetës!

NON IMPORTA - L'uomo è irragionevole, illogico, egocentrico: / non importa, amalo / Se fai il bene, ti attribuiranno secondi fini egoistici: / non importa, fa' il bene / Se realizzi i tuoi obiettivi, troverai falsi amici e veri nemici: / non importa, realizzali / Il bene che fai verrà domani dimenticato: / non importa, fa' il bene / L'onestà e la sincerità ti rendono vulnerabile: / non importa, sii franco e onesto / Quello che per anni hai costruito può essere distrutto in un attimo: / non importa, costruisci / Se aiuti la gente, se ne risentirà: / non importa, aiutala / Da' al mondo il meglio di te, e ti prenderanno a calci: / non importa, da' il meglio di te.

Jeta

Jeta është mundësi, përfito nga ajo.

Jeta është e bukur, adhuroje.

Jeta është ëndërr, jetoje.

Jeta është sfidë, përballu me të.

Jeta është loje, luaje.

Jeta është detyrë, plotësoje.

Jeta është e shtrenjtë, vlerësoje.

Jeta është pasuri, ruaje.

Jeta është dashuri, shijoje.

Jeta është mister, zbulojë.

Jeta është dhimbje, sfidoje.

Jeta është këngë, këndoje.

Jeta është tragjedi, shmàngiu.

Jeta është fat, përfito.

Jeta është aventurë, kujdes.

Jeta është shumë e çmuar, duaje.

Jeta është luftë, mësohu dhe me të.

Jeta është jetë, lufto për të..."

LA VITA - La vita è un'opportunità, cogliila / La vita è bella, adoralala / La vita è sogno, vivila / La vita è sfida, affrontala / La vita è gioco, giocala / La vita è dovere, adempila / La vita è preziosa, apprezzala / La vita è ricchezza, difendila / La vita è amore, gustala / La vita è mistero, scoprila / La vita è dolore, sfidala / La vita è canto, cantala / La vita è tragedia, evitala / La vita è fortuna, approfittane / La vita è avventura, fa' attenzione / La vita è molto preziosa, amala / La vita è lotta, assuefati a lei / La vita è vita, difendila.

Lutje

Për Shqipërinë time

E tronditur jam
e u trondit gjithë vendi im
i mrekullueshëm.

Më dhemb zemra
për jetët e humbura.
Plagë mëhapin
plagët e njerëzve.

I kuptoj andrrallat
kur humbin paratë,
por unë ju përgjerohem:
mos i sillni vuajtje edhe më njeri-
tjetrit!

E di pse s'kemi paqe tani?
Kemi harruar të shohim
te jetri vetveten.

Që armët dhe bombat
të jenë të zbulojmë
Zotin.

PREGHIERA - PER LA MIA ALBANIA
- Sono turbata / e si è turbato tutto il mio Paese / meraviglioso. / Mi duole il cuore / per le vite perse. / Piaghe mi aprono / le piaghe degli uomini. / Capisco le preoccupazioni / quando perdono i soldi, / ma io vi prego: / non provocate sofferenze anche maggiori l'un l'altro! / Lo sai perchè non abbiamo pace ora? / Abbiamo dimenticato di vedere, nell'altro, noi stessi. / Che le armi e le bombe / siano inutili, / e che nel nostro vicino possiamo scoprire / il Signore.

L ë m i

(vjen ka numri 66)

Giuseppe Chiaffitelli

ka Mashqiti (Pz)

I sprasmi kish bëj të mos mbetij grurët ta kashta. Kur hjdhjan, një grua o një djal, ma një “rrastjel” të lehtë, tilqij e nxirrij nga “masa” grurit kallinj o pjesa kallinjësh të mbetur pa shtipur. Ma një lopatë druri “mundunòjan” e hjdhjan grurët a masës pë të i nxirjan buhoin që ju kish mbetur adhë. Pëstana, ma një dërimon të madh e vjerrë të “triangulli” i bënë nga tre hunjtë lidhur ta ana a lartë, dhërmonisjan grurët që bij nga gavërët a dirimonit e mbi mblihdshin skala më të vogla e koqa gruri të veshura. Grurët a sakëjòjan, a vëjan ndë thastë, di mënaxata (një tumën) a varru o kaçup nga thes. Kashtan a vëjan ndë rjetat që i mbushjan ma një furçil ma katër dhëmb hekuri. Më a liga ish kur kish ngarkoja kashtan ta kali o ta gajdhuri, sa kashta e buhoi të pushtroj gjithë kurmin, të ngjitij te mishtë a dërsijtur nga vapa e të haj. Kur ngarkoja gajdhurat ma kashtë, kisha shtrëngoja mirë qenqlan a samarit anëmos ai shtrëmbij e pririj samarrin e ti kish t’i ngjitja ta rjeti që ngrij o kish t’i ngulja një gur që shumë herë bij përdhë pas pak mot. Vëjan kashtan ta “palërja” e lëjan të lozjan e te kërxejan djelmat sa ashtu nxëj më shumë kashtë. Skalët e pizaturës i shtipjan ma kalin o, ndë ishan pak, i batojin ma një hu o një kopanë. Pas që kishan shtipur gjithë dhomatat, ma një fshiazë spartja fshijjan lëmin pë të mblihdjan ca grurë bashka ma farë barash edhe a shoshjan, a qërojan e atë që mbetij nga të qëruart ja shtian pulëvet. Ta lëmi bëj shumë vapë e nganjari, si kish ca ngë, prëhij ta hjea kazacëvat. Manatën hajën mënestrar çë gratë kishan prënë nga hora, mjesditën bëjan të ngrënë ta lëmi ndë një argomë pranë, o ndë një vend i qëruar mirë nga bari e kallameja, pë trëmbësirë se një vrundull erje a pa pritur shtij zjarrin ta dhomatat. Hajan patafa të diganisura o të ziarë, papadhenë e pumëdhora, fasulina, tumacë ma çimakungul, rizë ma rripul e mëraj të egër. Mbrëman, çë mbetij vetëm burri ma djelmrar, hajan “akuasalin”, i bënë ma pumëdhora të vogla, di thelba hudhrash, një qepë, një karkavecë, një këmbë açi, di pepdhënë të njoma gjithë të prera thelë thelë të holla, valët, ujë, kripë e riganë e bukë të thatë sa më dishën e kishën. Ai çë shtij trecë këndoj, llavdoj e vandoj kuelt a tijë e piyaj ndë ish ndonjë çë dish t’ish ndihur e çarë një faqë pizaturja; e i folij mbë të huaj, pëçë ata kuelt nëng ishan arbëresh e nëng diligojën arbërishtin, se loshrat i gjen këtu ta Itallja kur iktin nga Shqipria.

Nga herë çë më vjen mbë mendë lëmi, mba mendë edhe storjan a Rutës, çë ish a reja a Noemis. Ruta a veja urtë, pas çë kish mbledhur kallinj ndë dherat e Boozit, një kushri i të shoqit vata ta lëmi, si i kish thënë a vjehra çë dish të kish nga ajo një të nip, e u vu natan të flij ndën mandjeli të Boozit, çë prana a vu kurorë e nga ata u le Obedi, tatmadhi Davidit, e pëstana stërloshi Zotit Krisht.

Jeta Arbëreshe

+

Fjalor i Arbëreshëvet t’Italisë

i Emanuele Giordano - s

Euro 50

L’ultimo non doveva far andare il grano nella paglia. Quando ventilavano, una donna o un ragazzo con un rastrello leggero tirava e toglieva dalla massa del grano le spighe e pezzi di spighe rimaste non trebbiate. Con una pala di legno ammuccchiavano e ventilavano il grano della masa per togliere la pula che era rimasta ancora. In seguito, con un crivello grande e appeso al triangolo formato da tre pali legati all’estremità superiore, vagliavano il grano che cadeva dai fori del crivello e sopra restavano le scaglie piccole o chicchi ancora rivestiti.

Mettevano il grano nei sacchi: due mezzetti (un tomolo) rasi o colmi per ogni sacco. La paglia la mettevano nelle reti che riempivano con una forca con quattro denti di ferro. Il peggio era quando caricavi la paglia sul cavallo o sull’asino, perché paglia e pula ti copriva tutto il corpo, si attaccava alla pelle, sudata per il caldo, e ti provocava il prurito. Quando caricavi l’asino con la paglia dovevi stringere bene le cinghie del basto altrimenti pendeva da un lato e rovesciava il basto e tu eri costretto ad appenderli alla rete che si alzava o mettervi una pietra, che spesso cadeva peer terra dopo poco tempo. Mettevano la paglia nella “pagliera” e lasciano giocare e ballare i ragazzi, perché così vi entrava più paglia. Le scaglie di una “pisatura” le tritavano col cavallo o, se erano poche, le battevano con una mazza o un battitoio. Dopo aver trebbiato tutti i covoni, con una scopa di ginestra (sparto?) pulivano l’aia per raccogliere un po’ di grano unito a semi di erbacce e terra, lo setacciavano, lo pulivano e il rimanente lo gettavano alle galline. Nell’aia faceva molto caldo ed ognuno, come aveva un po’ di tempo, si riparava all’ombra dei casazzi. La mattina mangiavano la minestra che le donne avevano portato dal paese; a mezzogiorno preparavo il mangiare nell’aia, in un maggesi vicino o in un posto ben pulito dall’erba e dalla stoppia, per timore che una folata di vento inaspettata spingesse il fuoco verso i covoni. Mangiavano patet fritte o lesse, peperoni e pomodori, fagiolini, tagliatelle con cime di zucche, riso con piselli e finocchio selvatico. La sera, quando restava solo l’uomo con i ragazzi, mangiavano l’“acquasale”, fatto con pomodori piccoli, due spicchi d’aglio, una cipolla, un cetriolo, un gambo di sedano, due peperoni teneri: il tutto tagliato a fette sottili, olio, acqua, sale, origano e pane raffermo, quanto ne volevano e avevano.

Quello che trebbiava cantava, elogiava e vantava i suoi cavalli, e chiedeva se c’era qualcuno che volesse essere aiutato e rotto una faccia di pisatura; e parlava loro in lingua forestiera perché i cavalli non erano albanesi, e non capivano l’albanese perché i nostri avi li trovarono qui in Italia, quando fuggirono dall’Albania.

Ogni volta che mi viene in mente l’aia, ricordo anche la storia di Rut, la nuora di Noemi. Rut, la vedova virtuosa, dopo aver raccolto le spighe nei terreni di Booz, un cugino del marito, andò all’aia, come le aveva detto la suocera che voleva da lei un nipote, e si mise, durante la notte, a dormire sotto il mantello di Booz, che poi la sposò e da loro nacque Obedi, il nonno di Davide, e perciò l’antenato di Nostro Signore Gesù Cristo.

Këngë për fëmijë

(e mbjedhur ka) **Andrea Bellucci**
ka Maqi (Cs)

Kur u leve ti, uratë,
dritësoj gjithë ajo qacë!
Dritësoj edhe shpia
edhe puru gjitonia!
Dritësoj dhe autari
edhe ndrikulla e kumbari.
Dritësuan e bënë spere
dritësuan gjithë ato rrëvëre.
Oj i bukur, oj i bukur,
kur më nget vullar si fjetur.
Malli im, ti bën dritë
për sa dielli mjezditë.
Dielli del e rrëmba shtie
gjithë djalit ndër sit m'i bie.
Rrush i kuq e marvazi,
kush e ka një dial si ti?
Mund m'ecnjen e të kërkonjen
se njetër djali si ti ng'e çonjen.
Eca male, eca dhe,
njetër djali si ti ng'e pé!
Eca male, eca katunde,
ngë të ndërronja për milljune!
Mëma të lan e të pastron
e ndër skollë pra të dërgon.
Të dërgon ndër skollë Romë
të m'i marsh di profesjonë:
një mjedhk e një spexjall;
ashtu ke të më vish ti djal.
Pa të ndihur mosnjeri
ke të bëhesh me urteri.
Kur marton mëma këtë,
nga katund më nisen një.
Nisen një, di e tri,
nisen katër o pesë nga shpi.
Shtie një vuxhë ka Frangavila,
nisen trima edhe kopila.
Shtie një vuxhë edhe mbatanë,
nisen sikuforma janë!

Duminku te poça

Vittoria Oliverio
ka Shën Kolli (Kr)

Nj' her ish' nj' pjakarele ç' dehj t'gjejh ng'dondar. Kështu o von
te anti i ders e vrehj kush shkohj. Ka shkue nj' kuçk e i ka thon:
- Pjakarele, ç'jeç bon?
Pjakarela i thot se o von te anti i ders pse do të gjenj nj' dondar.
E kuçka i thot:
- Më do mua?
E pjakarela i thot:
- Vremi si këndon!
Bau, bau bau!
Pjakarela i thot:
- Gjo, ng'më përqehe!
Pra shkon gjeli e i thot pjakarele:
- Ç jeç bon?
Pjakarela i thot se o von te anti i ders pse do të gjenj nj' dondar.
E gjeli i thot:
- Më do mua?
- E pjakarela i thot:
- Vremi si këndon!
- Kikiriki, kikiriki!
Pjakarela i thot:
- Gjo, ng'më përqehe!
Pra shkonjin ujku e qeu, e pjakarela ng'i xjedh.
Gji te nj' her shkon nj' mi e pjakarela:
- Do t'vrenj si këndon? Miu vohet e këndon:
- Xiu, xiu xiuxiu xiuxiu!
- Ne, ne, m'përqehe. T'hres Dum! Hip, hip te shpia, se rrimi
bashk!
Ditin ç'vihj, pjakarela i ka thon Duminkut:
- Vete te qisha, ti mos ec te poça ç'osht te zjarri pse privlohe;
pse jam ç'zie çik mish e kur vinj e hami.
Kur pjakarela ka dal, Duminku dehj të vrehj ç'ish te poça e, si
hipin, bie ka mbronda.
Kur pjakarela o mbiedhu, stret Duminkun e ai ng'i përqeget.
Pjakareles i vihj ui, ka mar poçen e e ka mbrazu te tajuri.
Mbronda longut ka gjetu Duminkun i privluer e vohet e qan!
Gji te nj' her shkon nj' maçe e ja mer, hipin sip te qaramidhet
e e han.
Ç'at hrinja maça ikin prapa miut.

Vjershe malli

(mbjoth) **Salvatore Franco**
ka Ferma (Cs)

Doj t'isha zog i bukur të vullarja
e folenë te gjiri jot u doj t'e bëja

Kuri t'amarja u, m'rrije si lule:
nani m'u thajte si ai fag ndër male.

Kopile, mos e mirr at forxharjël,
se është i zi e t'nxin at skamandil.

E bukur e Shën Mitrit më se hëna,
mos ngi t'marrsha u, m'u bjerrtë furtuna.

Pituri çë t'pitarti ata di si
ju ça piniëli e s'pitaren më.

Pirndoi Pularza e dull illi dits:
pir tij, kopile, shkova pent e jets.

M'u ça garxholla e m'iku thëllëza
e vate paru paru nd'ata quza.

Kaloi në amshim Arkimandriti Arbëresh Eleuterio Fortino

Don Lush Gjergji

Vikar i përgjithshëm i Dioqezës së Kosovës

Më 22 shtator 2010 kaloi në amshim Mons. Eleuterio FORTINO, i cili vite të tëra ishte në dializë për shkak të sëmundjes së veshkëve. Edhe pse i sëmurë, asnjë herë nuk pushoi, gjithnjë ishte në veprim në nder të Zotit, në dobi të Kishës, veçanërisht për dialogun ekumenik mes Kishës Katolike dhe Kishës Ortodokse, si dhe në veprimtaritë baritore në kishën arbëreshe e “Shën Athanasit” në Romë.

Ishte një ndër studjuesit dhe ekspertët më të spikatur të Kishës Katolike për ekumenizëm.

Mons. Eleuterio Fortino u lind në San Benedetto Ullano, në Kalabri, më 2 prill 1938 nga prindër arbëreshë; dhe është vëllau i studjuesit dhe albanologut të njohur prof. Italo Fortino. Pas seminarit dhe studimeve filozofiko-teologjike në Universitetin e famshëm të Gregorianës, më 24 nëntor 1963 qe shuguruar meshtar.

Prej vitit 1965 ka punuar me shumë zell, përkushti dhe dashuri në Këshillin Papnor për Bashkimin e të Krishterëve, i ftuar personalisht nga kardinali Johannes Gerardus Maria Willebrands, ku ka dhënë një kontribut tejet të çmueshëm deri në vdekje.

Për Mons. Eleuter Fortinon ka çka të thuhet dhe të shkruhet, mbi të gjitha për fenë e tij të fortë, shpresën e tij të qartë dhe dashurinë e tij të zjarrtë ndaj Zotit, Kishës, bashkimit të të krishterëve, dialogun ndërjetar, kulturës së tij vërtet të thellë dhe enciklopedike, për zemrën e tij të hapur për çdo njeri.

Më se 25 vite ishte Nën-sekretari i Këshillit Papnor për Bashkimin e të Krishterëve, ku është dalluar gjithnjë për të mirë, për nisje dhe studime të shumta burimore, për përzemësi dhe urti baritore, për kërkim të vazhdueshëm dhe pa kusht të bashkimit të të krishterëve, si thoshte ai “parakusht për të jetuar fenë e krishterë dhe për t’ua dëshmuar atë të gjithë njerëzve vullnetmirë”.

Kohën e fundit qe shpërblyer me disa mirënjohje të rëndësishme, si Rosa d’argento /2007/ për marrëdhëniet mes Vatikanit dhe Kishës Ortodokse, si dhe Shpërblimi Arbëria /2009/ në Shënmitër (San Demetrio Corone).

Këto ditë në shumë mjete pamoro-dëgjimore bëhet një lloj “bilansi” pëpr jetën dhe veprimtarinë e tij shumëdimensionale, dhe të gjithë, pa dallim nga përkatësia fetare, pikëpamja kulturore, qëndrimet botëkuptimore, janë të njëzëshëm në këtë vlerësim: Mons. Fortino ishte “Shpirti, zemra dhe motori i ekumenizmit të Kishës Katolike në dekatat e fundit”.

Në një ndër intervistat e fundit ai kishte thënë kështu: “Dialogu i dashurisë na ndihmon që në tjetrin ta shohim vëllaun tonë dhe në anën tjetër i shkarkon çështjet doktrinare nga ngarkesat e llojllojshme...”.

Mons. Fortino ishte shumë i frytshëm edhe në shkrime dhe botime, duke u nisur prej L’Osservatore Romano e përditshmja zyrtare e Selisë së Shenjtë, e deri te revistat apo gazetat më prestigjioze italiane dhe evropiane. Stili i tij i thjeshtë dhe i rrjedhshëm, qartësia e tij në formulimin e mendimeve, shqyrtimeve, këndvështrimeve, shpirti i tij gjithnjë pozitiv dhe konstruktiv, dëshira e madhe për takime, afrime dhe bashkëpunime, janë disa nga veçoritë e botimeve të tij.

Një kapitull i veçantë është veprimtaria e tij për kultivimin dhe promovimin e gjuhës, traditës dhe kulturës shqipe ndër Arbëreshë dhe më gjerë, të cilën vazhdimisht e pat në mend dhe në zemër. Ishte themelues i Qendrës dhe Fletushkës Besa në Romë, bashkëpunëtor i rregullt në Oriente cristiano. Ka botuar Liturgjia greke /1970/, Kisha bizantine arbëreshe në Kalabri /2000/, Dialogu ekumenik...

Kardinali Kasper ndër të tjera ka thënë për të: “Ishte një njeri i shenjtë, bujar dhe thellësisht i mirë. Dinte të dhuronte gëzim edhe gjatë tri ditëve të javës kur duhet t’i nënshtrohej dializës. Gëzimi i krishterë ishte stili i jetës së tij... Ishte njohës i mirë i teologjisë ortodokse”.

Do ta përfundoj këtë shkrim mbi Mons. Eleuter Fortinon me disa kujtime të mia personale. Së pari e kam takuar në Romë qysh në vitin 1968, në kremtimin e përvjetorit të Gjergj Kastriotit Skënderbeut, dhe prej asaj dite ishte dhe do të mbesë Vëlla-Meshtar shembullor, Njeri i Fesë dhe Kulturës Shqiptare, mikëpritës dhe bujar në çdo kushtim dhe drejtim.

Çdo vizitë që e bënte Imzot Nikë Prela në Romë, në Vatikan, pikënisja e këshillimeve ishte Mons. Fortino. Çdo festim fetar, kishtar, liturgjik, por edhe kulturor kombëtar, po ashtu nismitar dhe organizator ishte ai, si njeri që rrezatonte mirësi, besim, komunikim, që frymëzonte çdo njeri për veprim, apo thënë në termonologjinë e Nënës Tereze, e “jepte dhe e nxjerrte nga çdo njeri pjesën më të mirë të vetvetes”.

Vite të tëra ishte përkrahës dhe bashkëpunëtor i çmuar me revistën tonë fetaro-kulturore Drita si dhe me botimet tona. Më kujtohen recensionet e tija shumë të qëlluara në L’Osservatore Romano për librin e Dr. Don Gaspër Gjinit, Ipeshkvia Shkup-Prizren gjatë shekujve; Bibla complete në gjuhën shqipe; për dhjetë vëllimet Kisha dhe historia e saj; Nëna jonë Tereze; Atenagora: Profet i bashkimit; Nëna e Dashurisë e shumë të tjera.

Atë e patëm derë dhe dritare, për të parë dhe hyrë në qarqet e larta të Vatikanit, të Italisë dhe më gjerë, si për çështje kishtarë, po ashtu edhe kombëtare dhe kulturore. Gëzohej me zemër për çdo nisje, hap, sukses tonë, dhe na përkrahte gjithnjë për të mirën e përbashkët. Për Nënë Tereze ndër të tjera më shkruante kështu: “Nëna Tereze është përfaqësuesja më e mirë e krishtërimit tonë shekullor, e traditës dhe kulturës sonë familjare dhe shoqërore, mirësisë dhe dashurisë flijuese për të gjithë... Në të çdo njeri, aq më tepër çdo shqiptar, mund dhe duhet ta gjejë kuptimin e jetës dhe flijimit, domethënien e vuajtjes dhe amshimit...”.

Para dy muajve ia dërgova botimet Nëna Tereze: Shenjtëresha e Dashurisë; Nëna Tereze: dashuria në veprim dhe Imzot Nikë Prela: Njeriu i Zotit, Kishës dhe Popullit, në gjuhën shqipe dhe italisht. Më falënderoi përzemësisht dhe vëllazërisht për këto dhuratat, si u shpreh ai “shumë të çmuara dhe të qëlluara për ne Shqiptarët, por edhe për të tjerët”. Dhe vazhdoi: “Kisha jonë, populli ynë ka nevojë për paraqitje sa më dinjitoze. Nëna Tereze dhe Imzot Nikë Prela e kanë nderuar dhe begatuar Kishën dhe Popullin Shqiptar...”.

Ja, i tillë ishte Arkimandriti Mons. Fortino, njeri që nga goja dhe zemra gjithnjë derdhte dhe dhuronte urti, mirësi, mbi të gjitha dashuri.

Pushoftë në paqe dhe ndërmjetëssoftë për ne!

(Prishtinë, 24 shtator 2010)

(ec te faqja 25)

Mesha e Shën Vasilit të Math**(Lutjet e priftit, me zë të ulët)****(vjen ka nr. 66)**

(Lutje pas "Mirrni, hani...")

Gjithashtu e mori kupën me frutin e dhrisë, e si e përziejti me ujë dhe falënderoi, e bekoi dhe e shëjtëroi, ja dha dishipulvet dhe Apostulvet të tij të shëjtë, tue thënë:

-Pr.: "Pini prej këtij të gjithë..."

-Pop.: Amin.

Bëni këtë për kujtimin tim; se kurdoherë që t'ë hani këtë bukë dhe t'ë pini këtë kupë, lajmëroni vdekjen time, dhe rrëfyeni ngjalljen time. Prandaj edhe na, o kryezot, tue kujtuar pësimet e tu shpëtimtarë: kryqen jetëbërëse, varrimin e triditshëm, ngjalljen nga të vdekurit, të hipurit ndër qiel, të ulurit ka e djathta e Perëndisë dhe Atit, dhe ardhjen e dyjtë të lavdëruar dhe të trëmbshme.

-Pr.: "Të tuat nga të tuat..."

-Pop.: Të himnojme të bekojmë.....

Prandaj, o kryezot, i tërëshëjtë, edhe na mbëkatarë e shërbëtorë të tu të padenjë, që u vlerësuam të meshojmi përpara alltarit tënd të shëjtë, jo nga drejtësitë tona, se s' kemi bërë asnjë të mirë mbi dhenë, po nga mëshirat e lipisitë, që derdhe dorëgjërisht mbi ne, guxojmi e i afrohem tryesës sate të shëjtë e, tue dhuruar simbolet e kurmit e të gjakut të Krishtit tënd, të parkalesmi e të lutemi, o shëjt i shëjtravet, të urdhërosh, me mirësinë tënde, të vinjë Shpirti yt i Shëjtë mbi ne e mbi dhuratat që janë këtu përpara, se t'i bekonjë, t'i shëjtëronjë.

Dhe bëje këtë bukë kurmin e vetëm të çmuar të Zotit dhe Perëndisë dhe shpëtimtarit tonë Jisu Krisht. Amin. Dhe bëje këtë kupë gjakun e vetëm të çmuar të Zotit dhe Perëndisë dhe shpëtimtarit tonë Jisu Krisht. Amin. Çë derdhet për jetën e botës. Amin. Tue i ndërruar me anën e Shpirtit tënd të Shëjtë. Amin, Amin, Amin.

Edhe na, të gjithë, që marrim pjesë ka një bukë dhe ka një kupë, bashkona njerin me jatin në shoqërinë e Shpirtit Shëjtë, dhe mosnjë ndër ne të marrë pjesë te kurmi i shëjtë e te gjaku i Krishtit tënd, mbë gjykim o dënim, po vlerësona të gjëjmi hir dhe lipisi, bashkë me gjithë shëjtravet që të kanë pëlqyer që prej shekulvet: Parapindët, Etërit, Patriarkët, Profitët, Apostulit, Predikatorët, Vangjeltarët, Martirët, Rrëfyesit, Mësonjësit, dhe çdo shpirt të drejtë, që mbaroi jetën me besë.

-Pr.: "Më se më, të dhurojmi..."

-Pop.: Mbi Tyj gëzohet...(te Kreshmet); Në darkën tënde mistike (të Enjten e madhe), Le të qetet çdo kurm...(të Shtunën e Madhe)

O Zot, bëj të gjëmi lipisi e hir për Profitin prodhromin dhe pagëzorin shën Janj, për apostulit e shëjtë, të lavdëruar dhe ëmërshkëlqyer, për shëjtin (e ditës), kujtimin e të cilit po

bëjmi sot, dhe të gjithë shëjtravet. Për lutjet e tyre, ruajna, o Perëndi.

Dhe kujto, o Zot, gjithë ata që kanë ndërruar jetë me shpresë ngjallje, për jetën e pasosme. *(Këtu prifti kujton të vdekurit që do)*. E bën të prehen ku shkëlqen drita e faqes sate.

Adhe të lutemi: kujto, o Zot, Qishën tënde të shëjtë katolike dhe Apostolike ka të katër anët e botës, e ruaje mbë paqë atë, që e blejte me gjakun e shtrëjtë të Krishtit tënd; e siguroje këtë qishë të shëjtë njera në mbarimin e jetës.

Kujtohu, o Zot, për ata që të sualltin këto dhuratat dhe për ata të gjithë për të cilët u dhuruan; kujtohu për ata që i sjellën frut qishavet të tua të shëjta, dhe për ata që kujdesen për të nëmurit: paguaji me dhuratat e tua të bëgata e qiellore, jipi atyre qielloret për të dheshmet, të përjetshmet për të përmotshmet, të pagrisurat për të grisurat.

Kujto, o Zot, ata që jetojnë ndër shkretitë dhe ndër malet e ndër shpellat edhe ndër gropat e dheut; kujtohu, o Zot, për ata që rrojën jetën e tyre të nderusur ndë virgjëri, për të devotshmit, për asqetinjtë.

Kujtohu, o zot, për qeveritarët tanë, të devotshëm dhe besëmirë, kujve i ke dhënë të drejtën të rregullojnë të bëmat e dheut. Kurorëzoi me fuqinë e së vërtetës e të mirëdashjes, dhe vëri nën hjenë e tyre gjithë popullit barbarë që duan lufta; jipi atyre paqë të vërtetë e të gjatë; frymëzoi tek zëmrat e tyre të mirën e Qishës sate e të gjithë popullit tënd. Ashtu që edhe na, në paqen e tyre, të shkojmi një jetë me çdo poni dhe dinjitet, me qetësi, me shpresë e me nderë.

Kujtohu, o Zot, për gjithë krerët e udhëtuesit tanë, për ushtëritë e anijesitë e tyre, ruaji të mirët në mirësinë tënde, të liqtë bëji të mirë, me lipisinë tënde.

Kujtohu, o Zot, për popullin që rri rreth dhe për ata që nëng janë këtu, për shkaqe të drejtë, lipisi ata edhe neve, pas meshirës sate të madhe; mbloji shpëtë e tyre me gjithë të mirat; ruaji martesat e tyre në paqë e në armoni; rriti bilzit, mësoje dialërinë, fortëroje pleqërinë, eci pas shpirtvëgjëlvet, mblidhi të shprishurit, priri të llarguarit, dhe bashkoji me Qishën tënde të shëjtë, katolike dhe apostolike; liroji ata që janë të zënë ka djeltë, lundrë me lundronjësit, udhëtë me udhëtonjësit, ndihni të vejat, përkrahi të varfërit, shpëtoji filiaqirët; kujtohu për ata që kanë të gjykohen ose janë të shtrënguar ndë shërbime të forcuar, të reshturit, dhe ata të vënë në shkllavëri e që gjenden në çdo pësim, shtrëngim, dhe angim; për gjithë ata që lypjen lipisinë tënde të madhe.

Kujtohu, o Zot, për ata që na duan mirë dhe për ata që na duan lik, për ata që na lypsin neve, të padenjë, të parkalesmi për ata e për të tërë popullin; dhe mbi të gjithë derth burimin e mëshirës sate e gjegji kërkesat për shpëtimin.

Kujtohu, o Zot, edhe për ata që nëng i kemi kujtuar, nga padija jonë, nga harrimi o nga shumica e ëmravet. Ti, të çdonjëi, njeh vitrat e ëmrin, që nga të lerit e tyre; sepse ti je ndihma i nevojtarëvet, shpresa e të dëshpëruarvet, shpëtimtari i dimëronjësvet, porti i lundronjësvet, jatroi i të smurëvet. Ti jipi gjithësej i të gjithve për të gjitha, sepse ti i njeh nganjë dhe kërkesat e tij, e famlijen e tij e të duhurat e tija.

(ec te jetra faqe)

Liroje, o Zot, këtë katund e çdo qytet e katund, nga uria, nga zia, nga ethja e ligë, nga tundja e dheut, nga përmbytja, nga zjarri, nga shpata, nga ndërhyrja me fuqi e të huajvet, nga lufta vëllazërore dhe nga vdekja e papritur.

Pr.: Më parë kujtò, o Zot, kryepeshkopin tonë...
Pop.: Dhe të gjithë e të gjitha

Kujtohu, o Zot, për çdo Peshkopatë orthodoxe, që predhikon drejtësisht fjalën e së vërtetës sate. Kujtohu, o Zot, edhe për pavlerësinë time, me shumicën e lipisivet të tua; ndëlemë çdo mëkat të dashur e të padashur, dhe mos e nxir hirin e Shpirtin e Shëjtë nga dhuratat e vëna këtu përpara, për shkak të mëkatëve të mi. Kujtohu, o Zot, për priftërinë, dhjakoninë mbë Krishtin edhe për çdo urdhër priftëror, dhe mos e turpëro mosnjë ndër ne, që rri rreth altarit tënd të shëjtë. Vizitona në mirëdashjen tënde, o Zot. Buttohu neve në lipisite e tua të shumta, jipna neve erë të buta dhe shira të qeta për dheun që të sjellë frutë. Beko kurorën e vitit të mirëdashjes sate.

Paqësò ndarjet e qishavet, shuaji tërbimet e paganëve, shtypi shpejt të ngrëjturit e Eresivet me fuqinë e Shpirtit tënd të Shëjtë. Pritna gjithëve në rregjërinë tënde dhe bëjna bil të dritës e bil të ditës. Jipna paqen tënde, e dashurinë tënde, o Zot, Perëndia ynë, Ti që na i dhe të gjitha.

Pr: Dhe jipna se me një golë e me një zëmër.....
Prifti: Dhe qofshin lipisite e Perëndisë.....
Dhjakoni: Pra që kujtuam gjithë shëjtrat.....
Pop.: Lipisi, o Zot.....

O Perëndia ynë, Perëndi i shpëtimit, ti mbësona të të falënderojmi denjësisht, ashtu si të ka hje për të mirat, që na bëre dhe që na bën.

Ti, o Perëndia ynë, që u denjove të prisje mirë këto dhurata, pastrona të gjitha njollat e kurmit dhe të shpirtit, e mbësona të praktikojmi shëjtërinë me trëmbësinë tënde, ashtu që, me martërinë e pastër të ndërgjegjjes sonë, të marrmi pjesë te dhuratat e shëjta dhe të bashkohemi me kurmin dhe gjakun e shëjtë të Krishtit tënd; dhe, si i muartim vlerësisht, mund t'ë kemi Krishtin që rri ndër zëmrat tona, dhe të bëhemi tempull i Shpirtit Shëjtë.

Ëh, o Perëndia ynë, mosnjë ndër ne u bëftë fajtor të këtyre mistereve të trëmbshëm e përmbiqiellorë, e mosnjëri u sëmurtë te shpirti e te kurmi, ndëse u kungua me ata padenjësisht; po bëna të denjë, njera sa të kemi frymë, të marrmi pjesë vlerësisht te dhuratat e tua të shëjta, si udhëtim për jetën e pasosme, si mbrojtës të mirëpritur përpara tribunallit të trëmbshëm të Krishtit tënd; se kështu edhe na, bashkë me gjithë shëjtrat e tu, që të gëzuan prej shekujvet, të bëhemi pjesëtarë të lumturivet qiellorë, të përgatitura për ata që të duan mirë, o Zot.

Dhjakoni: Tue kujtuar gjithë shëjtrat.....
Pop.: Lipisi, o Zot.
Prifti: Dhe vlerësona o kryezot.....
Pop.: Aty ynë që je ndër qiel.....
Dhjakoni: Krerët tuaj uljani Zotit.
Pop.: Tyj, o Zot.

O kryezot, o At i lipisivet, dhe Perëndi i ngushëllimevet, bekoji ata që të kanë ulur kryet: shëjtëroji, ruaji, mbroji, fortëroji, llargoji ka çdo e bëmje e ligë, bashkoji me çdo të bëmje të mirë; dhe vlerësoji të marrën pjesë, pa dënim, te misteret e tu të delirë dhe jetëberëse, për ndjesën e mbëkatëve dhe për bashkësinë e Shpirtit Shëjtë.

Pr: Me hirin dhe dhëmsuritë dhe mirësinë e birit tënd...

Ruajna, o Zoti Jisu Krisht, Perëndia ynë, nga ndënija jote e shëjtë... (shih 'Liturgia di S Giovanni Crisostomo', faqe 89)

(Lutja përpara Ikonës së Zotit Krisht)

O Zoti Jisu Krisht, Perëndia ynë, që mbleth, ka ata që të parkalesjën e të thërresën me gjithë zëmër, këtë therore shpirtërore e të pagjakshme, si therore lavdërimi e si adhurim i këndshëm. Ti je shtjerri dhe i Biri i Perëndisë, ai që nxir mbëkatit e jetës; viçi i pafajshëm, që s'mban ziguan e mbëkatit e që për ne vullnetarisht jep jetën. Ti je ai që çahet po s'ndahet, ahahet po s'griset, e shëjtëron ata që tagjisen me tij. Ti, për kujtim të durimevet të dashur dhe të gjallëruasës ringjallje tek e trejta ditë, na bëre të denjë të mirrjim pjesë te misteret e tu të pathënshtëm, qiellorë dhe të trëmbshëm të kurmit tënd të shëjtë e të gjakut tënd të shtrënjtë. Ruajna, në shëjtërinë tënde, neve shërbëtorët e tu, qeveritarët tanë dhe popullin që rri këtu përpara. Dhe jipna, te çdo mot e çdo moment, të mejtojmi drejtësinë tënde; se, të shtyjtur ka vëllima jote e tue bërë atë që të pëlqen tij, bëhemi të denjë të rrimi ka e djathta jote, kur të vish të gjykosht të gjallët e të vdekurit. Lirò vëllëzërit tanë, që janë ndër filaqi; prir sytë mbi ata që durojën ndër sëmundjet; udhëtò me ata që gjënden ndër rreziqet e detit; e jipi prëhjen atyre që u qëlluan, te shpresa e ringjalljes, atje ku shkëlqen drita e faqes sate. Gjegji ata që lypjën ndihmen tënde. Sepse ti je ai që dhuron të mirat, e na të japmi lavdi, Tij, bashkë me Atin tënd të përjetshëm, dhe Shpirtit tënd të tërëshëjtë, të mirë dhe jetëdhënës, nani e përherë e në jetët e jetëvevet. Amin.

Katundi im

(vjen ka faqja 8)

Albania, Germania.

Farneta si trova ad un'altitudine di 880 metri sul mare Jonio; nevica e molti vengono a visitarla perché assomiglia ad un presepe. Bambini e grandi giocano a palle di neve, si divertono e sono contenti di esserci venuti. Il paese di Farneta è circondato dalle farnie, ed è da quest'albero che prende il nome. A Farneta vi è un'usanza: quando ci sono le feste, si balla in piazza; è per questo motivo che vengono molte persone dai paesi vicini. Un'altra usanza molto in voga è la serenata fatta a suon di organetto e di zampogne, di casa in casa. Si riuniscono due o tre amici, dopo il tramonto del sole: prendono l'organetto e le zampogne e vanno di casa in casa, e pian piano se ne aggregano altri; e dopo la terza suonata il padrone di casa apre la porta e offre loro vino e taralli. Si balla e si canta tutta la notte fino al nuovo sorgere del sole. A Farneta si parla l'albanese, una parlata arcaica e rara, quelli che gli Arbëreshë portarono seicento anni fa. I Farnetani sono educati, socievoli, buoni, e parlano con tutti.

Zhaneta Ogranaja - Habazaj

Dua vullnetin Tuaj të bukur

Pikërisht, për ju Arbëresh të dashur po shkruaj sot
Me një dëshirë që t'ju them sa ju dua
Dua vullnetin tuaj si vegim të rrallë e të bukur që keni treguar nga moti në mot
Ky fakt shpresa e gëzim sjell, tek poeti, tek mua

Po. Ndër të gjitha ndej se shqiptar ke mbetur arbëresh ti
Sidomos me gjuhën e bukur shqipe që flet e shkruan ende
Përplot krenari e shpresë më mbush kjo dashuri
Ju mbi pesëqind vjet, matanë në Itali mendoni për Shqipërinë, këtë atdhe

Medet, keni psherëtirë, qarë e rënkuar
Për Shqipërinë e për shqiptarë në mërgim matanë
Ju na keni ndërjet të afërm përherë, edhe duke na poetizuar
Kur larg nesh rronit, na kishit përmallim në shpirt, brenda brengë kaq pranë

Që nuk na keni harruar, o sa jam e gëzuar
Nga sytë tani më ranë një rrëke lot
Për këtë “refren të kobshëm” që si pelegrinë ne rrimë botës duke fluturuar
Kur s'na mungon asgjë, zemrën plot brengë e vrer e kam për mërgatat edhe sot

Tërë një jetë më qanë këta sy mua
Elegjinë e mërgimit si bilbili edhe në kafaz e kam ligjëruar
Medet, se asnjëri nuk mund të gëzojë dot, jo, mua
Zemrën e shkretë sot, gjersa secili do të largohet, o arbëresh, edhe ky sot pelegrin
tamam si ty

E, ja, edhe sot si atë mot nga Shqipëria shqiptari u tret, duke u larguar
Si mërgatë e vjetër, mërgatë e re zë fill
Nëpër foletë e të tjerëve ngrënë çerdhe e jetë
Në vend që bukuritë e pasuritë tona çdo shqiptar t'i përfill

“Shkojmë në udhë të Zotit”, - thonë
Kështu, ashtu Shqipërisë i kanë munguar bijtë e vet
Shqipëria s'ka patur fuqi si të tjerët gjer më sot deri tani vonë
Se bijtë e vet s'janë gjendur, i ikin dhe e lenë krejt vetë

Arbëresh i dashur, nga larg dëgjoma ti këtë brengë
Këngën për braktisjen kur Atdheu është si kopësht përrallor
Nga tërë mërgatat dje, sot zemrën e kam plot brengë
Nga që kam qëllim e dëshirë që Shqipërisë mërgimin, asimilimin mos i vëmë kurorë

Tani nga zemra ime nxorra një psherëtimë
Sepse unë për Shqipërinë këtë soj mërgimi s'e dua, sa dua për të lumturinë e dashurinë
S'ka sepse nga bota të presë si dikur. Të presë mëshirë
Dhe s'ka sepse natyrisht, gjersa me bukuri e pasuri si tërë bota, kjo e ka gjinë!

Spixanë: 1860-2010

(vjen ka faqja 4)

e Federica Mostaccio, Daniela Carfora, Franca De Rosis, Lina Bellusci, Antonella Russo, Daniela Bosco, Ferdinando Toma, Francesco Manna, Antonio G. Spingola, Giuseppe D'Ambrà, Giuseppe De Marco, Luca De Marco, Rocco Gallucci, Vincenzo Barbati, Vincenzo Genovese. Infine, ma non perchè meno importante, un grazie particolare alla dr.ssa Rosina Costabile, direttrice scolastica, che, con decisione, forza e sentimento, si è dimostrata un'arbëreshe autentica e sveglia, che ha visto e chiesto come procedeva il Progetto giorno per giorno.

Lek Pervizi

Mirëdita

Sa e bukur ishe
vashëza ime
e bukur si një zanë mali
a e mban mend atë ditë
plot diell
plot ngjyra
plot erëza lulesh
plot kangë zogjësh
a e mban mend ?

hyjnore
jo ndryshe Afërdita
e tejdukshme
engjëllore
sytë që shkelqenin
ma shume se një yll
me atë trup të derdhun
nga nje artist hyjnor
një Praksitel

nën hijen e ulla
erdhe e me takove
e buzëqeshun
sa e bukur ishe
moj vashëza ime
me pershendete
me the vetëm
mirëdita !

Falënderit, Liri !

Liri
ti meriton
prej meje
mirënjohje të madhe
dhe e meriton
prej gjithë atyne
që vyejten
që u flijuen
për ty

prej gjithë atyne
që luftuen
si heronj
që vdiqen
te pafajshëm
me emnin tand në gojë
Liri !

*Poezi të nxjerra nga: Lek Përvizi, Petalo di rosa – poesie in lingua italiana-albanese, Edizioni “Lampi di Stampa” Milano, 2009.

Bota poetike e Buzëdhelprit

dr. prof. Klara Kodra

Universiteti i Tiranës

Poezia e Agostin Jordani (Buzëdhelprit) spikat me ngjyrat e veta në panoramën e sotme të poezisë arbëreshe e cila vërtet nuk dallohet për një hierarki letrare të qartë si poezia arbëreshe e shekullit të nëntëmbëdhjetë, po numëron individualitete të ndryshme letrare me veçanësinë e tyre.

Agostin Jordani shfaqet si poet i problematikës sociale, që është i ndieshëm ndaj plagëve shoqërore të bashkësisë arbëreshe si papunësia dhe emigracioni, i zbulon dhe i denoncon ato. Poeti i pasqyron ato plagë me objektivitet, po edhe me një pjesëmarrje të pasionuar duke shprehur dhimbjen dhe revoltën e vet.

Me gjithë prirjen sociale të poezisë së tij, lëndën e gjallë që e merr nga realiteti i sotëm arbëresh poeti e mbruan nëpërmjet lirizmit, pra, aspak me retorizëm, aspak me tone oratorike, e shkrin me ndjenjat e veta dhe kështu arrin forcën komunikuese me lexuesin nga i cili nuk mban distancë, po bashkëbisedon si me një shok, me një të afërm.

Agostin Jordani i ka botuar poezitë e veta te përmbledhjet “Hroaza”, Kastrovillari 1971 dhe “Hapa mbi kalldrëm”, Jehona, Shkup, 1976 si edhe në shtypin arbëresh, italian dhe shqiptar.

Poezitë e tij nuk kanë komunikuar, pra vetëm me publikun arbëresh, po edhe me publikun e atdheut të origjinës dhe çuditërisht edhe me publikun italian që gjithnjë ka ngurrur t’i japë një vend në letërsinë e vet poezisë arbëreshe.

Te publiku shqiptar A. Jordani ka ardhur, në fillim, bashkë me arbëreshë të tjerë, në antologjinë “Degë e blertë” (1980), më vonë me vëllimin e botuar më 1997 “Për ty arbëresh” (botuar nga SH.B. “Afërdita”) që përfshin krijime të reja të pabotuara. Te publiku italian poeti ka vajtur me poezitë e përkthyer dhe të përfshira në disa antologji (“I trovieri”, Milano 1978, “La poesia contemporanea” Milano 1982, “Antologia di un premio”, Piacenza 1983).

Në këtë mënyrë A. Jordani ka mundur të shprehë identitetin e vet të dyfishtë, pjesën shqiptare që e lidh me atdheun e lashtë dhe pjesën italiane që e lidh me vendlindjen.

Sepse poeti është ushqyer me traditën e poetëve arbëreshë (duke qenë madje stër-stërnipi i një poeti si Bernard Bilota), të poezisë popullore arbëreshe, po edhe të poezisë moderne italiane. Ai vetë është një poet realist, pra, vazhdon një traditë që ekzistonte te poetë arbëreshë si Stratigoi apo (pjesërisht) te Skiroi dhe dëshmon për vitalitetin e realizmit edhe në shekullin e njëzetënjëtë.

Realizmi i tij shfaqet në pasqyrimin objektiv të figurave të bashkëkohësve arbëreshë dhe problemeve të tyre. Po ky realizëm pasurohet edhe me teknikat moderne të poezisë së sotme italiane dhe evropiane që anojnë nga lirika e mendimit dhe thellësia e nëntekstit.

A. Jordani është një poet konçiz, një poet që shkrin çiltërsinë me punën e kujdesshme të limës. Është lirik, po di njëkohësisht të vizatojë portrete dhe pejsazhe.

Ndonëse poet kryesisht social, Buzëdhelpriti nuk u shmanget temave ekzistenciale, di t’i këndojë me gëzim a me dhimbje dashurisë, marrëdhënieve midis brezave, figurave të babait dhe nënës, natyrës, kryesisht natyrës arbëreshe që e rikrijon në miniatura të holla. Në poezinë e tij zë vend figura e gruas

arbëreshe, e mishëruar te figura e nënës dhe vajzës së dashur. Poezia e Buzëdhelprit është një poezi e detajeve, po edhe e një figuracioni të kursyer, po befasues dhe fin (bie borë ... Bie e qetme / si mëmë që lan liveret / natën; ... doj’ t’i vjidhja varfërisë / një lotë ari... një ëndërr që e potisim me ujën e shiut / që e puthim me dritën e hënës...; Ti luan ngaherë me lotët / përpara murit të dobësisë sime; Era thërret mallkimet e veta / mbi dyert e mbyllura të pasanikëve; / Era qan vajtimet e veta / mbi dyert e hapura të të varfërve ...)

Poeti madje di të vendosë harmoni midis mendimit dhe ritmit, ritmit të brendshëm të vargut të tij të lirë që ai e punon me kujdesin e një argjendari.

IL MONDO POETICO DI BUZËDHELPRIT - La poesia di Agostino Giordano (Buzëdhelpriti) spicca con i suoi colori nel panorama odierno della poesia arbëreshe, la quale non si distingue per una gerarchia letteraria chiara, come la poesia arbëreshe del XIX secolo, ma annovera diverse individualità letterarie con le loro particolarità. Agostino Giordano si manifesta come poeta della problematica sociale, sensibile alle piaghe sociali della comunità arbëreshe, come la disoccupazione e l’emigrazione: le riflette con obiettività e coinvolgimento appassionato. La materia viva della sua poesia la prende dalla realtà odierna arbëreshe e la impasta tramite il lirismo, senza retorica e toni oratori; la fonde con i suoi sentimenti e così arriva a comunicare con il lettore, dal quale non si tiene lontano, ma colloquia. Agostino Giordano ha pubblicato le sue poesie nelle raccolte “Hroaza”(Castrovillari 1971), “Hapa mbi kalldrëm” (Shkup 1976) e “Për ty, Arbëresh”(Tirana 1997), come anche sulla stampa arbëreshe, italiana e albanese. Il poeta si è nutrito alla tradizione dei poeti arbëreshë (essendo pure pro-pronipote del poeta Bernardo Bilotta), della poesia popolare; ma anche alla poesia moderna italiana. Lui stesso è un poeta realista: continua una tradizione che esisteva in poeti come Stratigò e (parzialmente) Schirò, e testimonia la vitalità del realismo anche nel sec. XXI. Il suo realismo si arricchisce anche delle tecniche moderne dell’odierna poesia italiana ed europea, che propendono verso la lirica del pensiero e la profondità del sottinteso. Buzëdhelpriti è un poeta conciso che fonde la sincerità col lavoro attento della lima. E’ lirico, ma contemporaneamente sa disegnare ritratti e paesaggi. Anche se poeta essenzialmente sociale, Buzëdhelpriti non evita i temi esistenziali, sa cantare con gioia o con dolore l’amore, i rapporti tra generazioni, le figure del padre e della madre, la natura, specie quella arbëreshe, che ricrea in fini miniature. Nella sua poesia trova spazio la figura della donna arbëreshe, incarnata nella figura della madre e della ragazza amata. La poesia di Buzëdhelpriti è una poesia dei dettagli, ma anche di una figurazione parsimoniosa, ma sorprendente e fine. Il poeta sa mettere armonia fra il pensiero e il ritmo, ritmo interno del verso che lui lavora con la cura dell’orafo.

“Fitirja e sana” e Zef Serembes**Fitirja e sana****Prof.dr Zejnullah Rrahmani**

Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë

E bardha vashëza ime e bukur ë:

E prerë, e hollë si kumbull shtuara rri;
Nd' ecën vete si zogë e thomse më
E ngrënë zanin pjot me jonësi

Shtekëljisur, e bukur rrethas vë

Këshetin e çë i shkëlqjen vo mbë të zi,
I feksën balla e cilja rrëmba zë
Si grika e detit kur ë pjot agi

Te zezë e noer e mall të thellë

Sit t'asana shkëlqjenjën më se hënë
E gëzon ndë mest fakjes hunda e hollë.

Ka buzët si kurajli, ë fakjemollë:

Ka dorën, zverkun ndër alabastër bënë
E ndë se kleshën te mbieru të kjellë.

Kur e lexojmë këtë poezi të poetit arbëresh Zef Serembe na rrëmben një përshtypje komplekse e cila përmban më vete efekte të veprimt të saj në ndjesitë tona dhe në shqisat me të cilat e perceptojmë. Janë sytë dhe veshët që koordinohen bashkë dhe përcjellin tutje drejtë racios sonë përshtypjet e tyre të fuqishme. Poezia është një sonet (një lexues i ditur e kupton këtë me shikim, ashtu siç i merr me shikim edhe disa mbaresa të tjera vargjesh, disa rima fundore e tinguj, disa pamje të trajtës së strofave e të fjalëve). Të tërën e pranojmë si një bashkësi përmbajtjeje dhe forme, si një ‘mesazh poetik’ që ka ‘pamjen’ dhe ‘esencën kuptimore’ dhe që të dyja na shpjen në përfundime që poeti e ka krijuar ashtu figurën poetike të një gruaje. E ka bërë këtë me shumë dashuri, me një pasion të veçantë të krijimit: ka përdorur fjalët të cilat janë të harmonishme dhe që tingëllojnë bukur. Përsëritjet dhe përdorimet e tingujve të caktuar dhe bukurtingëllimi e pëlqimi i rimave krijojnë një melodi të gëzuar dhe një ton të kthjelltë, i cili krijon një diskonim të këndshëm të lexuesi i cili e kupton që po shpalosë imazhin poetik të një lumturie dashurore kur djali sheh fytyrën e të dashurës.

Pamja e kësaj gruaje të imazhit poetik është pamja e një vajze të bukur, e cila është objekt i dashurisë. Ajo është pamje dinamike, një vajzë që portretizohet në qetësi e në lëvizje por në mungesë nga subjektit, poeti. Pamja e parë është ajo e pikurës: përhershmëria e saj e zënë brenda një çasti, në një pamje. Lëvizjet e saj shkaktojnë dinamikën e imazhit, kanë shpalosur kualitetet e caktuara të bukurisë së saj, kualitetet që nuk do t'i kishte një portret piktori a fotografie. Kemi një imazh që ndryshon duke ruajtur esencën e së bukurës, duke e plotësuar pamjen e saj.

Tingujt, fjalët, melodia e vargut, bukurtingëllimet e ndryshme, figurat, krahasimet e shumta, rimat, melodia, toni i përgjithshëm i kësaj poezie, të gjitha i nënshtrohen përfundimisht atij imazhi të bukur poetik: ka në epiqendër paraqitjen e bukur poetik të figurës së vajzës së dashur. Një figurë fizike e morale njëkohësisht.

Leximi i kësaj poezie na shtynë t'i rikthehemi prapë ndonjë ditë

tjetër dhe ta lexojmë si poezi të cilën tashmë e njohim, imazhin poetik të së cilës një kohë e kemi bartur me vete si një megjullnjë të bardhë, të dashur, të këndshme, të bukur... Herën e dytë këtë poezi e lexojmë me seriozitetin e studiuesit: varg pas vargut me kujdes; duke i gjetur, zbuluar e definuar të gjitha mikroimazhet e shumta të kësaj poezie, figurat, simbolet, alegoritë dhe gjithë ligjërimin metaforik e poetik të saj.

Kjo është një punë shumë më e vështirë dhe më e ndjeshme dhe për ta bërë këtë zakonisht lexuesit i duhet një njohuri e përshtatshme për nivelin e kërkesës. Kur për lexuesin është e nevojshme, ai duhet t'u drejtohet me këtë rast burimeve të poezisë (ku shpesh janë faktet e vërteta mbi krijimin e saj ose nxitësen direkt, që e ka shtyrë poetin të shkruajë atë poezi), si dhe punimeve të jashtme (shkrimeve të ndryshme kritike që të tjerët i kanë shkruar për atë poezi); ose, në shumë raste, lexuesi duhet të kërkojë ndihmën e poezive të tjera të të njëjtit autor.

Ja disa aspekte që janë të patejkalueshme kur e lexojmë për së dyti të njëjtën poezi të Z. Serembes: se kuptimi i fjalës ‘fytyrë’ nuk është emërtim i pjesës së përparme të kokës, po është përdorur në kuptim të fjalës “figura”, “pamja”, “dukja” që do të thotë imazhi poetik; se poezia fillon me një krahasim përjashtues; nuk ka objekt me të cilin ajo mund të krahasohet në tërësi.

Krahasimi është figura qendrore e kësaj poezie dhe ai shtrihet përgjatë pothuajse të gjithë vargjeve. Përdorimi këtillë i dendur i figurës së krahasimit e përcakton poezinë si krijim përmes figurave elementare ose të thjeshta. Përdorimi i dendur i krahasimit e afron poezinë në nivelin konceptual me botëkuptimin popullor të bukurisë.

Koncepti popullor manifestohet gjithashtu përmes leksikut të përdorur në figurën e krahasimit: si kumbull, drejt rri, shkon si zogë, si gryka e detit, më se hënë, buzët si kurajli, zverkun ndër llabastër bënë, dhe vetëm shumë rrallë hasim ndonjë figurë tjetër të bazës metaforike: faqemollë, i feksën balla etj. Në këtë poezi bukuria e vashës krahasohet me gjëra që janë të botës bimore, shtazore dhe të natyrës. Pra, është abstraksioni pothuajse i papërfillshëm. Kjo sugjeron një koncept popullor dhe të sipërfaqshëm të shikimit e të botëkuptimit të bukurisë së femrës, të së bukurës në tërësi. Poezinë më tutje duhet ta analizojmë në mbështetje të zhanrit të saj: sonetit. Madje, të sonetit italian, ose të Petrarques...një temë e hapur për studiuesit...

Il sonetto “Il suo volto” del poeta romantico Zef Serembe, è una delle poesie più belle del suo genere in tutta la letteratura albanese. A parte un leggero influsso nella forma e nel verso, che naturalmente viene dalla letteratura italiana, soprattutto Petrarca, in questo sonetto Serembe magistralmente ha assimilato nella sua ispirazione la tradizione poetica del paese natio, dello spirito poetico arbëresh e l'intero respiro romantico europeo. L'immagine poetica, da lui creata, risuona allegra, appassionata e complessa e contiene non solo il ritratto pittorico ma anche la dinamica della diversità e del movimento, la dinamicità dei sentimenti e la polivalenza dei significati che provengono dal linguaggio figurato. L'immagine poetica della ragazza che è oggetto d'amore è così vicino e costruito in ottemperanza alle figure poetiche vicine a quelle popolari, come anche con le figure del senso più raffinato e aristocratico, dando così un quadro completo e forte che chiamerei arte. Perciò si legge anche oggi così vicina e così moderna!

De Rada, promovues i romantizmit shqiptar

Letërsia arbëreshe ka lindur dhe është zhvilluar si shprehje dhe pjesë e pandarë e jetës dhe historisë së një bashkësie të qëndrueshme, me vetëdije të qartë etnike. Ajo ka qenë e ka mbetur zëri i kësaj vetëdije, një zë që u ka bërë ballë shekujve, duke ardhur deri në kohën tone. E themi këtë, sepse edhe letërsia e sotme arbëreshe i ka ruajtur me fanatizëm tiparet e letërsisë së shekullit të XIX, ku spikat vepra e të madhit Jeronim De Rada. Jeronim De Rada lindi më 1814 në fshatin e vogël dhe piktoresk Maki të Kozencës. Qe ne vitet e para të studimeve të tij ai u përqëndrua në letërsinë antike dhe moderne. Në shekullin XIX ngulmimet arbëreshe, sidomos ato të arbëreshëve të Italisë kishin ruajtur të paprekur ndjenjën e dashurisë për atdheun e të parëve, gjuhën, zakonet e traditave stërgjyshore, e shfaqën me një forcë të veçantë vetëdijen e tyre shqiptare edhe në fushën e lëvizjes kulturore e letrare. Letërsia e re që lindi tek arbëreshët përtej Adriatikut nga dhjetëvjetëshi i tretë i atij shekulli ishte një degë e letërsisë shqiptare të kohës. Në qendër të kësaj letërsie ishte ideja patriotike, evokimi i traditave të lavdishme të popullit tone sidomos, i kohës së Skënderbeut. Kësaj letërsie iu përkushtua edhe poeti arbëresh, Jeronim De Rada.

Me veprën e tij, De Rada konsiderohet si poeti që hodhi themelet e romantizmit original jo vetëm në letërsinë arbëreshe, por edhe në atë shqiptare.

Po të lexosh veprën e De Radës kupton se ai ishte një mjeshtër i stilit dhe shprehjes, i përdorimit të figuracionit që duket i freskët e aktual edhe sot.

De Rada mbetet poeti që hodhi themelet e letërsisë me të vërtetë artistike arbëreshe, dhe dha një ndihmesë të madhe për tërë letërsinë kombëtare. Në thelb vepra e De Radës i përket romantizmit përparimtar, një romantizmi veçanërisht origjinal, që nuk i këndon vetëm të jashtëzakonshmes, por zbulon edhe poezinë e së zakonshmes. Gjuha me të cilën shprehet De Rada, është e pasur dhe ka një ndikim të forte emocional. Poeti pati një ndikim të madh në veprat e shkrimtarëve arbëreshë dhe një ndikim më të vogël të shkrimtarët e tjerë të Rilindjes.

”Këngët e Milosaos” është vepra e parë e De Radës dhe më e njohura. Me këtë poemë liriko-epike tepër të veçantë poeti afirmohej si individualitet i fuqishëm dhe origjinal. Kjo veper vlerësohet si manifesti i romantizmit shqiptar. Aty shfaqen të gjitha tiparet e romantizmit, kulti, hyjnizimi i së kaluarës, por në një plan të ri, duke e parë këtë të kaluar si një epokë të lavdishme të historisë së të parëve tanë, ku duhet mësuar të jemi optimistë për të ardhmen. Ky këndvështrim i së kaluarës është në bazë të veprës romantike të De Radës. Poeti e ndërton gjithçka mbi bazën e intuitës së tij poetike e historike, mbi ato që ka dëgjuar, mësuar e ëndërruar.

Ai i takon atij brezi krijuesish, të cilët lindën, jetuan e krijuan përtej kufijve të Shqipërisë e ku ëndërra e realiteti mbetën gjithmonë të shkrira me njera-tjetrën. Ashtu si tek të gjithë romantikët, edhe tek De Rada çdo gjë nis me ardhjen e muzës poetike, por tek De Rada çdo gjë është më e bukur. Tek Milosao përdoret në mënyrë të përkryer metafora. Autori njehohet me Milosaon dhe habitet me çdo gjë të bukur e të lulëzuar. Ashtu si në të gjitha veprat romantike, edhe këtu zotëron ngjyrim emocional me figura të natyrshme që rrjedhin nga mendimi i qartë dhe burojnë si lule në të gjitha vargjet. Peisazhi është i mrekullueshëm, mahnitës e të krijon idenë se je aty, pranë

Doc. Zamira Alimemaj

Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë

Milosaos.

De Rada përdor figura të shumta por më e spikatura është inversioni. E gjithë poema duket fragmentare plot metafora. Poema është e fuqishme dhe fragmentizmi është tipar i të gjithë romantikëve. Në poemë përdoret forma e vetërrëfimit, e dashur për romantikët. ”Këngët e Milosaos” është një shembull tipik i ”parregullsisë lirike” romantike. Poema është e ndërtuar në mënyrë të tillë që kalimi nga një kapitull në tjetrin është krejt i befasishtëm madje këngët e poemës mund të duken si vjersha të veçanta. Unitetin poemës nuk ia jep bashkëndimi logjik i ngjarjeve përmes subjektit, por ideja poetike. Copëzimi i poemës është në përputhje me parimet krijuese të De Radës. Skema e subjektit të poemës është e njohur në letërsinë sentimentale dhe romantike, një dashuri e ndihmuar nga mjedisi. Po kërty motivi të njohur De Rada i jep një freski të jashtëzakonshme. Thjeshtësia në dukje e fabulës dhe subjektit lind iluzionin për thjeshtësi të idesë. Një element me rëndësi të ”Këngët e Milosaos”, është natyra, pothuajse gjithnjë e shkrirë me ndjenjat e personazheve. Shqetësimin e djalit gjatë grindjes me të dashurën ai e jep me lëvizjen e deleve nëpër vathë, kurse dhembjën e tij të thellë për vdekjen e gruas e jep përmes kontrastit me përtëritjen e përhershme të natyrës.

Vepra ka një originalitet të veçantë që i vjen nga shkrirja e mahnitjes, gëzimit fëminor në soditjen e botës, karakteristike për poezinë popullore, me shqetësimet, dyshimet e forta të poetit romantik. Pra, me plot të drejtë, me mund ta quajmë De Radën promovues të romantizmit në letërsinë shqiptare.

Literaturë

De Rada, Këngët e Milosaos

Gaçe, B. Letërsia shqiptare, Triptik 2007

Jorgaqi, N. Poetika e dokumentit, “Naim Frashëri”, 1987

Vyshka, M. Nëpër faqet e veprave letrare, ERIK 2000

Mi hanno sempre attirato i poemi del grande scrittore arbëresh Girolamo De Rada, per questo mi sforzo a stimolare gli studenti a seguire il corso di Stilistica, a leggere i suoi poemi soffermandosi sulla lingua e lo stile dell'autore. Uno dei progetti da loro realizzato l'anno scorso è stato proprio la traduzione in lingua inglese di alcuni versi de “I Canti di Milosao” e la loro analisi stilistica e linguistica. Sono rimasta strabiliata del loro lavoro. Per questo ho pensato di scrivere qualcosa di modesto su questa figura insigne delle Lettere Albanesi.

BIBLIOTEKA e JETËS ARBËRESHE

Emanuele papas Giordano:

<i>Vangjeli, i pjerrë arbërisht – 2006 – ff. 230</i>	€ 10
<i>Mbledhje këndimesh arbëreshë – 2006 – ff. 160</i>	€ 10
<i>Himne Bixantinë – 2005 – ff. 217</i>	€ 10
<i>Gramatikë Arbëreshe – 2005- ff. 70 (fotok.)</i>	€ 10
<i>Fjalor (Dizionario Arbëresh-Italiano / Vocabolario Italiano-Arbëresh) - edic. 2000 - ff. 715</i>	€ 30
<i>Shpata e Skanderbekut di B.Bilotta – 1967 - ff. 217</i>	€ 15
<i>Folklore albanese in Italia – Festeggiamenti Pasquali a Frascineto (1957) (fotok.)</i>	€ 10

Jeta Arbëreshe:

<i>(tetë vjet: 2002-2009)..... € 400;</i>	për Institucionet € 600
<i>Paqitje vjetor (abbonamento annuale).... € 30;</i>	për Institucionet € 60

Poezi e pikturë tek De Rada

Prof. asoc. dr. Laura Smaqi

Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë

Në studimet mbi De Radën është theksuar gjithmonë fryma e përgjithshme romantike, por në aspektin e ndërtimit të veprave, mënyrës sesi krijohet artistikisht imazhi, janë dalluar elemente të cilat ndoneshë dilnin nga kuadri romantik u janë veshur ose rrymave të tjera, ose vetëm janë cilësuar si shprehje të gjenialitetit artistik të De Radës. Marrëdhëniet mes poezisë dhe pikturës, të vëna shpeshherë në dukje nga studiuesit sidomos për sa i përket pamjeve të natyrës, por dhe më gjerë, janë mjaft interesante në rastin e De Radës. Një vështrim i shpejtë i shkrimeve të bashkëkohësve të De Radës mbi poezinë e tij vë në dukje përshtypjen që u ka ngjallur imazhi poetik si një imazh pikturë. Po citojmë vetëm Markianoin

“Poema është shprehje e natyrës, kurdoherë e freskët dhe e re, që kundërmon parfumet e tokës, të ajrit të pastër, të bukurisë së qiellit të kulluar, të detit të gjerë, të njelmët, të kaltër, që lëviz në djepin e lirë të valëve; është piktura e jetës shqiptare me zakonet e moçme dhe të papërdhosura, me krenarinë e prejardhjes së tyre të lashtë, me thjeshtësinë naëve stërgjyshore, me doket e tyre të patundura.

Natyra është përshkruar me shprehje skalitëse e të forta, e freskët, e fuqishme, shumë e kulluar, me konture të thjeshta, të shkurtra, të sakta dhe realja brof si prej një dalte të sigurt, që vijëzon tipare të përsosura. Shprehjet e saj, që u duken të gjithëve të rëndomta, sepse janë të zakonshme dhe të dukshme për këdo, ndeshen si mbi një pëllurë me ngjyra të gjalla po të përkorta, na godasin me një habit të ëmbël dhe, të çuditur, pyesim vetveten: si vallë ne që kemi pare e dëgjuar gjithnjë të njëjtat gjëra, nuk i kemi vënë re gjithashtu ato bukuritë dhe lidhjet midis atyre ngjarjeve dhe shpirtit tone?” (f.37- 38)¹

Përgjithësisht mes rrymës të cilës i përket një vepër letrare dhe imazhit që ajo arrin të sendërtojë ekziston një lidhje e fortë, e cila bën që ky imazh të ketë tipare që ngajnë dukshëm me pikturat që i takojnë po kësaj rryme. Konkretisht lidhja e veprave letrare që i përkasin romantizmit me pikturat e së njëjtës rrymë janë thujtë e njëjta pamje në dy lloje të ndryshme arti. (Kujtojmë Lirinë në barrikada apo dhe vepra që zbulojnë ndjenjat e fuqishme njerëzore nëpërmjet pamjeve të fuqishme të natyrës).

Përshkrimi i gjallë i Natyrës së fshatit arbëresh, vizatimi i traditave shqiptare, imazhi i aristokracisë dhe bashkimi apo shkrija e dy niveleve, të realitetit dhe ëndrrës afrojnë poezinë e De Radës me imazhet sintetiiste.²

Sic vihet re dhe në citimet e lartpërmendura, imazhi plot ngjyra i përshkruar në poemat, e sidomos tek “Milosao” është vetë gjallëria e jetës, është shkrija në një e dliresisë, bukurisë, harmonisë së një vendi, i cili është përfytyrimi ideal i një toke që nuk i është nënshtruar të huajit, është një parajsë shqiptare. Me të tilla ngjyra është përshkruar dhe jeta fshatare arbëreshe, ku peizazhi dhe ndjesia që përfitohet prej tij shkrihen në një. Traditat, veshjet dhe festat popullore me ritet karakteristike janë njëlloj ekuivalenti në poezi i tablove të Gogenit me fshataret betone. Ky imazh i pakohshëm e i gjithkohshëm krijon idenë e një bote shqiptare që mbetet e paprekur pavarësisht nga koha që kalon, sepse është treguese e thelbit etnik shqiptar. Jeta e përditshme dhe simbolikja shkrihen e unifikohen.

Një tjetër imazh është ai i aristokracisë shqiptare, i princërve, princeshave e luftëtarëve, po aq simbolik sa dhe ai që përmendëm më lart, dhe që jep disa pamje të qëndrës shqiptare, jo thjesht në aspektin e luftës, por dhe të ruajtjes së traditave e të nënshtrimit të ndjenjës, kur është fjala për të mirën e përgjithshme.

Po ashtu është i dukshëm kombinimi si në një tablo i 2 niveleve të

realitetit, i botës së jetës së përditshme dhe ai i ëndrrës. Dy realitetet shkrihen në një eksperiencë vizuale duke pasur vlerë të njëjtë. Asnjëri nga realitetet nuk mbizotëron, ndryshe nga vizioni romantik, por të dy plotësojnë njëri – tjetrin.

Të tri aspektet e përmendura bëjnë që poezia e De Radës të japë imazhin shqiptar më të koncentruar e të sintetizuar të mundshëm. Po të bashkoheshin në një do të jepnin diçka të ngjashme me tablotë “Kush jemi ne, nga vijmë, ku shkojmë” të Gogenit, tablotë e Seruziesë e të Bernarit.

Lidhja e vënë në dukje nëpërmjet këtij parashtimi mes imazhit poetik të De Radës dhe imazheve sintetiiste dëshmon vizionin modern të De Radës, që përtej synimeve utilitare të realizimit të një detyre, siç e konceptonte ai përpjekjen e tij madhore, ndonëse pa qenë i vetëdijshëm, qëndroi afër përvojave që do të linin gjurmë në fushën e mendimit poetik evropian të mëvonshëm.

1) M.Markiano, “Shqipëria dhe vepra e Jeronim De Radës,” në De Rada në 100vjetorin e vdekjes, Tiranë, 2003, f.37- 38. Po aty: “Kënga e parë, që na nxjerr para syve natyrën e shkëlqyer dhe të hareshme, me qiellin e kulluar, me detin e kaltër, me kallzoret që këndojnë, (f.36) me rrushin kalangur që nxin mbi hardhitë ndërkohë që, kësaj feste naëve të natyrës i përgjigjet gezimi i nënës, që murmurit nëpër shtëpi emrin e të birit, që ishte kthyer pas një kohe të gjatë së largu, (Kënga I, pra – Red.) është një kuadër i pikturuar si në një pëllurë të gjerë me ngjyra ylberi. . . Përfytyrimet janë nga ato më të zgjedhurat me të cilat mund të mburret çdo letësi. . . Qielli është i kaltër e i qeshur si një lëndinë me lule liri, të përkulura dhe të trazuara nga era, dhe hareja e të dashurit është si hareja që ndien virgjëresha, e cila, duke prekur gjirin shikon se i është fryrë.”

2) Veprat e sintetizimit u shfaqën në fund të viteve 80 në Francë, në atë që u quajt Shkolla e Pont-Avenit. Një grup piktorësh, më i njohuri i të cilëve ishte Gogeni lanë Parisin për Bretanjen, e cila i tërhoqte për nga pastërtia e kulturës, traditave, fesë dhe natyrës. Këta artistë nuk pikturonin më në natyrë, por në atelie. Qëllimi ishte të realizonin një imazh mental sineteze. Për ta, të pikturosh do të thotë të kërkosh përtej aparencave, falë mjeteve plastike të thjeshtëzuara, një realitet më të plotë, të tërësisht të ri dhe menduar, një realitet shpirtëror. Duke kombinuar sintetikisht pamjet, realizohet imazhi mitik i një natyre primitive dhe paradiziake përmes një motivi breton. Duke pasur bindjen se përshtypja nuk krijohet e kufizohet në retinë por është pjesë thelbësore e aktivitetit të trurit, artisti shihet si “ndërgjegjja e peizazhit” dhe tabloja si ç’vendosje në natyrë e një apo disa cilësive të individit po aq sa dhe paraqitje e natyrës. Interesi shkon nga efemerja tek solidja, e qëndrueshmja, tek një palëvizshmëri absolute. Imazhi i sintetistëve është imazh pa kohë, si kapje e përjetësisë. Traditat dhe zakonet, lufta, fshati breton dhe jeta e përditshme frymëzoni këta piktorë. Ata u shfaqën me një stil thellësisht të ri, stil në të cilin forma (ngjyrat, planet e linjat) bëhet një me idenë, apo ndjenjën më të fuqishme të subjektit. Vendin e imazhit romantik të vrullshëm, të detajuar e zë imazhi plot ngjyra i lokales, ku personazh qëndror është njeriu i zakonshëm, jo figurat me domethënie të njohur simbolike.

I rapporti tra poesia e pittura messi spesso in evidenza dagli studiosi, specie per quanto riguarda aspetti della natura, ma anche più ampiamente, sono abbastanza interessanti nel caso del De Rada. La descrizione viva della Natura del paese arbëresh, il disegno delle tradizioni albanesi, l’immagine dell’aristocrazia e l’unione o lo scioglimento dei due livelli, della realtà e del sogno, avvicinano la poesia del De Rada alle immagini della pittura sintetiista. Le tradizioni, i costumi e le feste popolari con i riti caratteristici descritti poeticamente sono l’equivalente, in poesia, dei quadri di Goguin con i contadini bretoni. Questa immagine, senza tempo e di ogni tempo,

(ec te jetra faqe)

Edhe një Fjalor i Arbërishtes

dr. prof. Imri Badallaj

Universiteti i Prishtinës

Botimi i Fjalorit të Mario Massaros, i cili mban titullin: *Dizionario comparato delle parlate arbëreshe di Casalvecchio e Chieuti*, është një fjalor fort i çmuar, që pa dyshim dukshëm rrit vargun e fjalorëve të leksikografisë, jo vetëm arbëreshe, por edhe mbarë shqiptare. Autori në këtë Fjalor ka pasqyruar një leksik të dokumentuar, që nga kohërat më të vjetra të shqipes së moçme në të folmet e këtyre dy katundeve. Lënda dhe gjithë materia leksikore, e cila është shtruar me një kujdes dhe përpikëri të veçantë, do t'u shërbejë jo vetëm folsëve të italo-arbërishtes, por tërë studiuesve të leksikografisë dhe të interesuarëve të tjerë për këto dy idioma dialektore të ruajtura me një xheloz të pasqorë. Fjalori tregon qartë se, edhe për krah trysnisë së pandërprerë me shekuj të gjuhës italiane mbi arbërishten e "gjakut të shprishur", rron dhe qëndron në shtatë regionet e Italisë, si: Abruco, Basilikatë, Molise, Pulie, Kampani, Kalabri, dhe Sicili. Materia leksikore e shtruar në këtë vepër është studiuar nga autori me vite të tëra, sepse fjalët e krahasuara midis këtyre dy idiomave dialektore janë vënë edhe në përkthim shumë adekuat arbërisht-italisht, çfarë edhe shihet qartë nga vetë shembujt e fjalës të shtruar në Fjalor; dallimet leksikore, pra, midis këtyre dy të folmeve nuk janë edhe të pakta, që gjithsesi autorit gjatë hartimit të tij i është dashur një punë e pandërprerë dhe me shumë mund, duke regjistruar tërë lëndën e konsultuar nga qindra informatorë të moshave të ndryshme; duke qëmtuar një mori materiale të këtyre dy ngulimeve, qoftë folklorike ose edhe të karakterit artistik të botuara nëpër qendra të ndryshme brenda Italisë. E gjithë materia leksikore e vendosur në Fjalor rreptësisht i është nënshtuar metodologjisë shkencore të sotme, duke u ilustruar me citate origjinale, me frazeologjizma dhe me një fond të madh fjalësh të urta, të cilat pa dyshim bindshëm tregojnë edhe madhësinë mendore dhe shpirtërore të vetë arbëreshëve, që gjeneza dhe rrënjët e moçme të tyre nuk u thanë kurrë. Pra, ky fjalor është vepër serioze, që përfill kërkesat më bashkëkohore të leksikografisë, duke i dhënë përparësi thjesht materies burimore dhe shqiptimit adekuat të realizuar nga vetë folësit e Kieutit dhe të Kazallveqit. Kështu që, financimi për daljen në dritë të këtij Fjalori, është i qëlluar mirë dhe u takon një meritë e veçantë dy bashkive: të Kazallveqit dhe të Kieutit, që për këtë gjest edhe i përgëzoj për zemërsisht. Ndërsa autorit i dëshiroj sukses edhe më të mëdha në botimin e veprave të tjera.

20 vjet në Ejaninë

motra e vogël Maria Lucia

ka Tirana

Unë dëshiroj të tregoj dëshminë time rreth kohës që motrat e vogla të Jezusit kanë jetuar me italo-shqiptarët në Ejaninë, një fshat i Eparkisë së Ungërisë gati për 20 vjet, qysh 1969. Kur Delfina Rossano nga Acquafornosa hyri në Kongregatën tonë, motra e vogël Madëlenë (themeluesja jonë) ka njohur praninë e arbëreshëve në Itali, dhe menjëherë ajo ka pasur një dëshirë të fuqishme që në Ejaninë të fillonte Vëllazëria e motrave të vogla për arsye të ndryshe: ishte një rast për të dëshmuar miqësinë tonë "vëllezëre" të Shqiptarëve, që në Shqipëri ende jetonin krejtësisht të izoluar; por, sidomos, ishte një mundësi e veçantë për t'u lidhur me një Kishë Lindore Bizantine dhe me pasuritë e veta.

Në fillim unë kam jetuar në Ejaninë disa vjet... dhe ende i kujtoj në një menyre shumë të qartë fjalët e Ipeskëvit, imzot Giovanni Stamatit, kur na ka mikpritur: ai na kishte treguar vendin e privilegjuar që italo-shqiptarët kishin pasur dhe vazdhonin të kenë, në rrugën ekumenike në marrëdhënie me orthodoksët.

Në jetën e përditshme Zot Emanuel Giordano – udhëheqës i urtë dhe atëror – na udhëzoi në pasuritë e Liturgjisë Hyjnore. Ne motrat e vogla, së bashku me popullin e Ejaninës, dhe me bashkësi të tjera arbëreshe, kemi përjetuar entuziazmin e një zgjimi të vertetë: tekstet e Liturgjisë hyjnore të përkthyer në ato vite nga greqisht në gjuhën arbereshe me muzikë bizantine... Kishat e të gjithë fshatrave dhe qyteteve arbëreshe filluan të zbukurorshin me afresket dhe me ikona... Unë e kujtoj këtë kohë si një pranverë... E ndiejmë me gëzim të madh që më në fund arbëreshët ishin duke i zbuluar përsëri rrënjët e tyre bizantine, ato rrënjë që i kishin kur u larguan nga Shqipëria e Jugut. Unë e di që për çdo motër të vogël që ka jetuar në Ejaninë kjo kohë ka qenë shumë e pasur sepse secila ka patur mundësi për ta marrë frymë me dy mushkëri (sipas shprehjes së papës Gjon Pali II në letërën apostolike "Lumen orientale") dhe ky përfitim ka qenë jo vetëm për motrat e vogla, por për tërë VËLLAZËRINË, që në karizmën e vet ka një kujdes të veçantë për Kishat Lindore.

Il Dizionario di Mario Massaro, che ha come titolo "Dizionario Comparato delle parlate di Casalvecchio e Chieuti", è molto prezioso e va ad arricchire la schiera dei Dizionari di lessicografia, non solo arbëreshe, ma anche albanese. La materia lessicale, presentata con una cura e una precisione particolare, servirà non solo ai parlanti arbëreshë ma a tutti gli studiosi di lessicografia ed ad altri interessati a questi due idiomi dialettali; e si vede chiaramente, dagli stessi esempi del lemmario presente nel Dizionario, che le differenze tra queste due parlate non sono poche, e l'autore ha dovuto fare un lavoro ininterrotto e faticoso, registrando tutta la materia e consultando decine e decine di informatori di diverse età, e spigolando in una marea di materiali di queste due comunità. L'opera, seria, è stata impostata secondo l'odierna metodologia scientifica. La sua pubblicazione, comunque, è merito anche dei due Comuni di Casalvecchio e Chieuti, che ne hanno capito il valore. All'autore auguro altri successi, anche maggiori, nella pubblicazione di altre opere.

Poezi e pikturë tek De Rada

(vjen ka faqja 20)

crea l'idea di una terra albanese che resta intatta indipendentemente dal tempo che passa, perchè è indicatrice del cuore etnico albanese. Un'altra immagine è quella dell'aristocrazia albanese, dei principi, delle principesse e dei guerrieri, ma tanto simbolica, e che mostra alcuni aspetti della resistenza albanese, non semplicemente sotto l'aspetto della lotta, ma anche della salvaguardia delle tradizioni e della sottomissione del sentimento, quando si tratta del bene comune. Ma così è evidente la combinazione come in un quadro dei due livelli della realtà, quello del mondo della vita quotidiana e quello del sogno. I tre aspetti succitati fanno sì che la poesia del De Rada dia l'immagine albanese il più possibile concentrata e sintetizzata.

Ndikimi i italianizimeve në gjuhën e Arbëreshëve të Italisë

Në territore të të njëjtit shtet, grupe joindigjene flasin një gjuhë të ndryshme nga ajo e pjesës tjetër të popullsisë së atij vendi. I tillë është rasti i Italisë, që ka një trashëgimi të pasur gjuhësore e kulturore në këtë drejtim. Në fakt, në Itali gjenden dialekte e gjuhë minoritare të transplantuara prej kohësh në tërësinë e territorit, si: helene, gjermane, sllave, arbëreshe etj, në të cilat, ndikimi i fjalëve italiane që i madh.

Në fokus të këtij shkrimi vjen pikërisht ndikimi i huazimeve italiane në gjuhën e arbëreshëve të Italisë. Për këtë do të marrim në analizë Fjalorin arbërisht - shqip të Kolë Kamsit:

Të gjitha gjuhët kanë fjalë të huaja në leksikon e tyre, por në shqip (arbërisht) ato janë të shumta, si rezultat kryesisht i pushtimeve të ndryshme për një periudhë të gjatë. Kujtojmë këtu që gjuha dhe kultura shqiptare kanë qenë nën ndikimin e atyre (gjuhës dhe kulturës) latine, greko-bizantine, sllave e turke, duke lënë kështu në shqip fjalë me origjinë nga këto gjuhë. Përveç ndikimeve gjuhësore të vendeve pushtuese, të cilat i mbartën me vete, arbëreshët, të ndodhur në mjedisin e huaj italian, për të përballuar jetesën në dhe të huaj, krahas përfshirjes në popullsinë e një vendi që kishte tjetër gjuhë, nuk mund të mos pësonin edhe ndikimin nga italishtja dhe dialektet e saj. Takimi i të folmeve arbëreshe me italishten pas shpërnguljes nga Shqipëria, u bë në rrethana krejt të tjera, të cilat me kohë sollën edhe dygjuhësinë arbëresho-italiane, pastaj shumëkud edhe bjerren e plotë të gjuhës amtare. Është më rëndësi të theksojmë se rrallë gjen ndër arbëreshët e Italisë dygjuhësi të përsosur. Deri relativisht vonë arbërishtja ka mbajtur kurdoherë vendin e gjuhës së parë (L1), ndërsa italishtja ka mbetur gjuhë e dytë (L2).

Vepra "Fjalor arbërisht-shqip" pasqyron gjerë këtë proces gërryerjeje gjuhësore që kishte marrë udhë në të folmet arbëreshe dhe që pasqyrohet edhe në leksikon e shkrimtarëve arbëreshë. Në Fjalor ka shumë pak ose aspak fjalë turke (meqë si rezultat i pushtimit (osman), arbëreshët u larguan nga vendi i tyre), të cilat, ndërkaq janë të dendura në shqip, porse ka aq shumë italianizma që janë bërë pjesë e fondit leksikor të arbërishtes së Italisë. Prof. Kolë Kamsi, jo vetëm e konstatoi këtë dukuri, por edhe e hetoi mjaft gjerë atë, duke u bërë vend në fjalor, krahas fjalëve shqipe, edhe aq shumë fjalëve (emra, folje, mbiemra etj.) të huazuara nga dialektet italiane në ligjërimet e folura arbëreshe, apo nga italishtja letrare në gjuhën e shkrimtarëve arbëreshë.

Nga rreth 8600 lema që përmban leksiku i këtij fjalori, na rezultojnë se 1568 prej tyre janë huazime italiane, pra afro 20% (e leksikut të arbërishtes). Këto huazime (italiane), studiuesi Kamsi i ka ndarë në dialektet përkatëse: friulan, napolitan, sicilian, venet, kalabrez; të gjithë këto dialekte të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin, por jo plotësisht të kuptueshëm reciprokisht. Ndër to (1568 it.), 960 i përkasin gjuhës standard (e bëjmë këtë pohim duke iu referuar faktit se në fjalor nuk i është shënuar krahas dialekti, siç ndodh me fjalët e tjera, por vetëm përcaktimi si italiane (it.)), 591 i përkasin dialektit kalabrez, 31 i përkasin dialekteve: friulan¹, napolitan (11) (2 prej tyre kanë edhe përcaktime prejardhjeje të tjera), sicilian (17) (12 prej tyre kanë edhe përcaktime prejardhjeje të tjera), venet².

Këtë fond huazimesh (italiane) mund ta grupojmë si më poshtë:

Dr. Orjeta Baja – Ma. Merita Hysa

Universiteti i Shkodrës

1- Italianizma të përbashkëta për shqipen dhe të folmet arbëreshe të Italisë, të cilat kishin hyrë në shqip para se të niste shpërngulja e arbëreshëve për në Itali e gjetkë. Si të tilla përmendim: forca, fund, grup, birra, kundër, mars, sapun, sipar, spijun, qiparis, shall, shelq "shelg", engjëll, mik, pamendë, rërë (geg. ranë), bukë, qiell, këmbë (geg. kamb), qen, faqe, femër, festa etj..

2- Italianizma që ndeshen vetëm në të folmet arbëreshe dhe që mungojnë në gjuhën e sotme shqipe, të cilat kanë hyrë në të folmet e arbëreshëve të Italisë pas shpërnguljes së tyre. Si të tilla përmendim: distinguir, difendir, dominar, fermar, furnonj e fërnonj, fraxhelar, kapir, cikonjë, cukar, animalj, etj.

Në periudhën menjëherë pas shpërnguljes, përmendim si më të fuqishëm ndikimin e leksikut të italishtes dialektore mbi të folmet arbëreshe të krahinave përkatëse, për arsyen e ditur se edhe situata gjuhësore italiane e kohës (që përkon me vendosjen e arbëreshëve në Itali të Jugut) karakterizohej nga përdorimi i gjerë i dialekteve, ndërsa gjuha e përbashkët italiane kishte vend më të kufizuar. Hyrja e tyre është bërë në masë e shkallë të ndryshme në të folme të ndryshme arbëreshe. Duke ndjekur këtë kategori huazimesh leksikore, mund të njohim njëkohësisht edhe bjerret e fjalëve shqipe që ekzistonin më përpara.

Është e vërtetë, arbërishtja ka pësuar ndikime nga italishtja, sidomos në leksik, po është po kaq e vërtetë që ajo ka shfaqur aftësi për t'i asimiluar dhe ndryshuar sipas modelit të vet ato, duke treguar forcën dhe gjallërinë e saj. Këto huazime rrallë i ndeshim në formën e tyre të pastër; ato, zakonisht, janë përfshirë në sistemin fonetik e morfologjik të arbërishtes, duke iu shtruar një procesi të njohur "shqiptarizmi".

Mund të themi se leksiku i arbërishtes, parë nëpërmjet këtij fjalori, sado që i ndikuar nga italianizmat, prapëseprapë ka ruajtur një pasuri të vyer fjalësh të njëjta me ato të mbarë shqipes ose së paku me ato të ndonjë të folmeje, kryesisht jugore, të saj. Megjithatë, gjuha shqipe që flasin arbëreshët e Italisë paraqitet si një varietet më vete, që nuk është plotësisht i njëjtit me asnjërin dialekt të shqipes në trojet kompakte ballkanike, prandaj edhe ndonjë studiues ka dashur ta quajë atë si dialekt të tretë të shqipes. Sipas studiuesit Gjovalin Shkurtaj, po të vështrijmë elementet strukturore dhe fonetike themelore të ligjërimëve arbëreshe, rezultojnë se ato i përkasin toskërishtes jugore, duke u përputhur më fort me disa dukuri konservative të çamërishtes e të labërishtes, po edhe me gjuhën e autorëve të vjetër gegë; nga ana tjetër, - pohon Shkurtaj -, ato ligjërimë paraqesin edhe dukuri e tipare të reja (inovative) (sidomos në fushën e leksikut), që përcaktohen e kushtëzohen nga takimi i ngushtë gjuhësor që kanë pasur për kaq shekuj me italishten, qysh prej shek. XV – XVI e këtej.

Sot, realiteti arbëresh po tregon se situata gjuhësore atje po ndryshon: Shqipja e arbëreshëve të Italisë po merr karakteristikat e gjuhës vartëse në një situatë diglosie. Kështu, elementi gjuhësor arbëresh po dobësohet duke i lënë vend më tepër elementit italian, si rezultat i kalimit më lehtë tashmë përta në gjuhën italiane, sidomos nga të rinjtë, duke çuar në përfundimin e një varieteti gjuhësor ndryshe prej atij të viteve

(ec te jetra faqe)

Ku vete Eparkia e Ungris?

Nando Elmo

ka Firmoza (Cs)

Kisha marr benë se ngë do të kisha shkruajtur asnjëherë më mbë Arberinë e mbë shurbiset arbëreshe. Arbëria ka rahallin, është po të vdes e do lën më paqë, po situata e re e Eparkisë s'Ungris më detyron të thom timen... Ndër shkrimtarërt arbëreshë, ndër ata që dinë e shkruajin vet litisht, e interesohen vet të shohjin ëmërin e tyre përposh njëj artikulli pa kryp e pa valë, ng' u adunar mosnjë të fatit të ligë, e vazhdojin e shkruajin mbë "La poesia del passato" sikursë Arbëria të kishë nevoj të këtë vajtimi – e ng'adunaren se dreq ki vajtim e farmakosin. Një shkuanje e trekshte e e ngarë ka ndrishku e kopica, po që bën doksin e këtyre lllitratvet. Të lllitratvet intelektualë. Këtë nëng pandeftin kurrë se Arbëria kishë nevoj të njëj ardhmje, që ata kish të kishin pergatitur. Nani që ardhmja burthofet e pamundur, pse të qëndruarit e tyre kle i përshkuar ka moti, adunaren se ngë kan burime mbë të cilëvet mund besohen. Është e vdes Ungra? Është e vdes Eparkia? E kuja është ftesa? Ftesa është e Vatikanit - thon.

E nëng adunaren se ndose Vatikani, i cili është i bën ka krye të holla, jo si këta e intelletualvet tanë; ndose Vatikani ngë ka një pishkop të na dirgonjë, është sepse na ngë kemi krye të holla të vëmi te dispozicjona jonë e të Vatikanit.

E pse ng' i kemi? Pse jemi intelletualisht midhjokru. Tanët gjellojin mir vet ndër prallat e Skënderbeut e të ndrishme e të ndrishme pralla. Si pralla e Arbërisë e cila mejton se intelletuali më i math i saj është një liti që di e shkruan vet litisht, të cilit ja thon C. Abate, i cili u buar edhe ai prapa prallëzet të Skënderbeut.

Nani që Arbëria është e tëhelq rripat, si thomi Firmozë, njota se skadalizohen, e ngë kan edukatën e mirë të rrin qet: njota, se Vatikani do të na bënj litinjë.

E përsëritinj: ndose Vatikani ngë ka një, tek priftrat tanë, t' e bënj piskop, vjen me thën se prifrat tanë jan midjokru. E pse jan midhjokru? Pse ambjentij ynë është midhjokru: jemi pjoj "analfabeti di ritorno con laurea", sidomòs Ungir. Të cilët u len e u rritëtin me televizionin, sidomòs e Berlusconi, (e cila do ngamon shmanguar) e atë imitojin sikurse jan e bëjin kush e di kë.

Ambjentij ynë i krishter, prani, mbaroj jetën e tij që kur vdiqë Imzot Stamati, i cili kle i prasm pishkop i Arbërisë me tru. Midis

pishkopvet Mele e Stamati Eparkia pat personaxhe sesi papasërat Sepa, Solani, Manoli, Matrangolo, si Vorea Ujko, sesi arkimandriti Tamburi, i cili, i prasm, kle i vën ket një angon.

Pas këtyrve, errësia. Jo një që di e vë dy fjalë bashk, as litisht as arbërisht – ngë fjasmi për grekishtjen: ngë gjegjia kurrë nj' omeli e denjë t' ishë e gjegjur (për këtë më të shumëngë marjin meshen par se të mbaronj predhëka). Jo një theologë që shkruajti gjë të denjë t' ish' i mejtuar. Firastin Vangjelin e e bën prallë. E me këtë lllindrune që kemi rreth rreth, e disa narcizra, u bë historia e Arbërisë, e Ungris e Eparkisë. E e Ungris, sidomòs. Ka trizetë vjeç e më, e ture ardhur ket motet tanë, që Eparkia e Ungris e Arbëria ngë patëtin një personaxh ket lartësia e motit që jetomi e të situatëvet të rea.

Papàs Matrangolo (ftesa nëng kle edhe të këtyrve personaxhe që ngë ditëtin e paraqitëtin ardhmjen?) tue qajtur mbë situatën tonë vej ture thën: Ngë dimi më që jemi, ndose jemi litinjë ose arbëreshë, katolikë ose ortodoksë. U kutënduam të njëj i pakujdheshem katekizëm, e ngë djavastim kurrë një teologji serjose, as litire as ortodokse. U kutënduam njëj meshejet njetër aq më e pakujdheshme se katekizmi.

U kutënduam t'ishim te l' Azione cattolica, si te një parti politikë. Skruami pralla mbë Arberinë, e u qëlluum ket "quies intellectus".

Sot kur Vatikani na lipën një peshpëk ngë dimi ku kem' t' e gjëmi. E farrabullaret (i cialtroni) tanë marmarosen.

Për këtë ngë kemi kujit t' i japmi ftesën. Ftesa ë jona. Kutëndofemi të festivalvet e të bëmi vallet. Bëmi kund se jemi akoma të gjallë, po jemi fantazme, të mir vet për kastrofilotët të Parkut të Pulinit, që na burthojin si Indianëra ket një rezervë, pra që na shajtin: "li gjegji li kanjuoli". E te retorika të Parkut biremi.

Për këtë: "Zitti e muti", ju lutem.

I dedikonj këtë shkrim gjithëve atyrve që më kritikojin e ngë më durojin kur kirkonja t' i zgjonja, ture i dhuruar ndonjë vështirsi intelletuale, ka gjumi e ka ëndret t' ëmbël të tyrve: të Skënderbeut e t' Arbërisë së lashtë e së përjetshme. E kërkonja të mbillnja farë ardhmje, pse ndienja se ishim po të vdisjim. Profetia ime, e lehtë, sot realizohet.

Ndikimi i italianizmave në gjuhën e Arbëreshëve të Italisë

1960, kohë në të cilën përfundoi së realizuari Fjalori arbërisht - shqip i autorit Kolë Kamsi.

Në këtë vështrim, mund të pohojmë se: arbërishtja e shqiptarëve të Italisë përbën një varietet gjuhësor më vete, gjeografik e historik njëherësh, me tipare dalluese e në ndryshim të vazhdueshëm si rezultat i faktorit kohë.

1) Gj. Shkurtaj, Ligjërimet arbëreshe, Tiranë, 2006, f. 37; 2) R. Titone, Bilinguismo precoce e educazione bilingue, Armando Editore, Roma, 1972, f. 254 – 257; 3) Gj. Shkurtaj, Ligjërimet arbëreshe, Tiranë, 2006, f. 17

In questo scritto abbiamo messo a fuoco l' influsso dei prestiti italiani nella lingua degli Albanesi d' Italia. Per questo è stato analizzato il Vocabolario Arbëresh-Albanese di Kolë Kamsi. Quest' opera riflette ampiamente un processo di corrosione linguistica che era iniziato nelle parlate arbëreshe. Su 8600 lemmi di cui è composto questo Vocabolario, risulta che 1568 di loro sono prestiti italiani, quasi il 20% del lessico arbëresh. Questi prestiti lo studioso Kamsi li ha suddivisi nei rispettivi dialetti: friulano, napoletano, siciliano, veneto, calabrese; dialetti legati strettamente l' uno all' altro, ma non completamente comprensibili reciprocamente. E' vero, la lingua arbëreshe ha subito influssi dall' italiano, soprattutto nel lessico, ma è anche vero che ha dimostrato capacità di assimilarli e di cambiarli secondo il proprio modello, dimostrando la sua forza e vitalità. Questi prestiti raramente li incontriamo nella loro forma pura; generalmente vengono inseriti nel sistema fonetico e morfologico della lingua arbëreshe, sottoponendosi a un processo conosciuto come "albanesizzazione". Possiamo dire che il lessico arbëresh, visto attraverso questo Vocabolario, benchè influenzato dagli italianismi, ha comunque conservato una ricchezza preziosa di parole uguali a quelli dell' albanese, o, come minimo, con quelli di qualche sua parlata, specialmente del sud. Tuttavia, la lingua albanese che parlano gli arbëreshë d' Italia si presenta come una varietà a sè stante, che non è completamente identica con nessuno dei dialetti dell' albanese nelle aree compatte balcaniche.

Vertikaliteti i përditshmërisë dhe alegoria e heshtjes

(Rasti 'i çuditshëm' Bedi Pipa në "Ditarin intim")

Bayjola Shatro M.A.

pedagoge e letërsisë shqipe në Universitetin e Durrësit

Në larmishmërinë e madhe të kulturës dhe letërsisë shqipe të viteve '30 -'40 (pjesërisht) me krijesit e shkëlqyer të asaj kohe, shtrirjen disipërmasore në filozofi, kritikë, ndjeshmëri e botëperceptim, bie në sy një pririje që koha më vonë do të dëshmonte se rezultoi në produktin zhanror të ditarit dhe memuaristikës. Mjafton të kujtojmë sfondin e pikërisht këtyre viteve dhe më tej ngjarjet e gjysmës së dytë të viteve '40 të përshkruara aq mjeshtërisht në një nga veprat më të mira të këtij lloji në letrat tona, tek vepra e at Zef Pllumit. Në këtë kuptim memuari shfaqet mirëfilli si dëshmia e njerëzve të zakonshëm në kohë dhe në rrethana të jashtëzakonshme. Në të tilla rrethana shënimet vetjake të këtyre njerëzve fitojnë një status të ri brenda konceptit tonë për një sërë fenomenesh shoqërore, kulturore dhe bazuar mbi disa vlera të posaçme, ato marrin edhe një pozicion brenda sistemit letrar.

Memuari kategorizohet në zhanret autobiografike dhe megjithatë ndonëse nuk është mirëfilli lloj letrar shpesh ndahet prej këtyre të fundit veç nga një kufi tepër i brishtë, nga ai element që e quajmë fiction-i i pastër.

Nga ana tjetër, memuari është kaq tërësisht vetjak si lloj shkrimi sa që shndërrohet në paraqitjen e mënyrës në të cilën ikush e mban mend jetën e tij, ndërkohë që autobiografia nga ana tjetër është histori, kërkim faktesh etj.

Shënimet e Ditarit intim të Bedi Pipës, janë shkruar në formën e një tipi të veçantë eseje që njihet në tipologjinë e teksteve akademike si ese personale. Ato gjenden midis shkrimit letrar dhe atij publicistik e argumentues. Sigurisht në rastin e letërsisë shqipe, kur fatkeqsisht në kritikë e studime pririje dhe formati eseistik ka munguar e madje jo rrallë, me dritëshkurtësinë më absurde, gjoja në dobi të argumentit shkencor, ai është ndrydhur e shmangur, sigurisht edhe theksimi i vendit të rëndësishëm të esesë personale e ca më shumë memuarit, kërkoi kohë që të merrte vëmendjen reale. Në paraqitjen e tij për lexuesin, në botimin e këtij libri, Arshi Pipa shpjegon se shkrimet e këtij ditari mund të ndahen në tri kategori kryesore: në ato me karakter psikologjik e kryesisht përshkruar të fenomeneve psikike dhe të pavetëdijshme, në ato me karakter teorik dhe në kategorinë e shkrimeve me natyrë morale. Ajo prek tema të tilla aspak të zakonshme as për kohën dhe as për moshën e saj fare të re: Vetmia, lumturia, shpresa, halucinacionet, parandjenjat dhe telepatia, simpatia, urrejtja, vlera e jetës, sundimi i vetes, artificialiteti, vullneti, martesja, vuajtjet e brendshme dhe enigma e njeriut, si edhe besimi në Zot. Ajo temë të cilën B.Pipa e ka prekur në një mënyrë tronditëse duke provuar dhembshtëm saktësinë e parandjenjave të saj, është vdekja.

Fenomeni Bedi Pipa sado që ne e shikojmë brenda logjikës së ditarit dhe memuaristikës në letërsinë shqipe është në shfaqje të përkundërt me normën, sipas të cilës fama e autorëve na nxit më fort drejt leximeve të këtyre zhanreve. Ndërsa tani është pesha dhe çudia e këtij teksti që na nxit të zbulojmë autorin dhe bashkë me të një kohë të tërë, një botëperceptim, një shije letrare dhe artistike të materializuar në një tekst konkret, që deri fare pak kohë më parë ishte i panjohur.

Po flasim për memuaristikë, pra po flasim në një kuptim

gjithëpërfshirës për kujtesën. Hyjnesha e kujtesës, titanida Mnemozinë kishte një vend nderi ndër hyjnitë greke. Tek "Teogonia" e tij, Hesiodi thoshte se mbretërit dhe poetët i marrin fuqitë e tyre të ligjërimit autoritar dhe mbërthyes, nisur nga sa ata zotërojnë Mnemozinën dhe nga raporti që vendosin me bijat e saj, Muzat, të cilat i lindi të nënta në nëntë netë, pasi u bashkua me Zeusin. Një lidhje mes Mnemozinës dhe femërores në cilësinë e kujtesës nuk e shikojmë vetëm në antikitet, por edhe në teoritë moderne të Heidegger-it dhe J.Derrida-së. Po të kujtojmë Heidegger-in tek "Çdo të thotë të mendosh", ai ngrinte logjikën e Mnemozinës duke folur për kujtesën si për atë që i përmbledh mendimet. Ndërsa trajtonte poezinë e Holderlinin "Mnemozina" ai shkonte përtej komentit për rolin e hyjneshës Mnemozinë dhe thoshte se kujtesa nuk është thjesht aftësia psikologjike për të rajtuar një përfaqësim mendor të një ngjarjeje të të shkuarës, por do të thotë, diçka për të cilën ia vlen të mendosh.

"[Memoria] është pra mbledhja e kujtimit mendues ndaj asaj që duhet konsideruar përpara çdo gjëje tjetër, duke arritur me këtë mbledhje të strehojë pranë saj dhe të fshehtë brenda vetes atë e cila duhet të mendohet paraprakisht, në lidhje me gjithçka që ajo është (west) e që deklarohet si e qenë dhe e patur qenë që në origjinë. Për këtë arsye, Memoria, kujtimi i mbledhur e i kthyer drejt asaj që duhet menduar, është toka nga ku buron poezia." Në këtë kuptim Bedi Pipa, me thjeshtësinë e një vajze 20 vjecare të viteve '40, e ndjeshme, me një formim tejet të admirueshëm për kohën kur jetoi dhe njëkohësisht me perceptimet e mprehta të një natyre të thellë, na thotë se provat e vetvetes dhe njohja e asaj që jemi është dicka për të cilën ia vlen të mbash mend dhe të mendosh, pra ia vlen ta ruash në strehën e kujtesës, në një memuar. Kjo, më së fundi, do të thotë të prekësh njërën prej dy temave bazë të letërsisë dhe të mendimit të të gjitha kohëve, pra të prekësh pragun e letërsisë.

Heidegger tek "Çdo të thotë të mendosh" pyet: "Po çfarë synon kujtesa? Atë, që të na mbajë në qenie, për aq kohë sa të gjejë tek ne konsideratën e saj." Ja, çfarë qetazi vjen të dëshmojë Bedi Pipa, më shumë se 60 vjet pas vdekjes, një alegori të shkëlqyer të cilësisë kryesore të psikologjisë njerëzore e vecanërisht femërore mishëruar në muzën e kujtesës Mnemozinë dhe ciklit të thellimit, rrotullimit dhe përmylljes tek vetja për të dëshmuar vetëdijen e përkatësisë gjetkë, pakënaqësinë e shpirtit fisnik, i cili intuitivisht dhe qenësisht ka perceptuar përmasat e epërme drejt të cilave qaset me vetanalizë, ndjeshmëri fine dhe dialog të heshtur. Kjo, më së mbrami do të thotë të bësh/ të bëhesh letërsi.

1) Arshi Pipa, Paraqitje për lexuesin, "Ditari intim", Botime Fjala 2007, fq. 16;

2) Martin Heidegger, "Leksione dhe konferenca" Plejad, Tiranë, 2003. Fq. 106;

3) Martin Heidegger, vep.cit.

Vertikaliteti i përditshmërisë...

(vjen ka faqja 24)

Al genere memorialistico si lega il nome di un'autrice, un fatto che per la nostra letteratura ha un valore specifico, se si pensa che, ad esclusione di Musine Kokalari, fino agli anni '60, non si sono avute altre creatrici nella nostra letteratura (senza voler entrare comunque nei processi dentro il dominio degli studi di genere). Proprio all'inizio degli anni '40 è stato scritto un testo che consideriamo come uno dei casi più rappresentativi del genere diaristico per le lettere albanesi: "Il Diario intimo" di Bedi Pipa. Questo testo, più tardi, il fratello dell'autore, lo studioso critico Arshi Pipa, l'avrebbe corredata di un apparato esplicativo e un'ampia relazione per la pubblicazione. Questo libro è stato pubblicato nell'anno 2007 nella collana "Ad memorandum" dalle Edizioni Fjala. Noi qui presentiamo alcuni tra i lineamenti fondamentali di questo testo letterario, che lo rendono un documento importante che stimola analisi interdisciplinari, dopo che tocca e tratta spesso in profondità notevoli questioni, come il gusto letterario del tempo, la filosofia e l'emozione femminile in un periodo della loro invisibilità nel mondo culturale albanese, la traforazione delle caverne dell'interiorità umana e le prove del carattere, ecc...

La forma letteraria, spesso molto impressionista, ingrana la meditazione, la riflessione filosofica, i contesti sociali, gli scontri culturali e di mentalità, dei calchi per metà o completamente pronti per la vita, la letteratura e la donna di quel tempo, la psicologia e gli enigmi dell'incoscienza nell'individuo, ecc...

Kaloi në amshim Arkimandriti...

(vjen ka faqja 13)

Il 22 settembre è passato a miglior vita Mons. Eleuterio Fortino, per lunghi anni sottoposto a dialisi a causa di una malattia renale. Nonostante la sofferenza, egli continuò con zelo l'attività a favore del movimento ecumenico quale sottosegretario del Pontificio Consiglio per l'Unità dei Cristiani. Nel contempo non tralasciò il suo impegno pastorale a favore degli arbëreshë di Roma, quale rettore della Chiesa di Sant'Atanasio.

Nato a S. Benedetto Ullano da genitori arbëreshë, alunno del Collegio Greco, studi alla Gregoriana, papà nel 1963, dal 1965 inserito nell'isituzione pontificia relativa alla promozione dell'unità dei cristiani, di cui diverrà animatore e memoria storica. Personalità poliedrica, assommava in sé gli aspetti dello studioso, del pubblicista, del pastore, del fine dialogante con gli ortodossi, dell'amico aperto e accogliente, del consigliere prudente.

Amante della tradizione arbëreshe, fondò il circolo culturale BESA e l'omonimo foglio mensile.

Per gli albanesi d'oltre Adriatico fu punto di riferimento costante, "porta e finestra" per l'accesso alle istituzioni vaticane; e a quelle italiane per il vescovo Nikë Prela, primo presule dei cattolici di Kosova.

Estimatore di Madre Teresa, recensiva volentieri le opere a lei dedicate. Soleva dire, a proposito delle pubblicazioni albanesi di matrice ecclesiastica: "La nostra Chiesa, il nostro popolo hanno bisogno di essere presentati in maniera quanto mai dignitosa. Madre Teresa e Mons. Nikë Prela hanno onorato e arricchito la Chiesa e il Popolo albanese".

L'Arhimandrita Mons. Fortino fu persona che, dalla bocca e dal cuore, sempre spargeva e donava prudenza, bontà e soprattutto amore.

Riposi in pace e interceda per noi!

Kryeartikulli

(vjen ka faqja 3)

Ungrës. Ky ka të ketë idë të qarta, kulturë bixantine, zëmër arbëreshe e shkop të ngurët. E ka të ruanjë ka del dielli, më shpejt se ka hyn dielli. Eparkia e Ungrës u le (1919) për të mbjethë Arbëreshët Bixantinë e t'i mbanjë të bashkuar te Riti Bixantin: me Shëjtrat e tyre, me lkonat e tyre, me Këndimet e tyre, me Tipikonin e tyre, me Sinodet e tyre, me Gjuhët e tyre (Arbërishtja e Greqishtja). Roma s'na do lëtinj, na do Bixantinë; s'na do italianë, na do Arbëreshë. Një herë, kur ish zakoni të këndohej natën, trimat i kallëzojin mallin vashazvet të tyre, nën dritësoret e tyre, me vjershe e graxeta: domethënë me këndime, jo me fjalë të recituara. E vashat arbëreshe ishin shumë të gëzuara. Edhe Inzot, te Qishat Arbëreshe, preferon prifrat që këndojnë arbërisht/grek, jo ata që recitojnë lëtitsh. Eparkia e Ungrës zu historinë e saj me peshpkun Mele, që mbanij unazën te gjishti, doj mirë vet grekun, e statuat s'i nxuar ka qishat; peshpku Stamatit s'e vu unazën, kalli Arbërishten e më lkona ndër qishat; me peshpkun Lupinaçi Eparkia bëri një hap përpara e dy prapa. Me Peshpkun e ri Eparkia e Ungrës ka të jetë më Bixantine e më Arbëreshe.

Papa Benedikti XVI pret, ka Eparkia e Ungrës, një kandidat peshpk të denjë; e pret ka prifrat arbëreshë uniformitet liturgjik e njësi zëmrash dhe mendjesh. Për mos t'e qajën besimtarët arbëreshë, të babartur e të ndajtur, po që duan aq Ritin Bixantin sa Gjuhën Arbëreshe.

D.

Questi deve avere idee chiare, cultura bizantina, cuore arbëresh e bastone nodoso. E deve guardare a Oriente, piuttosto che ad Occidente.

L'Eparchia di Lungro è nata (1919) per radunare gli Arbëreshë Bizantini e per tenerli uniti nel Rito Bizantino: con i loro Santi, con le loro Icone, con i loro Canti, col loro Tipikon, con i loro Sinodi, con le loro Lingue (Albanese e Greco).

Roma non ci vuole latini, ci vuole Bizantini; non ci vuole italiani, ci vuole Arbëreshë.

Una volta, quando si usava cantare di notte, i giovani dichiaravano l'amore alle loro ragazze, sotto le loro finestre, con stornelli e strambotti: cioè con canti, non con parole recitate. E le ragazze arbëreshe erano molto contente.

Anche Dio, nelle Chiese Arbëreshe, preferisce i preti che cantano in albanese o greco, non quelli che recitano in italiano.

L'Eparchia di Lungro ha iniziato la sua storia col vescovo Mele, che aveva l'anello al dito, amava solo il greco e le statue non le tolse dalle chiese; il vescovo Stamatit non lo mise l'anello, ma introdusse la Lingua Albanese e Icone nelle chiese; con il vescovo Lupinacci l'Eparchia ha fatto un passo avanti e due indietro. Col vescovo nuovo l'Eparchia di Lungro deve essere più Bizantina e più Arbëreshe.

Papa Benedetto XVI aspetta, dall'Eparchia di Lungro, un candidato vescovo degno; e aspetta dai preti arbëreshë uniformità liturgica e unità dei cuori e delle menti. Perché non ci vadano di mezzo i fedeli arbëreshë, confusi e divisi, i quali però amano sia il Rito Bizantino che la Lingua Arbëreshe.

D.

Shqyrtime Sociolinguistike për Emrat

Helena Grillo, M.A.

pedagoge e gjuhës shqipe, Univeriteti i Vlorës

Problematika e shqyrtimeve e hulumtimeve gjuhësore gjithnjë e më shumë në ditët e sotme po orientohet në thellimet e studimeve sociolinguistike e etnolinguistike¹. Më tepër se nga mungesa e hulumtimeve sociolinguistike para viteve 90, kjo problematikë thellohet po të kemi parasysh ndryshimet shoqërore, sociale dhe demografike të viteve të fundit. Por tashmë mendojmë se ka ardhur koha që mes kundërimeve sociolinguistike e etnolinguistike, që përbën lënda, e cila lidhet me emrat vetjakë, me emrat familjarë e farestisnore, të bëjmë një analizë të hollësisht për marrëdhëniet familjare e fisnore në krahinë e Himarës. Këto analiza do të na shërbejnë si baza studimesh krahasuese mes krahinash e trevash që paraqesin gjithmonë interes për studimin e shqipes e historisë së gjuhës. Këto marrëdhënie do të dalin e pasqyrohen më të plotë mes “etnografisë të së folurit”

- Me interes duket për t'u studiuar sinonimia e emrave familjarë e farestisnore të përfutur nga trysia shoqërore dhe kulturore. Emërtimet sinonimike janë shumë të larmishme për lidhjet e marrëdhëniet e farestisnës, lidhjet familjare, martesore e gjinore etj. Studiuesi kosovar Shefki Sejdiu nënvizon: “Për të mënjauar homoninë dhe ngatërrimin, ndër shqiptarëve janë ndërtuar struktura nomenklaturave sinonimike, që janë të karakterit “squares” dhe që përdoren me tepër në komunikimin indirekt me të tjerët: kushëri; djalë axhe; nip; djal dajë (çikë, motra, halle) gjysh; baba i babës (i nënës)².

Në krahinë e Himarës përdoren për fjalët e shqipes standard; bab/ë-a; mam-a; tat/ë-a; mëm/e-a

Në marrëdhëniet familjare ndeshim emërtimet të përbëra e të përngjitura, të cilat ndryshojnë edhe nga raportet familjare e shkalla shoqërore si; tat zot/i – babai i babait (gjyshi)

Zakonisht fëmijët e vegjël e brezi i mesëm përdorin:

Babai e babait – papu

Babai i mamasë - papu (trajtë sinonimike Papu – prift që shërben në kishë) Papu–li Shihet qartë ndikimi grek për këtë emërtim.

Për Gjyshe, nëna e babit : Gjyshe, nëna e mamasë, e folmja e Himarës ka të njëjtin emërtim; nona. Ky emërtim mund të jetë huazim nga italishtja, ose mund të jetë përfutur si rezultat i ndryshimeve fonetike dialektore në^ona –nona . Kthimi i ë –së në një o (o e labializuar) siç ka ndodhur edhe në fjalët gjë^o – gjo, pë^o – po

Ashtu si në çdo krahinë, edhe këtu kemi përdorimin e respekt formave për të moshuarit:

Për seksin femër halle/e : Si i dive o halle? Qish je halle Lilitua?

Për seksin mashkull barba (Barba Nikua, Koçua, Seu (Odise), Foto

Për të emërtuar profesione e për të shprehur respektin gjuhësor ndeshim formime të tilla: Emër (ndajshim) në trajtë të pashquar + emër vetiak në trajtën e shquar: Doktor Pirrua ; Mësues Ndreku

Emrat e farestisnës shprehin edhe “statusin shoqëror e etno kulturor.”

Këto marrëdhënie pasqyrohen edhe gjuhësisht. Në krahinë e Himarës bashkëshortët nuk e zinin në gojë emrin e njëri – tjetrit. Këtë e ka pasqyruar shumë bukur poeti Ali Asllani te “Hanko Halla”

“Ah thot’Hanko Halla, - kur ishte Ai gjallë

*Kurr’ nuk bënte gëk njeri në mëhallë
Ai na thotë halla, pasi femra kurrë*

S’ mund t’i flasë në emër burrit që ka burrë

Zakonisht, në vitin e parë të martesës, gruaja i thotë burrit: Ki; ndërsa burri: o nuse, pastaj o grua, o plakë
Në krahinë e Himarës burri (përkatesisht gruaja) në vend që të thërrasë të shoqin (përkatesisht të shoqin), thërret emrin e djalit apo të vajzës.

Po kështu dhe vjerra e vjerri nuk e thërrasin në emër nusen e djalit po i thonë thjesht nuse. Pas disa viteve martese mund t’i thërrasin në emër (kjo ka ndodhur pas viteve ’50.) Kurse nusja u drejtohet prindërve të burrit (Zot /i dhe Zonjë)

Pra , pothuajse në të gjithë krahinë në marrëdhënie të tilla nuk përmendeshin emrat e përveçëm (Lilo, Petro, Thoma Dhoski, Niko, Gogo)

Ata zëvendësoheshin me emërtimet e sipërpërmendura.

Për të vazhduar këtë traditë, si dhe për të ruajtur “statusin” shoqëror të djalit të madh, shpesh në një moshë të thyer gratë e moshuara thirreshin në emrin e djalit të madh.

Mëm/ë –a e Thomajt ;O mëm/e Thomajt; Mëm/a e Nikos; Po kështu, për të shprehur lidhjet shoqërore më të ngushta. Në qoftë se do t’i drejtohej shoqja e vajzës (Klementina), si për të shprehur marrëdhëniet e afërt shoqërore me të, ajo o drejtohet ; mëm/ e Klemes.

Ashtu si të gjitha fjalët dialektore, edhe antroponimet në varësi të përdorimit kanë pësuar ndryshime fonetike e morfologjike në ndikimin dialektor.

Zakonisht emrat vetiakë janë emrat të besimit ortodoks; Irakli, Andon, Petro, Thoma, Maria Foto, Ndreko, Pavlo, Odise, Jorgo, Kiço, Marrë, Llambro, Klearko, Jani, Dhoksi, Niko, koço, Lenë, Andon, Janullë, Kleme.

Kemi përndarje të formave fonetike të emrave të hershëm ndër shqiptarë: Gjon, Jani. Në brezin e mesëm e të ri ndihet një farë largimi nga këta emra, prireja e shqiptarëve për të vendosur emra të huaj. Nga ky ndikim nuk ka shpëtuar edhe krahina e Himarës, megjithëse ky ndikim ndihet më i zbutur apo errësuar³. Kemi emra Daniel, Brunildë, Orsiola, Ilda, Krisida, Xheni, Stefania.

Krahas ligjeve të zhvillimit të natyrshëm fonetik “kanë fryrë edhe erërat e ndikimeve kulturore dhe shoqërore prej viseve e etnive fqinje”⁴.

Si përfundim, mendojmë se edhe në këtë fushë kjo krahinë është thellësisht ruajtëse e konservative, pavarësisht se për “modernistët” kemi edhe raste të daljes nga tradita.

Përgjithësisht, në brezin e ri është përhapur gjerësisht tradita e ringjalljes së emrave të vjetër fisnorë, të babait, gjyshit, gjyshes si për emigrantë, kryesisht në Greqi, ashtu edhe për ata që banojnë aty.

Me lëvizjet e mëdha demografike, në këtë krahinë ndeshin edhe emra të rinj shqiptare, modern, emra të huaj perëndimore, emra personazhesh , aktorësh të ndryshëm, madje edhe emra të besimit mysliman (nga të ardhurit).

(ec te jetra faqe)

Tiranë 1986, Otranto 1991, Shkodër r 2010**(Imazhe që më shoqërojnë)**

Motra e vogël Liçia, që disa herë ka vizituar Shqipërinë qysh në 1986; sivjet ka kaluar muajin maj te Motrat e vogla në Tiranë: ajo na komunikon imazhe që e kanë shoqëruar atë gjatë qëndrimit të saj në Vëllazërinë e tyre.

Tiranë 1986, festa e 1 majit - Një turmë e pafund personash, që, me lulekuqe në dorë, i thurin himne Partisë dhe “realizimeve” të saja, të cilat dëshmojnë me paradën madhështore të automjeteve në Rrugën “Dëshmorët e Kombit” të qytetit.

Një gëzim jo i vërtetë, një qëndrim i diktuar nga frika dhe nga tmerrri, një uniformitet i jashtëm që dëshiron të bëjë të besojë se ky gëzim është edhe në zemrën e njeriut... Një liturgji fallsiteti, buzëqeshesh, këngësh, “himnesh” miratimi: një popull në festë, në ecje, sikur në fund të kësaj të kishte ende diçka të re për të zbuluar, diçka pozitive...

Pas disa ditësh feste, zyrtësia dhe monotonia e një të përditshmeje të rëndë si një plumb, që shtyp dhe pengon çdo dëshirë lirie dhe shprese.

Otranto, mars 1991 - Një turmë e pafund: të rinj, fëmijë e të mitur, ushtarakë që arrijnë mbi një anije të vjetër nga Vlora. (Gjashhtë shqiptarët e parë kanë ardhur në Otranto nga Elbasani në korrik të vitit 1990). Një sfilatë jo më prej automjeteve që i thurin lavdi Partisë, por anijesh të vjetra, argshe, gomone... në dorë nuk kanë më lule, por bëjnë shenja fitoreje! Vijnë të plagosur, disa të vdekur, të shkatërruar, me tmerr në sy, mosbesues se kanë mundur të kapërcejnë detin, mosbesues se kanë mbërritur në një tokë që do t'i mikpresë... një turmë me qindra e mijëra burra, gra, fëmijë për të cilët jo gjithmonë jeta do të jetë e lehtë!

Por kanë shpresë se të paktën një herë nuk janë tradhtuar, gënjyer, shtypur... drita në sytë e tyre, edhe pse për pak kohë, ka ngjyrën e tëfëmijës që beson gjithçka dhe pret gjithçka.

Kampet e refugjatëve... nuk është kjo ajo që prisnin!... Më pas secili kërkon dhe merr rrugën e vet, një punë që i ofrohet, kush mirë, kush keq... me keqardhjen e vetme për familjen që ka mbe-

Motra e vogël Liçia e Jezusit

nga Tirana

tur në Shqipëri, duke pritur që t'i përqafojnë sërisht... Fillohet një e përditshme e re, që përbëhet nga pritshmëri, sepse siç dihet trashëgimia e imigrantit nuk përbëhet vetëm realizimi i shumë ëndrrave të drejta, por këto ëndrra shoqërohen edhe me shumë vuajtje, lënie pas dore dhe mospranim... megjithatë janë të lirë me shpresën se do t'i gjejnë edhe rrënjët e tyre fetare.

Shkodër, maj 2010 - Jo më automjete që i thurin lavde Partisë, jo më argshe apo anije për të ikur, por makina e autobusë që shkojnë në Shenjtëroren e Shkodrës nga rrethinat, nga fshatrat që ndodhen afër maleve, autobuzë të mbushur me njerëz, ashtu si zemra e secilit është e mbushur me shpresë...

Shpresë që ka mbajtur gjallë fenë në dhjetëvjeçarët e dhunës dhe të torturave, shpresë e vënë në Atë që thirret “Nëna e Këshillit të Mirë – mbrojtëse e Shqipërisë”, ‘Ajo që nuk jep ideologji të rreme, por Birin e vet, Udhën, të Vërtetën dhe Jetën (Gjon Pali II).

Po, jo më automjete, jo më anije, por një turmë e pafund, gra, të rinj, të moshuara me kostume shumëngjyrëshe, të moshuar që kanë të vultosur në fytyrë – në thellësinë e rrudhave – shenjat e historisë së tyre, me sy që duket sikur duan të depërtojnë Misterin! Të moshuar që mbajnë në duar fëmijë, nëna të reja, rregulltare...! Kështu, në mes të kësaj turme, të fortë si gurët e maleve të tyre, jemi ndier të vogla, por me një zemër të mbushur me gëzim, mirënjohje, mrekullim, mallëngjim, kaq i fortë ishte intensiteti i lutjes...

Po, të shpresosh është e mundur dhe e kam pyetur veten se çfarë do t'i thoshte kjo turmë botës nëse asaj do t'i drejtohej kjo pyetje: Si mund të përligjim shpresën tonë në botën e sotme? Këto tre momente “turme”, dëshmitare e të cilave kam qenë, më bëjnë të përgjigjem pa ngurrim: Me besim të thjeshtë dhe këmbëngulës në hyjin, Në jetën që rilind çdo ditë...

(Tiranë, maj 2010)**Shqyrtime Sociolinguistike për Emrat e Faresfisnisë dhe Emrat Vetjakë****(vjen ka faqja 26)**

1) Sociolinguistika është një degë e re e gjuhësisë në Shqipëri, e cila ka filluar të lulëzojë rreth vitit 1995 me inicimin dhe kontributin e jashtëzakonshëm të prof. Gjovalin Shkurtaj. Dokumentimi i një Sprovë të tillë në punimin tonë do të shërbejë për hulumtim krahasues në rrafshin e sociolinguistikës mes krahinës së Himarës dhe Arbëreshëve të Italisë, të studiuar nga prof. Gj. Shkurtaj.

2) T. Osmani – S Pepa, Pasqyrimi i eufemizmave në letërsi gojore dhe artistike ULG BSH XXVIII, viti 1995-1996, f.46.

3) H.Grillo, Toponimia dhe antroponimia e Himarës, në Aktet - Revistë Shkencore e Institutit Alb-Shkenca, vëllim III, nr.4, 2009, f.531.

4) Gj.Shkurtaj, Onomastikë e Etnolinguistikë, Tiranë 2001, f.154.

La problematica delle analisi e delle ricerche linguistiche sempre di più, ai giorni nostri, si orienta verso l'approfondimento degli studi sociolinguistici ed etno-linguistici. La Sociolinguistica è un nuovo ramo della linguistica in Albania, che ha iniziato a fiorire intorno al 1995 su iniziativa e contributo straordinario del prof.Gjovalin Shkurtaj. La documentazione di una simile prova nel nostro lavoro servirà per ricerche comparative sul piano della sociolinguistica tra la provincia di Himara e gli Arbëreshë d'Albania, studiate dal prof. Shkurtaj. Nel nostro lavoro studieremo la sinonimia dei nomi familiari e di parentela beneficiati dalla pressione sociale e culturale. I nomi della parentela esprimono lo “status sociale e etnoculturale”, che studieremo anche dal punto di vista linguistico. Dallo studio linguistico si notano influssi greci causati dalla situazione sociolinguistica dell'uso bilingue. Per il nome “gjshe”, la mamma del papà –“nona”, facciamo luce su due ipotesi: può essere prestato dall'italiano o può essere il risultato delle differenze linguistiche fonetiche dialettali, nëna –nona.

Konferencë shkencore**Martin Camaj për kulturën shqiptare. Shkrimtari dhe albanologu**

Qendra kërkimore-shkencore albanologjike, Departamenti i letërsisë dhe Departamenti i gjuhësisë i Universitetit “Luigj Gurakuqi” në Shkodër, më 26 korrik 2010 organizuan konferencën shkencore “Martin Camaj për kulturën shqiptare. Shkrimtari dhe albanologu”, me rastin e 85-vjetorit të lindjes. Në konferencë morën pjesë studiues nga Shkodra, Tirana, Durrësi, Gjermania dhe Austria. Përveç autoriteteve vendore mori pjesë edhe bashkëshortja e M.Camajt, dr. Erika Camaj.

E hapi konferencën prof.dr. Tomor Osmani, i cili në mes të tjerash tha: “Është një nder i veçantë për Universitetin tonë që sot kremtojmë në një konferencë të veçantë 85-vjetorin e lindjes së shkrimtarit dhe filologut, shkodranit nga Temali i Dukagjinit, Martin Camajn, që në të kaluarën moniste emri i tij mbeste si legjendë, por shpejt pas viteve ‘90 emri dhe vepra e tij filloi të trokasë në dyert e shqiptarëve nga Veriu dhe nga Jugu, duke u bërë një personalitet i dashur, i nderuar dhe i respektuar. Martin Camaj e njohu Europa dhe Amerika, por jo atdheu i tij, Shqipëria; e vlerësoi gjuhësia kontemporane europiane, por jo gjuhësia shqiptare; botoi jashtë veprat e tij, por jo në Shqipëri... Ka të drejtë të krenohet Shkodra me Martin Camajn, i cili ndonëse larg atdheut prej afro gjysmë shekulli, nuk e harroi Shkodrën, gjetoi vend në krijimtarinë e tij të kujtojë atë natyrë përrallore dhe magjepse të saj, por mbi të gjitha duke përdorur një gegërishte letrare, të pasur, tingulluese, plastike dhe të zhdërvjellte...”

M.Camaj, ky intelektual i formuar, shkrimtari dhe gjuhëtar, albanolog me dëshirat e gjithanshme për të kontribuar në zhvillimin e kulturës shqiptare, radhitet në plejadën më të zgjedhur të shkrimtarëve dhe gjuhëtarëve tanë...”

Më pas përshëndetën: Zv.Rektori i Universitetit të Shkodrës, prof.dr.Fatmir Vadahi në emër të Rektoratit, z. Ndue Sanaj, kryetar i shoqatës “Atdhetare –Dukagjini, prof.dr. Gjovalin Kolombi, kryetar i Këshillit të qarkut të Shkodrës, prof.dr. Ardian Marashi, drejtor i Qendrës Studimore Albanologjike në Tiranë dhe bashkëshortja e M.Camajt dr. E. Camaj, e cila falenderoi për këtë konferencë organizuesit dhe dhuroi dy kopje të vëllimit në gjermanisht të përmbledhjes për kontributin, kryesisht të M.Camajt, me titull “Ne jemi të tutë”, përgatitur nga prof. dr. Bardhyl Demiraj. Referatin “ “Martin Camaj-krijues dhe dijetar”përgatitur nga prof.as.dr. Ledri Kurti dhe dr. Mimoza Priku e lexoi L.Kurti.

Konferenca vazhdoi në dy seksione ku u mbajtën 34 kumtesa. Në seksionin e letërsisë u lexuan këto kumtesa : A.Jakllari (Tiranë), Poezia e Camajt midis simboleve mitike dhe synkopeve moderne; L.Kurti (Shkodër), Drama apo tekste të dramatizuar “Loja e mbsadrekës” dhe “Kandilli argjandit”; Z. Gjetja (Tiranë), Trajtimi i vendlindjes në veprën e M.Camajt; B.Gjoka (Tiranë), Gëgnishtja, mallkimi dhe lavidia e Camajt; A.Hafizi(Shkodër), Relativizimi i Camajt në novelen “Jesemina”; V.Osja (Tiranë), Çështje të tipologjisë së llojit tek madrigalet “Dranja”; B.Shatro (Durrës), Poezia si botëkrijim dhe estetika e ripërmasimi të kohëhapësirës; Sh.Sinani(Tiranë), Ikja si dukuri në jetën dhe veprën e M.Camajt; V.Karakaci (Shkodër), Qëndrimi i Camajt mbi letërsinë shqipe të Pasluftës; L.Smaqi (Tiranë), Camaj, shkrimtari ideal në vizionin e Koliqit; A. Prendi (Shkodër), Marrëdhënie të poezisë së Camajt me folklorin dhe letërsinë gojore shqiptare; A.Dani-L.Kazazi (Shkodër), Dimensioni përendimor i shkrimtarit dhe gjuhëtarit; E.Alia (Shkodër), Camaj në këndvështrim pedagogjik; E.Ramadani (Shkodër), Romani “Djella”- gërshetim intertekstual midis prozës dhe poezisë.

Në seksionin e gjuhës u mbajtën këto kumtesa: K.Topalli (Tiranë),

Prof.dr.Tomor Osmani

Universiteti i Shkodrës

M.Camaj dhe albanologjia e gjymtuar ; T.Osmani (Shkodër), Konsiderata gjuhësore të M.Camajt për gjuhën letrare shqipe dhe ndihmesa e tij për një afrim dialektor; E. Çerpja-E.Lafe (Tiranë), Sistemi foljor te vepra “Lehrebuch der albanischen Sprache dhe Albanian Grammar “ të M.Camajt; Gj. Shkurti (Tiranë), M.Camaj-figurë e shquar e albanologjisë dhe e letërsisë shqiptare; B.Demiraj (Gjermani), Camaj në karrieren e tij akademike; M.Priku (Shkodër), Rreth disa ndërtimeve foljore në prozën e M. Camajt;T.Topalli (Shkodër), Kontribut gjuhësor i panjohur i M.Camajt; E.Paci (Tiranë), Pikëpamjet e Camajt për “Mesharin” ((Vështrim filologjik dhe tekstologjik mbi librin e parë të gjuhës shqipe); I.Arapi (Austri), Pasuri leksikore te “Njeriu më vete e me të tjerë; Rr.Draçini-E.Hoti (Shkodër), Vështrim psikolinguistik i veprës “Pishtari i natës”; M.Parllaku (Tiranë), Sintaksa e M.Camajt si pasuri gjuhësore e shqipe; A.Kosteri (Shkodër), Disa veçori dialektore të romanit “Rrathët” të M.Camajt; A. Uruçi (Shkodër), Çështje të fjalëformimit të veprës “ Drandja madrigale” e M.Camajt; O.Dushi- T. Çoku (Shkodër), Konsiderata rreth sistemit foljor në një veprë letrare të Camajt; A.Kraja- V.Sakej- A.Kaloshi (Shkodër), Fenomeni i mënjanimin të së ashtuqajturës nyjë të përparme të veprës së Camajt; A.Hoti-A.Osmani (Shkodër), Risetit në gramatikën shqipe të M.Camajt; M. Bushi (Shkodër), Letërkëmbimi i M.Camajt me Gj.Sinishten.

Konferencën e ndoqën një numër i madh intelektualësh e qytetarë nga Shkodra dhe Tirana dhe vlerësuan këtë aktivitet për nivelin shkencor të saj.

Konferenca u mbyll me promovimin e përmbledhjes studimore të vëllimshme prej 600 faqesh për M.Camajn “Na jemi të tutë”, përgatitur nga prof.dr.B.Demiraj.

Ky aktivitet u mbështet nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe Shoqata “Atdhetare-Dukagjini”.

Il Centro di ricerca scientifica albanologica, i Dipartimenti di Letteratura e di Linguistica dell’Università “Luigj Gurakuqi” di Scutari, il 26 luglio 2010 hanno organizzato una Conferenza scientifica, dal titolo “Martin Camaj per la cultura albanese. Lo scittore e l’albanologo”, in occasione dell’85mo della nascita. Alla Conferenza hanno preso parte studiosi da Scutari, Tirana, Durazzo, Germania e Austria. Era presente anche la consorte di M.Camaj, dr. Erika Camaj. Ha aperto la Conferenza il prof.Tomor Osmani, che tra l’altro ha detto:”Nel passato totalitarista il nome di M.Camaj fu come una leggenda, ma presto, dopo glia nni ‘90 il suo nome e la sua opera iniziò a bussare alle porte degli albanesi, da nord a sud, divenendo una personalità amata e rispettata. Martin Camaj lo conobbe l’Europa e l’America, ma non la sua Patria, l’Albania...”La Conferenza è poi continuata in due sezioni, linguistica e letteraria, in cui sono state lette complessivamente 36 comunicazioni. Nella sezione letteraria hanno preso parte due collaboratrici di Jeta: L.Smaqi(Tirana) e B.Shatro (Durazzo); nella sezione linguistica, oltre al prof.T.Osmani, altre tre collaboratrici di Jeta: I.Arapi (Austri), Rr.Draçini ed E.Hoti (Shkodër). La Conferenza si è conclusa con la promozione del libro di 600 pp., curato da B.Demiraj, “Noi siamo tuoi”, una raccolta di studi su M.Camaj.

Arkimandriti Eleuterio F. Fortino

(vjen ka faqja 12)

dhe Skanderbeku i fatatur (nr.41/2005), *Babuini dhe Historia e Arbëreshëvet* (nr.40/2005), *Besa e Lëtinjvet* (nr.39/2005), *Babuini, Ikonat e Statuat* (nr.38/2005), *Babuini, Ndrikulat e Hënza* (nr.37/2005), *Babuini, Papa i ri dhe maçet* (nr.36/2005), *Babuini e Kalimera e Lazarit* (nr.35/2005), *Atmosfera e Sinodit t'Arbëreshëvet* (nr.34/2005), *Sinodi i Arbëreshëvet* (nr.33/2005), *Babuini e Natallet* (nr.32/2005), *Babuini e mesha arbëreshe* (nr.31/2004), *Jo vet pfishrat venë Grotaferratë* (nr.30/2004), *Kongresi i të Urtëvet* (nr.29/2004), *Joket Olimpikë* (nr.28/2004), *Babuini, Evropa dhe Abetari* (nr.27/2004), *Përpara varrit t'Emil Tavolarit* (nr.26/2004), *Babuini e Pashkat Bizantine* (nr.25/2004), *Babuini sod flet me tru* (nr.24/2004), *Djali e Ëngjlli* (nr.23/2004), *Babuini sod flet me zëmer* (nr.22/2004), *Babuini e muzika pa fjalë* (nr.21/2003), *Babuini e Draguni* (nr.20/2003), *Penjtë e Shën Nilit* (nr.19/2003), *Il Babuino e gli dei*, nr.17/2003), *Conversazione con il Babuino* (nr.15/2003), *Dialogo con il cavallo di Skanderbeg* (nr.14/2003), *Il sogno di Skanderbeg* (nr.12/2003), *Il coro di Lungro in concerto* (nr.9/2002), *Una lettera da Roma* (nr.7/2002).

Botime të E. Fortino-s të sinjalizuar mbi Jeta Arbëreshe

Pròthesis, Preparazione alla Celebrazione Eucaristica, Il Rito Nascosto, Sussidi Catechetici (48), Besa, Circolo Italo-albanese di cultura, pro manuscripto, Roma 2009; *La Madonna del Buon Consiglio, l'Odigitria degli Arbëreshë*, sussidi catechetici (43), Besa, Roma 2009 (nr.65); *Nel novantesimo di istituzione dell'Eparchia di Lungro (1919-2009)*, Besa, Circolo italo-albanese di cultura, Roma 2009 (nr.64); *Hesychia – Tranquillità dell'anima e del corpo*, sussidi catechetici (47), Besa, pro manuscripto, pp.66, Roma 2009 (nr.63); *Piccola catechesi cristiana secondo S. Atanasio*, sussidi catechetici (46), pro manuscripto, Besa, Circolo Italo-Albanese di Cultura, Roma 2008 (nr.62); *Per una nuova piccola storia – La Chiesa Italo-albanese*, a cura di Agnese Jerovante, Besa, Roma 2007 (nr.54); *Celebrazione del II Sinodo Intereparchiale dei Bizantini Cattolici in*

Fortino Eleuterio F., *Pròthesis, Preparazione alla Celebrazione Eucaristica, Il Rito Nascosto*, a cura di Maria Franca Cucci, Sussidi Catechetici (48), Besa, Circolo Italo-albanese di cultura, pro manuscripto, Roma 2009
Është i sprasmi libërthi i serisë “Sussidi Catechetici” i ndjezot Arkimandritit Eleuter Fortino. Ku folën mbi “Prothesin”, pjesa liturgjike që vjen më parë se të zërë Mesha, ku prifti përgatitën bukën e verën që lypsen për Meshën. Kjo pjesë është pak e njohur ka besimtarët, pse bëhet mbrënda Ikonostazit; për këtë është e thërritur “Riti i fshehur”. Libërthi është i ndajtur ndër tre kapituj: Riti i Prothesis sot; Si ndërroi gjatë motit; Meditim katekitik.

Passarelli Gaetano, *Madre Macrina Raparelli, nel cuore l'Unità dei Cristiani*, Editrice Velar, Gorle (Bg), 2010

Një libër i mirë, që të pëlqen t'e djovansjesh: rrëfyon jetën e Lenës Raparelli, ka Grotaferrata (Roma): ajo që, bashkë me të motrën Njeze, te viti 1930 themelloi “Kongregatën e Murgeshavet Basiliane, Bilat e Shëjtës Makrinë”. Pas “Profesiones fetare”, Lena patë ndërruar ëmrin në “Makrinë” dhe Njeza në “Eumelie”, e këllogjërësja Makrinë qe zgjedhur, atë vit, eprorë (superiora) e përgjithshme. Një këllogjërësje që shpejt do t'jetë e bënur shëjte.

Gjergji Lush, *Nëna e dashurisë*, Lshk & Fkk “Nëna Tereze”, Lironova, Gorle (Bergamo) 2000

Ká dhjetë vjetë ky libër, po s'i buthton fare. Më parë se këtë, autori – biografi më i mirë i Gonxhes Bojaxhiu - botoi të tjera vepra mbi Nënëen Tereze: Nëna jonë Tereza (1980), Lule për Nënëen (1986), Gonxha jonë - nëna e botës (1998). Një vepër madhështore, 250 faqe, ku s'dihet kush ka më rëndësi: fotografitë apo teksti. Këtu xë historinë e kësaj shëjte shqiptare, që dha vetëhenë e saj për të tjerët. “Nëng mund të duash mirë – thoj ajo – pa bënur gjë për të ndihur ata që kanë nevojë/bëzonjë”.

Italia, sussidi catechetici, Besa, pro manuscripto, Roma 2005 (nr.36); *Le quattro note – piccola catechesi sulla Chiesa*, sussidi catechetici, Besa, pro manuscripto, Roma 2005 (nr.35); *Le date di Pasqua, un'anomalia tra i Cristiani*, - Sussidi Catechetici (34) – pro manuscripto, Besa, Roma 2004 (nr.24); *Rinnovamento liturgico nella chiesa cattolica greco-melkita* – sussidi catechetici 32 – Besa, pro manuscripto, Roma 2003 (nr.23); *Le Beatitudini – la vocazione del cristiano*, sussidi catechetici

Assante Franca, *Per una storia di una casale arbëresh*, Napoli 1999

Çë kur ish studente, kjo grua, që sot është profesoreshe universitare në Napoli, tek teza e saj llëure, ndër fund të vitrave '50, zu e u interesua për historinë e këtij katundit. Pra te viti 1999, i muar ndër duar atë pjesë të tezit të saj e e botoi, ashtu si ish, në formë deskriptive. Një studim me dokumente të dorës së parë, ku po problemet - i pari është ëmri i katundit – nëng janë të zgjidhur. Presmi ka kjo profesoreshë njëjtë libër mbi historinë e Purçillit, o, sadopak, të na udhëtonjë për të tjerë kërkime.

Emmanuele Demetrio, *Antichi toponimi di Civita tra storia e leggenda - Èmëra vendi të vjetër e Çifit - histori dhe përballa*, a cura dell'Associazione Gennaro Placco, Civita 2009

Libri hapet me historinë e Çifit, pra shkollën e folën mbi territorin e katundit, mbi Kopelet, mbi vendet arkeologjikë e pëstaj hyn ndër Toponimet arbëreshë: të katundit, të Rrakanielit (Le Gole del Raganello) e të malit (Itinerario della Rrëza); e mbëllihet me disa rrëfime (Storie e leggende) e ca Frazieologjizma arbëreshë rreth Toponomastikës; e pra dica fotografi të bukura, të djeshme e të sotshme.

Unione Europea, Regione Calabria, Comunità Montana Italo-arbëreshe del Pollino, *Una storia un museo - La Filanda Filardi di Civita*, a cura di Renato Covino e Antonio Monte, Race, Perugia 2009

Ky është një libër që na rrëfyon si një Kongë mund të ndërrohet te një Muze. Kur një punë s'bëhet më, kur një strukturë zë e bie copa copa, kur duket se s'vlen më për faregjë, ahiera o do shllënë mbë truall o do restauratur. “Konga Filardi” e Çifit patë fat e qe ndërruar në Ekomuzë. Dje i jip punë pakë vetëve, sot tëhelq milra turistë ka gjithë Tallja. Një Ecomuzë. Një Kongë e një Mulli.

Schirò Giuseppe di Modika, *Radhio i Arbërishtes te Hora - Manuale*, Hora e Arbëreshëvet-Piana degli Albanesi, 2009 Ky është një ribotim, në dhjetë (10) kopje, i librit “Arbërishtja për të gjithë”, manuale (2005). Më parë se këtë, autori ka botuar të tjerë libe mbi gjuhën arbëreshë: Udhëtimi – gramatika, pjesa e parë (2000) e “Udhëtimi paralel” (2002). Një libër mbi Arbërishten e Horës së Arbëreshëvet. Tek paraqitja djovaset: “Manuali është vendi i sigurivët ortogtafike dhe gramatikore, të duhura për të shkollat e folmja tek shkrimi”.

(ec te faqja 31)

Dorëshkrimet e Binard Bilotës (1843-1918)

Pjeqëriza

(1900)

(transkriptoi) **Agostino Giordano**

ka Purçilli (Cs)

Është një poezi e pabotuar, e shkruajtur ka B.Bilota ditën 24-1-1900. Është e përbënur ka 28 tercina e një varg: 85 vargje njëmbëdhjetë rrokjesh. Rimë ABA BCB CDC ... Fletë e veçantë, me katër faqe; cm. 13,5x21. Titulli original: Piekieriza. Faqet nëng janë të nomruara ka autori, si edhe tercinat.

Një poezi autobiografike, mbi Pleqërinë: kur e shkruajti, Bilota kish “vetëm” 57 vjet, mund të jetë se ndihej edhe plak. Poezi e shkruar pa u menduar gjatë, me ndonjë korigjim të rrallë. Im lalë, papas Manuilli Giordano, si zakoni i tij, me laps të kuq dhe blu, gjatë vitevet, i bëri ndonjë korigjim këtu këtye. Këtu botomi tekstin origjinal.

1. Ndë gjellet, kūr lulzonja rrëmbth i rī,
s'pandehja të kish veshksha ndonjëhër,
e mos shihja si qift me këta sī.
2. S'pandehja këmbet mia më mbë karrër
mos vlejën e mos mundja u më qiçe
të bënja, si ndër njerzit burr me ndër.
3. S'pandehja u pjeqëriza të m'ish kriqe
e rënd sa s'undë qellet pa rëkuer
e pa mbajtur ndër duer një dhikoniqe.
4. S'pandehja t'kish t'e shkoja tue shërtuer
ditt e gjelles pār, çë shkuen e vān,
si gjith ata ç' mirosur dekja muer.
5. O gjella ime e pār, ku më të jān
gajdhīt e tua e oreksi me aq hję!...
Gjith pandohjīt e tua popo si rān!...
6. Si ndëpër trimat fare hję më kē
me lesht e bārđh, me kurmin të kërrust,
pa gōl e frīm e i ngrīt e pavëlē!...
7. Çë më të kënda t'roç kūr edhe kpuct
të mëshojen ndër këmb e s'und xarrisnjesh
nengu një pishk të vikerr zēn ndē luct.
8. Çë të kënda të roç kūr s'und përtipnjesh
nengu një dorez fiq, se dhēmb sē kē,
e s'kē fuqī vet tirqit të mund vishnjesh?
9. Njo si të rivet fare m' i kē hję!...
Si të përqeshjen mnjān e të sihjenen,
e s'duen të t'gjegjjen ndomos se i urt jē!...
10. Si dhjā gjirivet tū ti mshon, e zenen
e tire me tīj s'bējen e të lēn
si shapk me morra, se të presihjenen!
11. Oh kriqe ç'ë pjeqria! Kuj ngrah ē vēn,
e losen dhja si helmi prigatūerit,
çë, pra çë bēn e qami, lart na ngrēn.
12. Kush merr si bie të pjeqërīs durūerit
me pjeqērīt mēkat ai qān ndē jet,
e nd'pist sē vete pra me të mkatūerit.
13. Ndramendi pjaku nēmur si do fjet
te jeta lig e sosme māj kā liq
e gozhda më picūt ē kjo çë e vret.
14. Të liga she çë gjith si dosa e dirq
të bējen e s'ë gjegjur nd'i brevjarën,
e i nget për helm të pjasenj si rrëshiq.
15. Pjaku shkon gjellen keq kūr më t'e nxraren
dhjā gjindja shpizes tīj kūr e vë mnjān
si shiesen prapa deres, çë mbarraren.
16. Pjasen kūr p'shkat atīj māj poçen hān
mos ngijen buken ndē lēngt, mos të hār shūm,
e fshehur hān të mirat ç'ata kān.
17. Pjasen kūr niprat tīj e qelljen dhūn,
kūr fare nēng e gjegjjen e e përqeshjen
e printd e tire s'duen t'i japen dhūn.
18. Kān helm kūr gjith të shpīs të zēn e qeshjen
ndē gjegjjen ndonjë pordhez t'i pēshtōnj,
kē s'undē mbānj se kā ndē bitht spërveshen.
19. Për helmet e pjeqrīs mos māj të rrōnj
të lusenj ndonjarī, ndē s'kā mēkat
çë mīr të rrōnj këtu penet të shkōnj.
20. Pjeqria, si ka do prire, e ruen me shkat
e helm të theren gjellen me një thik
të keqe, se e rrujxjatez ē e xhavat.
21. Për të sē kemi sī, sē kemi griq;
sē kemi frīm e gōl e s'kemi duer;
sē kemi këmb e hję fare një çik.
22. Për të na e shkojmi vetem tue rëkuer,
e tue shërtuer at gjēll çë na perndōj,
e çë na prisjem māj të kish furnuer.
23. O gjella jōn e mīr si rranga shkōj,
e si na u strabukūa ka s'prirret më,
si rāt ndē varrt ku t'dalit jasht furnōj!
24. Ku trimrīs tēn qëllōj rrī rēnd e fjē,
e, sā më fjē, më i kënda atjē të fjēr,
se për të gjumi ēmbel keq i ē.

Idjomatizme ka Purçilli

(vjen ka nr. 61)

gomaradhe-ja, sf = ammasso di pietre

kjo shpi u bë një gomaradhe, questa casa è diventata un ammasso di pietre (è crollata)

gorrixë-a, sf = perastro, pera selvatica

ha gorrixa = mangia pere selvatiche (non ha altro da mangiare)
vate për gorrixa = è andato a cercare pere selvatiche (non ha altro da mangiare)

e di ai si hahen gorrixat = lo sa lui come si mangiano le pere selvatiche (conosce i sacrifici)

gozhdë-a, sf = chiodo

s'mund e shor fare, sikur i bëri gozhdat = non lo può vedere affatto, come se gli avesse fatto i chiodi

dish gozhdën sa t'virë hilnarin = volle il chiodo per appendere la lucerna (cerco il pretesto)

gradhë-a, sf = schiena

ju hap një vër ndë gradhet = gli si è aperto un buco nella schiena = gli fa male la schiena

i bën ngrit ka gradha = gli fa freddo alla schiena (è malaticcio)

i pruar gradhen = gli ha girato la schiena (l'ha tradito)

gramisënj, v.tr/intr = precipitare

ec u gramis ka timba Krivit! = vatti a buttare dalla rupe del Crivo! (non servi a niente!)

i gramisi ka timba Korbit e s'ka më gjë (li ha buttati dalla rupe del Corvo (i soldi) e non ha più niente) (s'è rovinato economicamente)

vate u gramis me këmbet e tij = è andato a buttarsi con le proprie gambe (si è rovinato da solo)

gramiset për të = si precipita per lui (si fa a pezzi)

grerez-a, sf = vespa

ë si grerez = è come una vespa (punzecchia, è vispa)

grihëz-a, sf = vipera

ju sul si grihez = gli si avventò come vipera (lo assalì violentemente)

grua-ja, sf = donna

ë drej grua = è proprio come una donna (ha atteggiamenti da

donna / svolge i servizi di casa come una donna)

ë grua e aret = è una donna d'oro (speciale)

grurë-t, sn = grano

mbjoth një xhavidhe grur = ha raccolto una conchiglia di grano (poco)

atë e ruajen si gruret mb'diell = la guardano come grano al sole (è preziosa)

grusht-i, sm = pugno

u bë një grusht = si è fatto un pugno (si è intimidito)

i dha një grusht bath = gli ha dato un pugno di fave

grykë-a, sf = bocca

sa karrera shqier griken! = quanto presto squarcia la bocca! (parla troppo e a vanvera)

iku pa hapur grik = se ne andò senza aprire bocca (senza parlare)
e vun nd'grikt gjindja = l'hanno messo in bocca la gente (la gente lo critica)

s'di menu t'vër vukunin nd'grikt = non sa nemmeno mettere il boccone in bocca (è incapace di fare le cose più semplici)

qindroj me griken hapt = restò a bocca aperta (restò meravigliato)

ka griken si furr = ha la bocca come un forno (è insaziabile)

ajo, me grik, shqier kambrin! = lei, con la bocca, strappa stoffa (si vanta a sproposito)

sa t'hapsh griken e gramiset = appena aprì bocca, si butta (è servizievole)

bëri grik moti = ha fatto bocca il tempo (si è aperto il cielo, il tempo si è rasserenato)

ja muar ka grika = glie l'ha preso dalla bocca (l'ha capito al volo)

bëri griken = ha fatto la bocca (ha preso un assaggio)

spordhisen, se ka griken pjot = parla a sproposito perchè ha la bocca piena (se la passa bene economicamente)

j'u hap një grik te gradha = gli si è aperta una bocca nella schiena (gli fa male la schiena)

e ka sembri nd'grikt = ce l'ha sempre in bocca (lo nomina continuamente)

është grik-qull = è bocca-polenta (non sa parlare)

është grik-hapt = è bocca-aperta (parla troppo / è credulone / svelta i segreti)

i mbjuan griken = gli hanno riempito la bocca (l'hanno comprato)

u bë me t'hapura grikje! = si è fatto di sbadigli! (si è scoccato a morte)

D.

Pjeqërisa

(vjen ka faqja 30)

25. Na la se t'gjillmi t'kallur si ndonj vër
ku fare mundë tundemi shtimguer,
si zën ka mora, çë mëj do t'na lër.

26. Pa, si do jemi na të mkatruer,
Ti Zotikrisht kī paq e na lipis,
na shkul ka lidhur jemi këmb e duer.

27. Na shkul e nxir ka këjo e keqe pis,
e, i mir e i but e i dashur si ti jë,
ma mirr me t'ij e lart ndër qiell na shtin.

28. Na mirr e qell me t'ij lart nd'ato hjë,
ku me drit paqja bukur shum lulzon
e çëdo aq shërtohet ktu mbi dhë

29. atjë, si ndë dët math, mbàru mburon.

Arkimandriti Eleuterio F. Fortino

(vjen ka faqja 29)

31 – Besa, Circolo italo-albanese di cultura, pro manuscripto, Roma 2003 (nr.22); *Partecipazione alle cose sacre tra cristiani non in piena comunione*, sussidi catechetici 29 – pro manuscripto -, Besa, Roma 2003 (nr.19); *Bolla d'unione tra Greci e Latini del Concilio di Firenze e gli Albanesi d'Italia*, Besa, pro manuscripto, Roma 2003 (nr.18); *Colonna dell'ortodossia: Sant'Atanasio di Alessandria*, Besa, Roma 2003 (nr.15); *Iconografia bizantina – visione del mondo nuovo*, Sussidi Catechetici, pro manuscripto, Besa, Roma 2003 (nr.13); *Teologia dell'icona in S.Giovanni Damasceno*, - Sussidi catechetici 21 -, Besa, pro manuscripto, Roma 2000 (nr.6).

Madre Teresa. Dai Balcani a Calcutta

Pierfranco Bruni

ka Sullarënxa (Cs)

Forse è questione anche di capire il valore delle etnie o delle appartenenze. Comprendere e dare un nome ai vissuti delle genti nei luoghi, nei territori, nella testimonianza delle religiosità espresse. Sono stato più volte in Macedonia: tra Skopje e Tetovo. Una geografia che racconta la civiltà e la storia in un rimando tra una forte componente macedone e musulmana e un inciso di eredità albanese. Quell'Albania che va oltre Tirana e le sponde dell'Adriatico o di Scutari, porta cerniera della Kosova. Tra la Kosova e la Macedonia nasce la voce di Madre Teresa di Calcutta. Una voce in un Adriatico che incontra due mondi: l'Oriente e l'Occidente. Anjezë Gonxhe Bojaxhiu nasce il 26 agosto del 1910 a Skopje, da genitori originari di Prizren, Kosova. Una terra albanese che recita nenie e verità.

Infatti spesso dirà di avere sangue albanese ("Sono di sangue albanese e di cittadinanza indiana"), e questa caratterizzazione la porterà a comprendere i "confini" delle civiltà e la profezia delle fedi. Ma al di là della sua biografia e delle sue varie tappe tra i Continenti e i Paesi dove ha portato la parola della cristianizzazione, il suo messaggio supera i conflitti territoriali che sono stati e sono divisioni ideologiche e di religione, per definire un percorso che è quello dell'amore in Cristo.

In una città, in cui il mondo musulmano è abbastanza radicato, la parola e la figura di Madre Teresa ha significato, tra l'altro, che la fede, o meglio le fedi, non possono conoscere confini e neppure orizzonti.

Ancora oggi Skopje si manifesta per la sua "tendenzialità", non solo balcanica ma islamica, e la voce di Madre Teresa è riuscita ad incidere notevolmente, non tanto nelle istituzioni o nelle scenografie, ma nel cuore della gente.

Così in Albania, o nelle Albanie che solcano i territori dei Balcani. In gran parte dei territori albanesi, pur tra le frontiere di una geografia graffiante da secoli, si respira la voce di Madre Teresa. C'è un'immagine emblematica che mi ritorna spesso e che si presenta con una valenza sia culturale che religiosa. In un frammento d'Albania. Un esempio, Scutari.

Mi riferisco al rapporto tra fedi e processi religiosi a Scutari. Perché Scutari? A Scutari, la presenza di Madre Teresa, pur nelle contraddizioni di una cultura che snocciola segni di Oriente impastati nell'Occidente, crea un confronto, mai un contrasto e tanto meno un conflitto, tra la Moschea e la Chiesa cattolico-cristiana. Infatti c'è una forte dimensione simbolica che si contraddistingue nell'immagine che si osserva entrando nella città di Scutari. Lo sguardo rimbalza immediatamente sulla statua di Madre Teresa, che è posta proprio di fronte alla Moschea a al minareto. Un'immagine non sorprendente, ma contemplante. Gli occhi di Madre Teresa sembrano focalizzare l'entrata della Moschea. Non si può trattare di una coincidenza. Ma i simboli hanno una loro dimensione che penetra anche i tessuti storici.

Così a Calcutta. Ho visitato la Calcutta di Madre Teresa. Un'immagine tra le ferite negli occhi. Una testimonianza soltanto. D'altronde il pensare di Madre Teresa è stato sempre quello dell'incontro, nell'interpretazione di una costante contaminazione tra vite, tra popoli, tra culture, e mai disperdendo doveri e diritti di una eredità che è fatta di sangue. Quel concetto-chiave del "sangue albanese" non è una ostentazione. È piuttosto una derivazione di un modello che è

profondamente esistenziale. Di un esistenzialismo in cui il senso della carità resta dominante. Missionaria dai Balcani a Calcutta in un attraversamento, in una Europa che non va evangelizzata, ma compresa.

La carità non è soltanto aiuto, secondo Madre Teresa, ma collaborazione, comprensione, amore. Il conferimento del Premio Nobel per la Pace nel 1979 non dimostra soltanto il compito svolto dalla missionaria, ma scava nella coscienza dei popoli; e scavano nella coscienza dei popoli soprattutto le parole pronunciate in quell'occasione. Ebbe a pronunciare: "C'è molta sofferenza oggi nel mondo, non solo nei Paesi poveri; ho scoperto che la povertà dell'Occidente è molto più difficile da rimuovere. Quando raccolgo una persona per la strada, affamata, le dò un piatto di riso, un pezzo di pane, l'ho fatta contenta. Ho rimosso quella fame. Ma una persona che è esclusa, che si sente indesiderata, non amata, spaventata, una persona che è stata espulsa dalla società, questa è una povertà molto vulnerabile e che io trovo molto difficile". Era l'11 dicembre 1979.

Gli ultimi anni della sua vita, nonostante i suoi malesseri e i suoi attacchi di cuore, sono abbastanza frenetici. Nel 1988 la troviamo in Unione Sovietica. Nel maggio del 1990 si reca in Albania e fa visita in questa sua terra per la prima volta dopo sessantadue anni. L'anno successivo, il 2 marzo, apre delle Case di Carità in Albania. Si reca a Baghdad, in Messico, in California. Qui viene operata, per la prima volta, al cuore; successivamente va prima in Cina, a Shanghai, e poi in Vietnam. Da Roma a New York, per poi fare ritorno a Calcutta. Le sue condizioni di salute diventano sempre più cagionevoli. Il 5 settembre del 1997 muore nella Casa Madre a Calcutta. Di sera, alle ore 21,30. Il suo legame con Giovanni Paolo II è esemplare. Nel 1999 si avvia il processo di beatificazione e nel 2002 il Papa firma due decreti che permettono l'autorizzazione per la beatificazione nell'ottobre del 2003. Il 19 ottobre del 2003 Madre Teresa, in San Pietro, viene beatificata. La religiosa cristiana albanese è un percorso nella comunanza delle fedi, nel nome dell'amore. Dai Balcani in India. Dalla sua Macedonia a Roma. Una suora albanese nel nome di Cristo. Nel segno della tolleranza, quel sangue albanese che ha vissuto nella cittadinanza indiana ci ha insegnato in una parola che occorre coraggio, molto coraggio per affrontare una contemporaneità in cui l'etnia può non essere un valore, ma una mera provocazione, ed è proprio in questi momenti che non bisogna dimenticare: "Quello che per anni ha costruito può essere distrutto in un attimo / Non importa, costruisci". Dall'incrocio di una città dei Balcani in un viaggio nel cuore degli uomini. Calcutta è un cuore lacerato. I Balcani sono l'attesa, ma anche la speranza, di una piccola suora che recita i passi del rosario.

Djovasni
Jeta Arbëreshe
<http://digilander.libero.it/jetarbreshe>